

TË TORTURUAR

PËR KRISHTIN

PASTOR RIÇARD VURMBRAND





TË TORTURUAR

PËR KRISHTIN

Ky libër është përdorur në mënyrë të veçantë për rizgjimin e ndërgjegjes së botës së lirë ndaj tmerreve të përjetuara nga vëllezërit dhe motrat tona pas Perdes së Hekur.

—Çarls W. Kolson, Bashkësia e Burgut

Muaj në qelinë e izolimit, vite të torturave të herë pas herëshme fizike, vuajtje të vazhdueshme nga uria dhe të ftohtët, ankthi i indoktrinimit dhe mizoria mendore, këto janë përjetimet e një pastori rumun gjatë katërbëdhjetë viteve në burgjet komuniste.

Krimi i tij, si i shumë të tjerëve, ishte besimi i zjarrtë në Jezu Krishtin dhe dëshmia publike në lidhje me këtë besim.

Duke u takuar nëpër shtëpi, në bodrume, në pyje, ndonjëherë duke guxuar të predikonin në publik në qoshet e rrugëve, këta shpirta besnikë këmbëngulën në dëshminë e tyre të krishterë duke e ditur shumë mirë çmimin e veprimeve të tyre.

Kjo është historia e tyre, një rrëfim klasik i guximit, besimit të patundur dhe qëndresës së pabesueshme. Kjo histori e kishës së fshehtë reflekton mundimet që vazhdojnë edhe sot në shumë pjesë të botës.



ISBN: 978-0340863688



9 780340 863688

TË TORTURUAR

PËR KRISHTIN

PASTOR RIÇARD VURMBRAND



Të torturuar për Krishtin

© 1967, 1998 nga Zëri i Martirëve, Inc. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij libri nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë lloj sistemi apo të transmetohet në ndonjë mënyrë, përveç rastit të citimeve të shkurtra të botuara në artikuj apo në përmbledhje, pa pasur më parë leje me shkrim nga botuesi.

Referencat e Shkrimit janë nga versioni ABS.

Bibliografia e të dhënave

Vurmbrand, Riçard.

Të torturuar për Krishtin/Riçard Vurmbrand. – përvjetori i 30-të i botimit.

p. cm.

ISBN 0-88264-326-6 (pbk.)

Vurmbrand, Riçard. 2. Kisha Luterane—Rumani—Pastor—Biografia. 3. Persekutimi—Rumani—Historia—shekulli XX. 4. Të burgosur politikë—Rumani—Biografi. 5. Komunizmi dhe Krishterimi—Rumani—Historia—shekulli XX. 6. Komunizmi dhe Krishterimi—Evropa Lindore—Historia—shekulli XX. 7. Rumani—Historia e Kishës—shekulli XX. 8. Evropa Lindore—Historia e Kishës—shekulli XX.

Translator: Eva Zela

Editors: Valbona Gace, Aurora Manaj, Valbona Gace

Graphics & Layout: OM EAST

Originally published in English under the title “Tortured for Christ” by Pastor Richard Wurmbrand

© 1967, 1998 by The Voice of the Martyrs, Inc., USA.

© 2012 by The Voice of the Martyrs in cooperation with OM EAST for the Albanian edition.

Translated by permission. All rights reserved.

ISBN-13: 978-0340863688

Kushtuar

Pastorit W. Stjuart Herris, Drejtor i Përgjithshëm i Misionit të Krishterë Evropian në Londër, i cili erdhi në Rumani kur u lirova nga burgu në vitin 1964, për të sjellë mesazhe nga të krishterët në perëndim. Erdhi në shtëpinë tonë natën vonë, pasi kishte marrë masa paraprake, na solli fjalë dashurie, ngushëllimi dhe lehtësimi për familjet e martirëve të krishterë. Në emër të këtyre besimtarëve besnikë, shpreh mirënjohjen tonë.

Parathënie

«Martiri»

Riçard Vurmbrand ka thënë: «*Të torturuar për Krishtin* nuk ka ndonjë vlerë letrare. Është shkruar vetëm tri ditë pas lirimit tim nga burgu, por është shkruar me bojë e lot. Për ndonjë arsye, Perëndia ka zgjedhur ta bekojë këtë shkrim dhe ta përdorë për qëllimin e Tij”. Në këtë përvjetor të botimit të 30-të, *Të torturuar për Krishtin* nuk ka ndryshuar shumë. Dëshmia origjinale e burgosjes katërmëdhjetë vjeçare të pastorit nën diktaturën rumune, është lënë e paprekur.

Gjatë viteve, *Të torturuar për Krishtin* është përkthyer në 65 gjuhë dhe janë shpërndarë miliona kopje në mbarë botën. Ne mahnitemi vazhdimisht se si kjo dëshmi është përdorur prej Perëndisë për të forcuar Trupin e Tij. Kemi zbuluar se në këtë Trup, fitorja, guximi, qëndrueshmëria dhe këmbëngulja nuk njohin kufij, as ngjyrë lëkure, as kombësi, por u janë dhënë të gjithëve në mënyrë të barabartë me anë të Frymës së Shenjtë.

Është shumë e habitshme se si pastorët kinezë, shtëpiaket amerikane dhe shoferët arabë të mund të frymëzohen dhe të inkurajohen të gjithë nga një libër i një çifuti rumun. Drejtuesit e kishave-shtëpi në Vietnam më treguan një herë se si përgatisnin grupin e tyre të krishterë të mbijetonin dhe të rriteshin ndërsa prisnin që komunizmi të vinte në pushtet në Vietnamin e jugut, në vitin 1970. Shpërndanin librin *Të torturuar për Krishtin* të përkthyer në gjuhën vietnameze si udhëzues mbijetese, një dëshmi


e një besimi fitimtar në rrethana jashtëzakonisht të vështira. Kemi marrë gjithashtu letra nga shumë persona, që kanë krijuar një marrëdhënie personale me Jezun Krishtin duke lexuar këtë libër dhe duke kuptuar se dashuria e Krishtit është një realitet i fuqishëm. Në këtë aspekt, këto faqe nuk përbëjnë ndonjë sulm politik, por paraqesin «dëshminë» e një martiri të Ungjillit.

Shumë njerëz sot besojnë se martir është dikush që vdes për besimin e tij. Fatkeqësisht, me anë të këtij përkufizimi kemi humbur kuptimin e vërtetë dhe të thellë të martirizimit. Shën Agustini ka deklaruar një herë: «Martir të vërtetë të bën shkak dhe jo vuajtja». Në dramën e tij *Vrasje në Katedrale*, T.S. Eliot e përshkruan një martir si dikë, që «është bërë instrument i Perëndisë, ka humbur vullnetin e tij në atë të Perëndisë, nuk e ka humbur, por e ka gjetur, sepse ai ka gjetur liri në nënshtrimin ndaj Perëndisë. Martiri nuk dëshiron asgjë për vete, madje as lavdinë e martirizimit».

Sipas origjinalit në greqisht, «martir» do të thotë «dëshmitar». Shkrimtari i Hebrenjve deklaroi «duke qenë të rrethuar nga një re kaq e madhe dëshmitarësh [martirësh]» (12:1), dhe Jezusi na udhëzon te Veprat 1:8: «Do të bëheni dëshmitarët [martirët] e Mi në Jeruzalem dhe në gjithë Judenë, në Samari dhe deri në skajin e dheut».

Martiri i Dhiatës së Re, jo vetëm që dëshmoi personalisht të vërtetën dhe fuqinë e Jezun Krishtit, por u udhëzua t'ua dëshmonte të tjerëve, pavarësisht çmimit. Më vonë, në librin e Veprave, lexojmë rreth goditjes me gurë të Stefanit, duke u bërë i pari që pagoi çmimin me vdekje për çka dëshmoi. Në këtë kohë fjala martir mori një kuptim më të fuqishëm, si dikush që s'është vetëm dëshmitar, por edhe gati të japë jetën e tij apo të martirizohet për atë qëllim.

E vërteta për të cilën duhet të dëshmojmë kushton shumë, mund të na kushtojë reputacionin, popullaritetin dhe prestigjin. Mund të na kushtojë familjen, miqtë apo jetën tonë. Por mesazhi i dëshmisë sonë është aq i fuqishëm sa nxitemi të «hedhim tej çdo barrë dhe mëkatin që na qarkon vazhdimisht duke na joshur» (Hebrenjve 12:1), me qëllim që të rendim me durim në «garën» që Perëndia ka vendosur përpara në jetën tonë.



Mesazhi i «dëshmitarëve» të Krishtit nuk mund të përcaktohet nga kufij fizikë. Ai tejkalon çdo lloj kornize, që mund ta konsiderojmë të përshtatshme. Martirizimi nuk është demoralizues, por është i nevojshëm për të shkuar drejt të kuptuarit të realitetit të krishterë global... i nevojshëm që të marrim atë që «na është dhënë për hir të Krishtit», «të vuajmë për Të» (Filipianëve 1:29). Besimi i këtyre dëshmitarëve apo martirëve, s'mund të kontrollohet apo të vritet. Ai vetëm mund të mbjellë fara për të zgjeruar më tej mbretërinë e Perëndisë «në Jeruzalem, dhe në gjithë Judenë, në Samari dhe deri në skajin e dheut» (Veprat 1:8), ndërsa dëshmitë e tyre dëshmojnë të vërtetën e Jezu Krishtit. Krishti ka thënë: «Mbi këtë shkëmb unë do të ndërtoj kishën time dhe dyert e ferrit nuk do ta mundin atë» (Mateu 16:18).

Në këtë kuptim e kam njohur pastor Riçard Vurmbrandin si dikë, jeta e të cilit pasqyron atë të një martiri. Jo për shkak të vdekjes, por sepse ai mban dëshminë e jetës së Krishtit dhe vuajtjet kanë qenë të atilla, sa në vend të jetës vetë, do të ishte preferuar më mirë vdekja.

Të torturuar për Krishtin, jo vetëm që zbulon fakte që kanë të bëjnë me një njeri që ka vuajtur në duart e regjimit të egër komunist, por gjithashtu besimin dhe këmbënguljen e një njeriu të përkushtuar plotësisht ndaj Krishtit dhe dëshirën e tij për ta ndarë të vërtetën me të tjerët. Është kjo e vërtetë që vjen e gjallë në çdo faqe, duke transformuar të menduarit e të krishterëve perëndimorë, duke zbuluar se gjatë gjithë historisë, madje edhe sot, të krishterët kalojnë vuajtje të tmerrshme dhe madje, edhe vdesin për dëshminë e tyre të jetës dhe fuqisë së Jezu Krishtit.

Lutja jonë është që kjo dëshmi të vazhdojë, që të mund ta thellojmë marrëdhënien tonë me Jezu Krishtin dhe detyrën tonë në këtë tokë. Që të mund të kuptojmë aspektet e vërteta të jetës së një martiri, dhe sipas vullnetit të Perëndisë, të mund të kemi dëshirë të bëhemi ky dëshmitar.

Tom Uait
Drejtori i SHBA-së, Zëri i Martirëve

KAPITULLI I

Etja e madhe e rusëve për Krishtin

Një ateist gjen Krishtin

Mbeta jetim që në vitet e para të jetës. Duke qenë se u rrita në një familje ku nuk njihej asnjë fe, nuk mora asnjë arsim fetar kur isha fëmijë. Për shkak të një fëmijërie të hidhur, që do të thoshte njohje e varfërisë në vitet e vështira të luftës së parë botërore, në moshën katërmëdhjetë vjeçare isha po aq ateist i bindur sa janë edhe komunistët sot. Kisha lexuar libra ateistë, dhe jo vetëm që nuk besoja në Perëndi apo në Krisht, por edhe i urreja këto nocione, duke i konsideruar të dëmshme për mendjen njerëzore. Kështu që u rrita me urrejtje ndaj fesë.

Por siç e kuptova më pas, pata hirin të isha një nga të zgjedhurit e Perëndisë për arsye që nuk i kuptoj. Këto arsye nuk kishin të bënin aspak me karakterin tim, shumë të keq atëherë.


Megjithëse isha ateist, diçka e pashpjegueshme më tërhiqte gjithnjë drejt kishave. E kisha të vështirë të kaloja pranë një kishe pa hyrë brenda. Megjithatë, asnjëherë nuk kuptoja se çfarë ndodhte në to. Dëgjoja predikimet, por nuk ma preknin zemrën. E imagjinoja Perëndinë si një padron, të cilit duhej t'i bindesha. E urreja këtë imazh të gabuar të Perëndisë, dhe do të më kishte pëlqyer të dija që një zemër e dashur ekzistonte diku në qendër të këtij universi. Meqë nuk kisha njohur shumë gëzime në fëmijëri dhe rini, kisha shumë dëshirë që të kishte diku një zemër të dashur, që rrihte edhe për mua.

E binda veten që nuk kishte Perëndi, por isha i brengosur që një Perëndi i tillë i dashur nuk ekzistonte. Një herë, gjatë një konflikti të brendshëm shpirtëror, hyra në një kishë katolike. Pashë njerëz që përgjunjeshin dhe thoshin diçka. Mendova, «Do të ulem pranë tyre që të mund të dëgjoj çfarë thonë, të përsëris lutjet dhe të shoh nëse ndodh diçka». Ata i drejtoheshin në lutje virgjëreshës së shenjtë: «E shenjta Mari hirplote». Përsërisja fjalët herë pas here, vështroja statujën e virgjëreshës Mari, por asgjë nuk ndodhi. U dëshpërova shumë.

Një ditë, si një ateist i bindur, iu luta Perëndisë. Lutja ime ishte pak a shumë kështu: «Perëndi, e di me siguri që Ti nuk ekziston, por nëse rastësisht ekziston, gjë që e kundërshtoj, nuk është detyra ime të besoj në Ty; është detyra Jote të më zbulohesh». Isha ateist, por ateizmi nuk më jepte paqe në zemër.

Gjatë kësaj kohe të trazirës sime të brendshme, një marangoz i moshuar në një fshat lart në malet e Rumanisë, lutej kështu: «Perëndia im, të kam shërbyer Ty në tokë dhe dëshiroj ta kem shpërblimin tim si në tokë, ashtu edhe në qiell. Shpërblimi im do të ishte që të mos vdisja para se të sillja një çifut te Krishti, sepse Jezusi erdhi prej çifutëve. Por jam i varfër, i moshuar dhe i sëmurë. S'mund të dal e të kërkoj ndonjë çifut. Në fshatin tim nuk ka asnjë. Sille një të tillë këtu dhe do të bëj të pamundurën për ta sjellë te Krishti».

Diçka e parezistueshme më tërhoqi drejt atij fshati. Nuk kisha asnjë arsye për të shkuar atje. Rumania ka dymbëdhjetë mijë fshatra, por shkova pikërisht tek ai. Duke parë që isha çifut, marangozi m'u vardis më tepër se ç'mund t'i vardisesh një vajze të bukur. Ai pa tek unë përgjigjen e lutjes së tij dhe më dha një Bibël për ta lexuar. E kisha lexuar Biblën shumë herë më parë, thjesht për interes kulturor, por ajo që më dha ai ishte e një lloji tjetër. Siç më tregoi më vonë, ai dhe gruaja e tij ishin lutur së bashku me orë të tëra për kthimin tim dhe të gruas sime në besim. Bibla që më dha nuk ishte e shkruar thjesht me fjalë, por me zjarrin e dashurisë të ndezur me anë të lutjeve të tij. Nuk mundja as ta lexoja. Vetëm vajtoja mbi të, duke krahasuar jetën time të keqe me jetën e



Jezusit; papastërtinë time me drejtësinë e Tij; zemërimin tim me dashurinë e Tij, dhe Ai më pranoi si një nga të Tijët.

Shumë shpejt pas meje, edhe gruaja ime u kthye në besim. Ajo solli shpirtra të tjerë te Krishti. Këta sollën të tjerë, dhe kështu u ngrit një bashkësi e re luterane në Rumani.

Më pas erdhën nazistët, nën sundimin e të cilëve kemi vuajtur shumë. Në Rumani, nazizmi mori formën e një diktature të elementëve ekstremë ortodoksë, që persekutonte si grupet protestante, ashtu dhe ato çifute.

Edhe para vajosjes sime zyrtare dhe përgatitjes për shërbesë, isha drejtuesi i kësaj kishe, duke qenë themeluesi i saj. Isha përgjegjës për të. Unë dhe gruaja ime u arrestuam disa herë, na rrahën dhe na nxorën para gjykatësve nazistë. Terrori nazist ishte i madh, por ishte vetëm pak në krahasim me atë që do të vinte nën sundimin komunist. Djalit tim, Mihait, iu desh të merrte një emër joçifut për t'i shpëtuar vdekjes.

Por në kohën e nazizmit patëm një avantazh të madh. Na mësuan se rrahjet fizike mund të durohen dhe shpirti i njeriut, me ndihmën e Perëndisë, mund t'u mbijetojë torturave të tmerrshme. Na mësuan teknikën e punës së krishterë në fshehtësi, e cila ishte përgatitje për një provë akoma edhe më të rëndë që po vinte, një provë që pothuajse ishte në prag.

Shërbesa ime ndaj rusëve

Përtej keqardhjes për prejardhjen time si ateist, që nga dita e parë e kthimit në besim, kisha shumë dëshirë t'u dëshmoja rusëve. Rusët janë një popull i mburjuar që prej fëmijërisë në ateizëm. Dëshira ime për t'i arritur është përmbushur, pa dashur të shkohej deri në Rusi për këtë. Përmbushja filloi që në kohën e nazizmit, sepse në Rumani kishte mijëra të burgosur lufte rusë mes të cilëve mund të bënim punë të krishterë.

Ishte punë prekëse dhe dramatike. Nuk do ta harroj kurrë takimin tim të parë me një të burgosur rus, një inxhinier. E pyeta nëse besonte te Perëndia. Nëse do kishte thënë «jo», nuk do ia


kisha vënë veshin shumë. Është zgjedhja e çdo njeriu të besojë apo të mos besojë. Por kur e pyeta, ai ngriti sytë drejt meje, më pa dhe tha: «Nuk kam asnjë urdhër ushtarak që të besoj. Nëse do të më jepet urdhër, do të besoj».

Lotët më rrodhën faqeve. Ndjeva që zemra m'u bë copë. Para meje qëndronte një njeri, mendja e të cilit ishte e vdekur, një njeri që kishte humbur dhuratën më të madhe që Perëndia i ka dhënë njerëzimit: individualitetin. Ai ishte një mjet i indoktrinuar në duart e komunistëve, i gatshëm për të besuar ose jo në bazë të një urdhri. S'mund të mendonte më vetë. Ky ishte një rus tipik pas gjithë atyre viteve të dominimit komunist! Pas tronditjes, kur pashë se çfarë u kishte bërë njerëzimi qenieve njerëzore, i premtova Perëndisë se do t'ua përkushtoja jetën këtyre njerëzve, për t'ua kthyer personalitetin dhe për t'u dhënë besimin te Perëndia dhe te Krishti.

Në 23 gusht 1944, një milion trupa ruse hynë në Rumani, dhe më pas, nuk vonoi shumë dhe komunistët erdhën në pushtet në vendin tonë. Filloi makthi që i bëri vuajtjet e nazistëve të dukeshin të lehta.

Në atë kohë në Rumani, që sot ka një popullsi prej 24 milionësh, Partia Komuniste kishte vetëm dhjetë mijë anëtarë. Por Vishinski, Sekretari i Jashtëm i Bashkimit Sovjetik, hyri me furi në zyrën e mbretit tonë të dashur Mikaeli I, përplasi grushtin në tavolinë dhe tha: «Ju duhet të caktoni komunistët në qeveri». Ushtria dhe policia jonë u çarmatos, me anë të dhunës dhe të urreyer nga të gjithë, komunistët erdhën në pushtet. Dhe kjo nuk ndodhi pa bashkëpunimin e qeveritarëve amerikanë dhe britanikë të asaj kohe.

Njerëzit janë përgjegjës para Perëndisë, jo vetëm për mëkatet e tyre personale, por edhe për mëkatet e kombit. Tragjedia e të gjitha kombeve të robëruara është përgjegjësi në zemrat e të krishterëve amerikanë dhe britanikë. Amerikanët duhet të dinë që herë pas here, në mënyrë jo të zgjuar, kanë ndihmuar rusët në vendosjen e regjimit të vrasjeve dhe terrorit ndaj nesh. Si pjesë e trupit të Krishtit, amerikanët duhet ta shlyejnë këtë duke i ndihmuar njerëzit e robëruar të vijnë në dritën e Krishtit.



Mashtrimi i Kishës

Kur komunistët erdhën në pushtet, përdorën me mjeshtëri mjetet e mashtrimit ndaj kishës. Gjuha e dashurisë dhe gjuha e mashtrimit janë të njëjta. Ai që e dëshiron një vajzë për bashkëshorte dhe ai që e dëshiron vetëm për një natë thonë të njëjtat fjalë: «Të dua». Jezusi na ka thënë të bëjmë dallimin midis gjuhës së mashtrimit dhe gjuhës së dashurisë, dhe të dallojmë ujëqit e fshehur nën lëkurën e deleve dhe delet e vërteta. Fatkeqësisht, kur komunistët erdhën në pushtet, mijëra priftërinj, pastorë dhe drejtues nuk dinin ta bënin dallimin midis këtyre dy zërave.

Komunistët mbajtën një kongres me të gjithë drejtuesit e krishterë në ndërtesën e Parlamentit. Kishte katër mijë priftërinj, pastorë dhe drejtues kishash nga të gjitha denominacionet, dhe këta njerëz të Perëndisë zgjodhën Jozef Stalinin si president nderi në këtë kongres. Në të njëjtën kohë ai ishte presidenti i lëvizjes botërore të të paperëndishmëve dhe vrasës në masë i të krishterëve. Njëri pas tjetrit, peshkopë dhe pastorë u ngritën dhe shpallën se komunizmi dhe Krishterimi janë në thelb e njëjta gjë dhe mund të ekzistojnë së bashku. Njëri pas tjetrit pastorët lëvdonin komunizmin dhe e siguronin qeverinë e re për besnikërinë e kishës.

Unë dhe gruaja ime ishim të pranishëm në këtë kongres. Sabina më tha: «Riçard, ngrihu dhe hiqe këtë turp prej fytyrës së Krishtit! Ata po i pështyjnë». I thashë: «Nëse veproj kështu, do ta humbasësh bashkëshortin». Ajo u përgjigj: «Nuk dua të kem për bashkëshort një frikacak».

Më pas u ngrita dhe fola në kongres, duke mos lëvduar vrasësit e të krishterëve, por Jezu Krishtin, duke theksuar se besnikëria jonë i përkiste në radhë të parë Atij. Fjalimi në këtë kongres ishte në transmetim të drejtpërdrejtë dhe i gjithë vendi mundi ta dëgjonte shpalljen e mesazhit të Krishtit nga tribuna e parlamentit komunist! Më pas, më është dashur të paguaja për këtë, por ia vlente.

Kisha ortodokse dhe protestante konkurronin me njëra-tjetrën në dorëzimin ndaj komunizmit. Një peshkop ortodoks vendosi

çekiçin dhe draprin në veshjen e tij (simbole të komunizmit) dhe u kërkoi priftërinjve të tij të mos e thërrisnin më «Hirësia Juaj», por «Shoku Peshkop». Priftërinj si Patraskoiu dhe Rosinau ishin më të drejtpërdrejtë. Ata u bënë oficerë të policisë sekrete. Rapi, peshkop i kishës luterane në Rumani, filloi të jepte mësimë në seminarin teologjik se Perëndia kishte dhënë tri zbulesa: një përmes Moisiut, një përmes Jezusit dhe një përmes Stalinit, ky i fundit zinte vendin e të mëparshmit.


Ndoqa kongresin e baptistëve në qytetin e Resitës, një kongres nën flamurin e kuq, ku himni i Bashkimit Sovjetik u këndua duke qëndruar të gjithë në këmbë. Presidenti i baptistëve lavdëronte Stalinin si një mësues i madh i Biblës dhe shpallte se Stalini nuk bënte gjë tjetër veçse përmbushte urdhërimet e Perëndisë!

Duhet të kuptohet që baptistët e vërtetë, të cilët i dua shumë, nuk ranë dakord dhe qëndruan besnikë ndaj Krishtit, duke vuajtur shumë. Megjithatë, komunistët «i zgjidhnin» udhëheqësit e tyre dhe baptistët nuk kishin ç'të bënin veçse t'i pranonin. I njëjti kusht ekziston sot në vendet komuniste në krye të vetë udhëheqësisë fetare të kishës «zyrtare». Ata që u bënë shërbëtorë të komunizmit në vend të Krishtit, filluan të padisnin vëllezërit, që nuk bashkoheshin me ta.¹

Ashtu si të krishterët në Rusi krijuan kishën e fshehtë pas revolucionit të tyre, ardhja në pushtet e komunizmit dhe tradhtia nga shumë drejtues të kishave zyrtare na detyroi të krijonim në të njëjtën mënyrë, kishën e fshehtë në Rumani: një kishë besnike në Ungjillëzim, në predikimin e Ungjillit dhe arritjen e fëmijëve për Krishtin. Komunistët e ndalonin këtë dhe kisha zyrtare e përkrahte.

Bashkë me të tjerë, fillova një punë në fshehtësi. Nga ana e jashtme kisha një pozitë shumë të respektueshme, pastor i Misionit Luteran Norvegjez, që shërbente si mbrojtje për punën time të vërtetë. Në të njëjtën kohë përfaqësoja Këshillin Botëror të Kishave në Rumani. (Në Rumani nuk e kishim as idenë më

¹ Kisha zyrtare është ajo që është e regjistruar dhe e kontrolluar nga qeveria. Anëtarësimi i kishave zyrtare në shumë prej sistemeve totalitare sot numëron më pak se dhjetë për qind të popullsisë së krishterë. Të tjerët preferojnë të adhurojnë në fshehtësi.



të vogël që kjo organizatë do të bashkëpunonte ndonjëherë me komunistët. Në atë kohë, në vendin tonë, kjo nuk bënte gjë tjetër veçse punë ndihmash.) Këta dy tituj më jepnin një imazh të mirë para autoriteteve, të cilët nuk dinin gjë për punën time të fshehtë.

Kishte dy aspekte të kësaj pune të fshehtë. E para ishte shërbesa jonë e fshehtë midis ushtarëve rusë. Aspekti i dytë ishte puna e fshehtë me njerëzit e robëruar në Rumani.

Rusët – Popull me shpirt shumë të «etur»

Për mua, predikimi i Ungjillit te rusët ishte si parajsë mbi tokë. U kam predikuar Ungjillin shumë njerëzve në shumë kombe, por nuk kam parë asnjëherë ta përpijnë sikurse rusët. Kanë shpirt shumë të etur.

Një miku im, prift ortodoks, më telefonoi dhe më tha se një oficer rus kishte ardhur tek ai për t'u rrëfyer. Miku im nuk dinte rusisht. Megjithatë, duke ditur se unë flas rusisht, i kishte dhënë adresën time. Të nesërmen, ky njeri erdhi për të më takuar. Kishte shumë mall për Perëndinë, por nuk kishte parë kurrë Bibël. Nuk kishte pasur asnjëherë edukim fetar dhe nuk kishte ndjekur ndonjë shërbesë fetare (kishat në Rusi ishin shumë të rralla në atë kohë). Ai e donte Perëndinë pa pasur aspak njohuri për Të.

I lexova Predikimin në Mal dhe shëmbëlltyrat e Jezusit. Pasi i dëgjoi, kërcëu rreth dhomës me një gëzim dalldisës duke shpallur: «Çfarë bukurie e mrekullueshme! Si kam mundur të jetoj pa e njohur këtë Krisht!» Ishte hera e parë që shihja dikë kaq të gëzuar në Krishtin.

Më pas bëra një gabim. I lexova mundimet dhe kryqëzimin e Krishtit, pa e përgatitur më parë për këtë. Ai nuk e priste dhe kur dëgjoi se si Krishti ishte rrahur, kryqëzuar dhe në fund vdiq, u lëshua në kolltuk dhe filloi të qante me hidhërim. Kishte besuar në një Shpërtimtar dhe tani Shpërtimtari i tij kishte vdekur!

E vështrova dhe më erdhi turp. E quaja veten të krishterë, pastor dhe mësues i të tjerëve, por asnjëherë nuk kisha ndarë vuajtjet e Krishtit siç bëri ky oficer rus. Po e vështroja dhe ishte

si të shihje Maria Magdalenën duke qarë në këmbët e kryqit, duke vajtuar me besnikëri kur Jezusi ishte një kufomë në varr.


Më pas i lexova historinë e ringjalljes dhe pashë që pamja e tij ndryshoi. Nuk e dinte që Shpëtimtari i tij u ngrit prej varrit. Kur dëgjoi këtë lajm të mrekullueshëm, rrahu gjunjët dhe u betua duke përdorur fjalë jo shumë të pastra, por «të shenjta». Ishte një mënyrë e papërpunuar e të folurit. U gëzua përsëri duke thirrur i ngazëllyer: «Ai është gjallë! Ai është gjallë!» Kërceu edhe një herë rreth dhomës, i mbushur plot me gëzim!

I thashë: «Le të lutemi!» Nuk dinte si të lutej. Nuk i dinte shprehjet e «shenjta». U ul në gjunjë bashkë me mua dhe fjalët e tij në lutje ishin: «O Perëndi, sa djalë i mirë që je! Nëse do të isha në vendin Tënd dhe Ti në vendin tim, nuk do t'i kisha falur kurrë mëkatet e Tua. Por Ti je vërtet shumë i mirë! Të dua me gjithë zemër!»

Mendoj se të gjithë engjëjt në qiell ndaluan punën e tyre për të dëgjuar këtë lujtë të mrekullueshme nga një oficer rus. Ky njeri u fitua për Krishtin!

Njëherë në një dyqan, takova një kapiten rus me një oficerë. Po blinin lloj lloj gjërash dhe kishin vështirësi në komunikim me shitësin, i cili nuk kuptonte rusisht. Ofrova t'u përktheja dhe u njohëm. I ftova për drekë në shtëpinë tonë. Para se të fillonim të hanim, u thashë: «Jeni në një shtëpi të krishterë dhe e kemi zakon të lutemi». E thashë lutjen në rusisht. Ata ulën pirunjët dhe thikat dhe nuk e e kishin më mendjen tek ushqimi. Për më tepër, nisën të bënin pyetje të njëpasnjëshme rreth Perëndisë, Krishtit dhe Biblës. Nuk dinin asgjë.

Nuk ishte e lehtë të flisje me ta. U tregova shëmbëlltyrën e një njeriu, i cili kishte njëqind dele dhe humbi njërën. Nuk e kuptonin për shkak të indoktrinimit të tyre me ideologjinë komuniste. Pyetën: «Si është e mundur që ai ka njëqind dele? A nuk ia ka marrë ferma kolektive komuniste?» Më pas u thashë se Jezusi është mbret. Përgjigjja e tyre ishte: «Të gjithë mbretërit kanë qenë të ligj që kontrollonin njerëzit, kështu që edhe Jezusi duhet të ketë qenë diktator». Kur u tregova shëmbëlltyrën e punëtorëve në vresht, ata



thanë: «Po pra, ata bënë shumë mirë që u rebeluan ndaj pronarit të vreshtit. Vreshti duhet të jetë i përbashkët». Çdo gjë ishte e re për ta. Kur u tregova rreth lindjes së Jezusit, pyetën për atë që do të ishte blasfemi për një perëndimor: «A ishte Maria gruaja e Perëndisë?» Në bisedën me ta dhe me shumë të tjerë, kuptova që predikimi i Ungjillit rusëve pas kaq shumë vitesh komunizëm, kërkonte përdorimin e një mënyre krejt të re.

Kjo është e vërtetë për shumë kultura të ndryshme. Misionarët që shkuan në Afrikën Qendrore kishin vështirësi në përkthimin e fjalëve të Isaias: «Edhe sikur mëkatet tuaja të ishin të kuqe flakë, do të bëhen të bardha si bora» (1:18). Askush në Afrikën Qendrore nuk ka parë ndonjëherë borë, kështu që nuk kishin një fjalë për të. Misionarëve iu desh ta përkthenin: «Mëkatet tuaja do të bëhen si thelbi i arrës së kokosit».

Kështu që na u desh ta përkthenim Ungjillin në «gjuhën marksiste» me qëllim që ata të mund të identifikoheshin me të. Ishte diçka që nuk mund ta bënim vetë, por Fryma e Shenjtë punoi përmes nesh.

Kapiteni dhe oficerja u kthyen në besim po atë ditë. Më vonë, na ndihmuan shumë në shërbesën e fshehtë ndaj rusëve.

Ne botonim dhe shpërndanim fshehurazi mijëra Ungjij dhe literatura të tjera të krishtera midis rusëve. Njëpërmjet ushtarëve rusë të kthyer në besim kalonim në fshehtësi Bibla dhe pjesë nga Bibla në Rusi. Përdornim gjithashtu një teknikë tjetër për të dërguar kopje të Fjalës së Perëndisë në duart e rusëve. Ushtarët rusë kishin disa vite që luftonin dhe shumë prej tyre kishin fëmijë, të cilët nuk i kishin parë gjatë gjithë kësaj kohe. (Rusët kanë një dashuri të veçantë për fëmijët.) Djali im, Mihai, dhe fëmijët e tjerë nën moshën dhjetë vjeçare shkonin tek ushtarët rusë në rrugë dhe parqe, duke mbajtur Bibla, ungjij dhe literatura të tjera nëpër xhepa. Ushtarët rusë u përkëdhelnin kokën, bisedonin me ta me dashuri, duke menduar për fëmijët e tyre, që nuk i kishin parë prej vitesh. U jepnin çokollata apo karamela, ndërsa fëmijët u jepnin Bibla dhe Ungjij, që pranoheshin me shumë dëshirë. Shpesh herë, ajo që për ne përbënte rrezik nëse bëhej hapur, për fëmijët tanë


ishte e sigurt. Ata ishin «misionarët e vegjël» për rusët. Rezultatet ishin të shkëlqyera. Shumë ushtarë rusë e merrnin Ungjillin në këtë mënyrë kur nuk kishte mënyrë tjetër.

Predikimi në kazemat e ushtrisë ruse

Punonim mes rusëve, jo vetëm duke dëshmuar personalisht, por edhe në takime të vogla grupi.

Rusët ishin shumë të dhënë pas orëve të dorës. Ua vidhnin kujtdo. I ndalonin njerëzit në rrugë dhe u kërkonin që t'ua jepnin. I shihnim rusët me disa ora dore në çdo krah, ndërsa oficeret i varnin në qafë. Nuk kishin pasur orë dore më parë dhe nuk kishin asnjëherë mjaftueshëm. Rumunët që kishin nevojë për një orë shkonin në kazemat e ushtrisë sovjetike për të blerë një të vjedhur, dhe qëllonte shpesh të blinin orën e tyre të vjedhur! Kështu që ishte e zakonshme për ta të hynin në kazemat ruse. Kisha e fshehtë e përdorte këtë pretekst, blerjen e orëve prej tyre, për të hyrë në kazermë.

Hera e parë që predikova në një kazermë ruse ishte në ditën e Shën Palit dhe Shën Pjetrit, një festë ortodokse. Shkova në bazën ushtarake duke pretenduar se do blija një orë dore. Hiqesha sikur njëra ishte shumë e shtrenjtë, një tjetër shumë e vogël, dhe një tjetër shumë e madhe. Disa ushtarë u mblodhën rreth meje, duke më ofruar secili diçka për të blerë. Me shaka i pyeta: «A quhet ndonjë nga ju Pal apo Pjetër?» Dhe kishte disa. Më pas thashë: «A e dini se sot është dita kur kisha ortodokse nderon Shën Palin dhe Shën Pjetrin?» (Disa prej rusëve më të vjetër e dinin.) Kështu pyeta: «A e dini cilët ishin Pali apo Pjetri?» Askush nuk e dinte, kështu që fillova t'u tregoja për ta. Një nga ushtarët më të vjetër rus më ndërpreu dhe më tha: «Ti nuk ke ardhur për të blerë orë dore. Ke ardhur për të na treguar për besimin. Ulu këtu me ne dhe na trego! Por trego kujdes! Ne e dimë prej kujt duhet të ruhem. Këta rreth meje janë të gjithë njerëz të mirë, por kur të vendos dorën në gjurin tënd, duhet të flasësh vetëm për orët e dorës. Kur ta heq dorën, mund ta fillosh përsëri mesazhin».



Një turmë e madhe burrash u mbledh rreth meje dhe u tregova për Palin dhe Pjetrin, për Krishtin për të cilin Pali dhe Pjetri kishin vdekur. Herë pas here, kur dikush që nuk besonte afrohej, ushtari vendoste dorën mbi gjurin tim dhe unë e hidhja fjalën për orët. Kur largohej, vazhdoja të predikoja për Krishtin. Kjo vizitë u përsërit shumë herë me ndihmën e ushtarëve të krishterë rusë. Shumë prej shokëve të tyre gjetën Krishtin dhe mijëra Ungjij u shpërndanë në fshehtësi.

Shumë motra dhe vëllezër në kishën e fshehtë u kapën dhe u rrahën për këtë, por nuk e tradhtuan organizatën tonë.

Gjatë kësaj pune gëzoheshim kur takoheshim me vëllezër nga kisha e fshehtë në Rusi dhe dëgjonim përvojat e tyre. Së pari, pamë tek ata atë çka i karakterizon shenjtorët e mëdhenj. Kishin kaluar përmes shumë vitesh indoktrinimi komunist, por ashtu si peshku që jeton në ujëra të kripura dhe e ruan mishin të ëmbël, në të njëjtën mënyrë edhe ata kishin kaluar përmes shkollave dhe universiteteve komuniste, por e kishin ruajtur shpirtin të pastër në Krishtin.

Sa shpirt të bukur kishin këta të krishterë rusë! Thanë: «E dimë se ylli me çekiçin dhe drapërin që mbajmë në kapela, është ylli i anti-Krishtit». E thanë këtë me keqardhje të madhe. Ata na ndihmuan shumë për të ndarë Ungjillin mes ushtarëve rusë.

Mund të them se i kishin të gjitha virtytet e krishtera, përveç virtytit të gëzimit. E kishin këtë vetëm kur ktheheshin në besim, por më pas kjo zhdukej. Mendova shumë për këtë. Një herë pyeta një baptist: «Si është e mundur që nuk keni gëzim?» Ai u përgjigj: «Si mund të kem gëzim kur më duhet ta mbaj të fshehur nga pastori i kishës sime që jam i krishterë i përkushtuar, që jetoj një jetë në lutje dhe që përpiqem të fitoj shpirtin? Pastori i kishës është informator i policisë sekrete. Spiunohemi njëri pas tjetrit dhe barinj të janë ata që tradhtojnë tufën. Shumë thellë në zemrën tonë ekziston gëzimi i shpëtimit, por gëzimin e jashtëm që keni ju, s'e kemi më».

Krishtërimi është bërë dramatik me ne. Kur të krishterët në vendet e lira fitojnë një shpirt për Krishtin, besimtari i ri mund


të bëhet anëtar i një kishe të gjallë e pa rrezik. Por në vendet e robëruara, kur dikush fitohet, e dimë që mund të shkojë në burg dhe fëmijët e tij mund të mbeten jetimë. Gëzimi që sjell dikë te Krishti është gjithmonë i përzier me ndjenjën e një çmimi, që duhet paguar. Kemi takuar një lloj krejt të ri Krishtërimi, të krishterim e kishës së fshehtë.

Në këtë pikë u befasuam shumë.

Meqenëse ka shumë që besojnë se janë të krishterë, por në të vërtetë nuk janë, zbuluam midis rusëve shumë që besojnë se janë ateistë, por që nuk janë të tillë.

Në një tren, një oficer rus u ul përballë meje. I kisha folur për Krishtin vetëm një herë për disa minuta kur ai shpërtheu me një furi argumentesh ateiste. Citime nga Marksi, Stalini, Volteri, Darvini dhe të tjerë kundër Biblës rridhnin prej gojës së tij. Më dha një mundësi për ta kundërshtuar. Foli për afërsisht një orë për të më bindur se nuk kishte Perëndi. Kur përfundoi, e pyeta: «Nëse nuk ka Perëndi, atëherë pse lutesh kur je në telashe?» Si një hajdut i zënë mat ndërsa vjedh, ai u përgjigj: «Nga e di ti që lutem?» Nuk e lejova të më shpëtonte. «Të pyeta unë i pari. Të pyeta pse lutesh. Të lutem m'u përgjigj». Uli kokën dhe pranoi: «Në front, kur u rrethuam nga gjermanët, të gjithë u lutëm! Nuk dinim si të luteshim, kështu që thamë: 'Perëndi dhe shpirti i nënës'» – që sigurisht është një lutje shumë e mirë në sytë e Atij që sheh zemrën.

Një herë tjetër takova një çift rus, të dy skulptorë. Kur u fola për Perëndinë, u përgjigjën: «Jo, Perëndia nuk ekziston. Ne jemi bezboshniki-jofetarë. Por do të të tregojmë diçka interesante që na ka ndodhur. Kur po punonim një statujë të Stalinit, gjatë punës, gruaja më pyeti: 'Po gishti i madh i dorës? Nëse nuk do të kishim gishtin e madh në anë të kundërt të gishtave të tjerë, nëse gishtat e dorës do të ishin si gishtat e këmbës, nuk do të mund ta mbanim draprin, çekiçin, mjetet e punës, librin apo një copë buke. Jeta njerëzore do të ishte e pamundur pa këtë gisht. Po, kush e bëri gishtin e madh të dorës? Ne të dy kemi mësuar marksizëm në shkollë dhe e dimë se qielli dhe toka ekzistojnë vetvetiu. Ata nuk janë të krijuar nga Perëndia. Kështu më kanë mësuar dhe kështu



besoj. Por nëse Perëndia nuk krijoi qiellin dhe tokën, nëse Ai ka krijuar vetëm gishtin e madh të dorës, do t'ia vlente të lëvdohej për diçka kaq të vogël.

Në lëvdojmë Edisonin, Bellin dhe Stivensonin që kanë shpikur dritën elektrike, telefonin, hekurudhën, dhe gjëra të tjera, por pse nuk duhet të lëvdojmë Atë që ka shpikur gishtin e madh të dorës? Nëse Edisoni nuk do të kishte pasur gishtin e madh të dorës, nuk do të kishte shpikur asgjë. Është e drejtë të adhurosh Perëndinë që e ka krijuar'».

Bashkëshorti u zemërua, siç bëjnë zakonisht ata kur gratë e tyre u thonë gjëra me mend. «Mos fol budallallëqe! Ke mësuar që nuk ka Perëndi. Ti nuk e di nëse shtëpia përgjohet. Mund të hyjmë në telashe. Ngulite një herë e mirë në kokë që nuk ka Perëndi. Në qiell nuk ndodhet askush!»

Ajo u përgjigj: «Kjo është një mrekulli edhe më e madhe. Nëse në qiell nuk ka një Perëndi të plotfuqishëm, në çfarë budallallëku besonin etërit tanë? Atëherë do të ishte e natyrshme që ta kishim gishtin e madh të dorës. Një Perëndi i plotfuqishëm mund të bëjë gjithçka, kështu që mund të krijonte edhe një gisht dore. Por nëse në qiell nuk ndodhet askush, atëherë do të adhuroj me gjithë zemrën time 'Askushin,' që ka krijuar gishtin e madh të dorës».

Kështu që ata u bënë adhuruesit e «Askushit!» Besimi i tyre tek «Askushi» u shtua me kalimin e kohës, duke besuar se Ai ishte krijuesi, jo vetëm i gishtit të madh të dorës, por edhe i yjeve, luleve, fëmijëve dhe i çdo gjëje të bukur në botë. Ishte pikërisht si në Athinë në kohët e hershme, kur Pali takoi adhuruesit e «Perëndisë së panjohur» (Veprat 17:23).

Ky çift ishte tej mase i lumtur kur dëgjoji prej meje se çka besonin ishte e drejtë, që në qiell ndodhej një «Askush,» Perëndia që është Frymë. Ai është Fryma e dashurisë, urtësisë, e së vërtetës dhe fuqisë, që i donte aq shumë sa që dërgoi Birin e tij të vetëm që të sakrifikohej në kryq për ta.

Ata besonin në Perëndi, duke mos e ditur që besonin. Kisha privilegjin e mrekullueshëm t'i drejtoja edhe një hap më tej, drejt përjetimit të shpëtimit dhe shpengimit.

Dikur pashë një oficerë në rrugë. Iu afrova dhe i kërkova ndjesë: «E di që nuk është e sjellshme t'i afrohesh një zonje në rrugë, por jam pastor dhe synimet e mia janë të pastra. Doja t'ju flisja për Krishtin».

Ajo më pyeti: «A e do Krishtin?». I thashë: «Po! Me gjithë zemrën time». M'u hodh në krahë duke më mbuluar me të puthura. Ishte situatë shumë e sikletshme për një pastor, kështu që e putha edhe unë, që njerëzit të mendonin se ishim të afërm. Më tha: «Edhe unë e dua Krishtin!» E solla në shtëpinë tonë dhe zbuluam se ajo nuk dinte asgjë për Krishtin, absolutisht asgjë, përveç emrit. Dhe përsëri e donte. Nuk e dinte që Ai ishte Shpëtimtari, as se çfarë kuptimi kishte shpëtimi. Ajo as nuk e dinte se ku dhe se si jetoi dhe vdiq. Nuk i njihnte mësimet, jetën apo shërbesën e Tij. Për mua ishte një kuriozitet psikologjik: si mund të duash dikë nëse i njeh vetëm emrin?


Kur e pyeta, më shpjegoi: «Kur isha fëmijë, më mësuan të lexoja me anë të figurave. Një 'a' ishte arrë, një 'b' ishte bukë, një 'c' ishte një cjap e kështu me radhë.

Kur shkova në shkollë të mesme, më mësuan se ishte detyra ime e shenjtë të mbroja atdheun komunist. Më mësuan rreth moralit komunist. Por nuk e dija se ç'ishte një 'detyrë e shenjtë' apo 'moral'. Kisha nevojë për figura për to. E dija që etërit tanë kishin një figurë për çdo gjë të bukur, të lëvdueshme dhe të vërtetë në jetë. Gjyshja ime përkulej gjithnjë para kësaj pikturë, duke thënë se ishte piktura e dikujt, që quhej Cristos (Krisht). Në vetvete e doja këtë emër. U bë shumë real për mua! Vetëm shpallja e tij më jepte shumë gëzim».

Kur e dëgjova, m'u kujtua ç'është shkruar te Filipianëve 2:10, që në emrin e Jezusit çdo gju do të përulet. Ndoshta anti-Krishti do të ketë mundësi për ca kohë të zhdukë prej botës njohurinë për Perëndinë, por në emrin e thjeshtë të Krishtit ka fuqi, dhe kjo do të çojë në dritë.

Ajo gjeti Krishtin plot gëzim në shtëpinë time dhe Ai, emrin e të cilit e donte, jetonte në zemrën e saj.

Çdo moment që kam jetuar me rusët ishte plot poezi dhe kuptim. Një motër që ndante Ungjillin në stacionet e trenave i



dha adresën time një oficeri të interesuar. Një mbrëmje, një toger i gjatë dhe i pashëm rus hyri në shtëpinë time.

E pyeta: «Si mund t'ju shërbej?»

Ai u përgjigj: «Kam ardhur për dritë».

Fillova t'i lexoja pjesët më kyçe të Shkrimit. E vendosi dorën mbi dorën time dhe më tha: «Të lutem me gjithë zemër, mos më ço në rrugë të gabuar. I përkas një populli të mbajtur në errësi. Më thuaj, a është kjo Fjala e vërtetë e Perëndisë?» E sigurova që ishte. Më dëgjoi për orë të tëra dhe pranoi Krishtin.

Prallë gjen rusë të cekët dhe sipërfaqësorë në çështje besimi. Nëse luftonin kundër fesë apo ishin pro saj dhe kërkonin Krishtin, e bënë me gjithë shpirt. Ja pse nën komunizëm në Rusi, të krishterët ishin misionarë të fitimit të shpirtave. Rusët kanë qenë historikisht një popull fetar. Vende të tilla janë gati dhe të frytshme për punë Ungjillëzimi, dhe drejtimi i botës po ndryshon ndërsa ndajmë me zell Ungjillin me ta. Është tragjike që Rusia dhe njerëzit e saj që janë kaq të etur për Fjalën e Perëndisë e kanë marrë Lajmin shkarazi.

Shërbesa jonë ndaj rusëve ka dhënë shumë fryte.

Më kujtohet Piotri (Pjetri). Askush nuk e di se në cilin burg rus u zhdruk. Ishte shumë i ri, ndoshta njëzetë vjeç. Kishte ardhur në Rusi me ushtrinë ruse. U kthye në besim në një takim të fshehtë dhe më kërkoi që ta pagëzoja.

Pas pagëzimit, i kërkova të na tregonte cili varg në Bibël i kishte bërë më tepër përshtypje dhe kishte ndikuar që të vinte te Krishti.

Tregoi se në një prej takimeve tona të fshehta, unë kisha lexuar nga Luka 24, historinë ku Jezusi takon dy dishepujt në rrugën për në Emaus. Kur u afruan afër fshatit, «Ai [Jezusi] tha se do të vazhdonte më tutje» (vargu 28). Piotri tha: «Mendova me vete pse e tha Jezusi këtë. Ai sigurisht që donte të qëndronte me dishepujt e Tij. atëherë, pse tha se donte të vazhdonte më tutje?» Shpjegimi ishte se Jezusi donte të ishte i sjellshëm. Donte të sigurohej që ishte i mirëpritur. Kur pa se ishte i mirëpritur, hyri me kënaqësi në shtëpi me ta. Komunistët nuk janë të sjellshëm. Ata hyjnë me dhunë në zemrat

dhe mendjet tona. Na detyrojnë t'i dëgjojmë nga mëngjesi deri në mbrëmje vonë. E bëjnë këtë përmes shkollave, radiove, gazetave, posterave, filmave, takimeve ateiste dhe ngado që shkojmë. Na duhet të dëgjojmë vazhdimisht propagandën e tyre afetare, na pëlqen apo jo. Jezusi respekton lirinë tonë, troket në derën e zemrës sonë.”

«Jezusi më fitoi me anë të sjelljes së Tij,» – tha Piotri. Ky kontrast i dukshëm midis komunizmit dhe Krishtit e kishte bindur. Ai nuk është i vetmi rus, të cilit i bëri përshtypje ky tipar i karakterit të Jezusit. (Si pastor, nuk e kisha menduar kurrë në këtë mënyrë.)


Pas kthimit në besim, Piotri rrezikoi vazhdimisht lirinë dhe jetën për të kaluar fshehurazi literaturë të krishterë dhe ndihma për kishën e fshehtë nga Rumania në Rusi. Në fund e kapën. Kur dëgjova për herë të fundit për të, ishte ende në burg. A vdiq? A është tashmë në qiell apo po vazhdon luftën në tokë? Nuk e di. Vetëm Perëndia e di se ku ndodhet.

Si Piotri, kishte shumë të tjerë, të cilët nuk ishin thjesht të kthyer në besim. Nuk duhet të reshtim kurrë të fitojmë një shpirt për Krishtin. Në këtë mënyrë kemi bërë vetëm gjysmën e punës. Çdo shpirt i fituar për Krishtin duhet të bëhet edhe vetë fitues shpirttrash. Rusët, jo vetëm që ktheheshin në besim, por bëheshin «misionarë» në kishën e fshehtë. Ishin të palodhur dhe të guximshëm për Krishtin, dhe gjithmonë thoshin se ishte më e pakta që mund të bënin për Krishtin, që vdiq për ta.

Shërbesa jonë e fshehtë ndaj një kombi të skllavëruar

Aspekti i dytë i shërbesës sonë ishte puna misionare midis rumunëve.

Fillimisht, komunistët përdornin mashtrimin për t'i fituar drejtuesit e kishave në anën e tyre, por shumë shpejt e hoqën maskën. Atëherë filloi terrori dhe mijëra vetë u arrestuan. Fitimi i një shpirti për Krishtin filloi të bëhej diçka dramatike edhe për ne, ashtu siç kishte qenë për një kohë të gjatë për rusët.



Për shembull, më vonë u burgosa bashkë me njerëzit, shpirtrat e të cilëve Perëndia më kishte ndihmuar t'i fitoja për Krishtin. Isha në të njëjtën qeli me dikë, që kishte lënë pas gjashtë fëmijë dhe gjendej në burg për besimin e tij të krishterë. Gruaja dhe fëmijët e tij po vdisnin urie. Ai mund të mos i shihte më kurrë. E pyeta: «A ke ndonjë mëri ndaj meje që të solla te Krishti, sepse për këtë arsye familja jote është në gjendje të mjerë?» Ai u përgjigj: «Nuk kam fjalë për ta shprehur falënderimin tim që më solle tek i mrekullueshmi Shpëtimtar. Përndryshe nuk do ta kisha njohur».

Predikimi në këto kushte të reja nuk ishte i lehtë. Njerëzit tanë ishin shumë të shtypur. Komunistët ua morën pronat të gjithëve, fermerëve u morën arat dhe bagëtinë. Berberit apo rrobaqepësit i morën dyqanin. Nuk ishin vetëm kapitalistët që po shpronësoheshin; njerëzit në varfëri të skajshme vuanin shumë. Pothuajse çdo familje kishte një pjesëtar në burg, dhe varfëria ishte e madhe. Njerëzit pyesnin: «Si është e mundur që një Perëndi që është dashuri të lejojë triumfin e së keqes?»

Në të njëjtën mënyrë nuk ishte e lehtë as për apostujt të predikonin Krishtin të premtën e mirë, ndërsa Jezusi vdiq në kryq duke thirrur: «Perëndia im, Perëndia im, pse më ke braktisur?» Por fakti që puna vazhdoi të jepte fryte vërteton se ishte nga Perëndia dhe jo nga ne. Besimi i krishterë ka një përgjigje për pyetje të tilla. Për shembull, Jezusi na ka treguar për Llazarin, një lypsar i varfër, i shtypur, ashtu siç ishim edhe ne të shtypur, duke vdekur, i uritur, me plagët që ia lëpinin qentë, por në fund, engjëjt e çuan në gji të Abrahamit.

Si punonte kisha e fshehtë pjesërisht në fshehtësi


Kisha e fshehtë takohej fshehurazi në shtëpi, në pyje, në bodrume, ku të mundej. Siç është e vërtetë në shumë vende të robëruara sot, kisha e fshehtë në Rumani ishte vetëm pjesërisht e fshehtë. Ashtu si një ajsberg, një pjesë e vogël e punës së saj njihej. Nën sundimin e komunistëve, thurëm një plan për të pasur predikime

në rrugë, gjë që me kalimin e kohës u bë shumë e rrezikshme, por në këtë mënyrë fituam shumë shpirtra, që s'mund të fitoheshin ndryshe. Gruaja ime ishte shumë aktive në këtë drejtim. Disa të krishterë mblidheshin qetësisht në një qoshe në rrugë dhe fillonin të këndonin. Njerëzit mblidheshin rreth tyre për të dëgjuar këngët e bukura, dhe më pas gruaja ime ndante mesazhin. Largoheshim përpara se të vinte policia sekrete.

Një pasdite, ndërsa isha i zënë diku tjetër, gruaja ndau një mesazh para mijëra punëtorëve në hyrje të fabrikës së madhe MALAXA, në qytetin e Bukureshtit. U foli punëtorëve për Perëndinë dhe shpëtimin. Të nesërmen, shumë punëtorë në këtë fabrikë u ekzekutuan pasi u rebeluan kundër padrejtësive të komunistëve. Ata e kishin dëgjuar mesazhin në kohë!

Ne ishim një kishë e fshehtë, por ashtu si Gjon Pagëzori, flisnim hapur me njerëzit dhe qeveritarët për Krishtin. Një herë, në shkallët e një prej ndërtesave të qeverisë sonë, dy vëllezër të krishterë shkuan deri te kryeministri ynë, Georgiu Dej. Në ato pak çaste që patën, i dëshmuuan për Krishtin, duke e nxitur të largohej nga mëkatet dhe persekutimi. Ai i flaku në burg për shkak të dëshmisë së tyre të guximshme. Vite më vonë, kur kryeministri Dej ishte shumë i sëmurë, fara e Ungjillit, që ata kishin mbjellë dhe për të cilën kishin vuajtur shumë, dha fryte. Në kohën e nevojës, kryeministrit iu kujtuan fjalët që i ishin thënë. Ato fjalë ishin, siç thotë Bibla, «e gjallë dhe e fuqishme, dhe më e mprehtë se një shpatë me dy tehe» (Hebrenjve 4:12). Ia zbutën zemrën e ngurtë dhe ai ia dorëzoi jetën Krishtit. Rrëfeu mëkatet, pranoi Shpëtimtarin dhe filloi t'i shërbente Perëndisë gjatë kohës së sëmundjes. Jo shumë kohë më pas, vdiq, por shkoi te Shpëtimtari i tij i sapogjetur dhe kjo sepse dy të krishterë kishin qenë gati të paguanin çmimin. Kjo është tipike e të krishterëve të guximshëm në vendet e robëruara sot.

Ndarja e Ungjillit u bë edhe më e vështirë nën shtypjen e komunistëve, por kishim mundësi të printonim broshura të krishtera, duke i kaluar përmes një censurimi të ashpër të komunistëve. I paraqisnim censuruesit broshura që kishin në faqe të parë një foto



të Karl Marksit, themeluesit të komunizmit, dhe tituj si *Feja është Opium për Popullin*. Ai i konsideronte si botime komuniste dhe vendoste vulën e miratimit. Në këto broshura, pas disa faqeve plot me citime nga Marksi, Lenini dhe Stalini, që kënaqte censuruesin, jepnim mesazhin e Krishtit.

Më pas shkoni në demonstratat komuniste dhe shpërndanim këto «broshura komuniste». Komunistët duke parë fotografinë e Marksit, konkurronin me njëri-tjetrin për t'i blerë. Kur arrinin në faqen e dhjetë dhe zbulonin se kishin të bënë me Perëndinë dhe Jezusin, ne tashmë ishim larguar.

Kështu që, kisha e fshehtë punonte jo vetëm në takime sekrete dhe aktivitete klandestine, por punonte me guxim edhe në shpalljen haptazi të Ungjillit udhëheqësve komunistë dhe përmes mënyrave komuniste. Kishte një çmim për t'u paguar, por ishim të përgatitur për të. Kisha e fshehtë është edhe sot e gatshme për të bërë të njëjtën gjë.

Puna në fshehtësi

Policia sekrete e persekutonte shumë kishën e fshehtë, sepse dallonin tek ajo të vetmen rezistencë që kishte mbetur. Ishte pikërisht lloji i rezistencës (një rezistencë shpirtërore), e cila, nëse nuk pengohej, do të shkatërronte fuqinë e tyre ateiste. E dalluan kërcënimin e menjëhershëm ndaj tyre ashtu siç mund ta bëjë vetëm djalli. E dinin se, nëse dikush besonte te Krishti, nuk do të ishte më njeri pa vullnet apo mendim të vetin. E dinin se mund të burgosnin trupin, por s'mund të burgosnin shpirtin e njeriut, besimin e tij te Perëndia, ndaj e luftonin shumë ashpër.

Por kisha e fshehtë ka simpatizantë dhe anëtarë, madje edhe në qeveritë komuniste apo në policinë sekrete.

Ne udhëzonim të krishterët t'i bashkoheshin policisë sekrete dhe të vishnin uniformën më të urryer në vendin tonë, kështu do të mund të raportonin aktivitetet e policisë sekrete ndaj kishës së fshehtë. Disa vëllezër të kishës së fshehtë vepruan kështu, duke e mbajtur besimin e tyre të fshehtë. Ishte e vështirë për

ta të përbuzeshin nga familja apo miqtë për veshjen e uniformës komuniste dhe të mos zbuloheshin për misionin e tyre të vërtetë, por përsëri e bënin, kaq e madhe ishte dashuria e tyre për Krishtin.

Kur u rrëmbeva nga policia dhe u mbajta i burgosur për vite në fshehtësinë më të madhe, një mjek i krishterë u bë anëtar i policisë sekrete për të mësuar vendndodhjen time! Si një mjek i policisë sekrete, ai kishte të drejtë të hynte në qelitë e të gjithë të burgosurve duke shpresuar të më gjente. Të gjithë miqtë e tij e kishin braktisur, duke menduar se ishte bërë komunist. Të ecësh i veshur me uniformën e torturuesve është sakrificë më e madhe se sa të veshësh uniformën e një të burgosuri.

Mjeku më gjeti në një qeli të errët dhe dërgoi fjalë që isha gjallë. Ai ishte miku i parë që më zbuloi gjatë fillimit të periudhës tetë vjeçare të burgimit! Falë tij, u përhap fjala se isha gjallë, dhe kur të burgosurit u liruan gjatë «zbutjes» së gjendjes midis Ajzenhaurit dhe Krushovit në vitin 1956, të krishterët ngritën zërin për lirim tim. Pas një kohe të shkurtër, u lirova. Nëse nuk do të kishte qenë për këtë mjek, i cili hyri në policinë sekrete posaçërisht për të më gjetur mua, nuk do të isha liruar kurrë. Do të isha ende në burg sot ose në varr.

Duke përdorur pozitën e tyre në policinë sekrete, këta anëtarë të kishës së fshehtë na kanë paralajmëruar shumë herë dhe kanë qenë ndihmë e jashtëzakonshme. Kisha e fshehtë në shtetet komuniste ka njerëz në policinë sekrete, të cilët mbrojnë dhe paralajmërojnë të krishterët për rreziqet që u kanosen. Disa prej tyre janë në majat e qarqeve qeveritare, duke e mbajtur sekret besimin e tyre të Krishti dhe duke na ndihmuar shumë. Një ditë në qiell, ata mund ta shpallin hapur Krishtin, të cilit i shërbejnë tani në fshehtësi.

Megjithatë, shumë anëtarë të kishës së fshehtë u zbuluan dhe u burgosën. Kemi pasur edhe «Judë,» të cilët ia raportonin aktivitetet tona policisë sekrete. Duke përdorur rrahje, drogime, kërcënime dhe shantazhe, komunistët u përpoqën të gjenin pastorë dhe njerëz të thjeshtë, të cilët raportonin për vëllezërit e tyre.

KAPITULLI 2

«Askush nuk ka dashuri më të madhe ...»

Kam punuar si në mënyrë zyrtare, ashtu edhe në fshehtësi deri më 29 Shkurt 1948. Atë të diel të bukur, rrugës për në kishë, u rrëmbeva në rrugë nga policia sekrete.

Kisha pyetur veten shpesh se ç'do të thoshte «grabitje njerëzish,» gjë që përmendet disa herë në Bibël. Komunizmi na e ka mësuar.

Shumë persona në atë kohë rrëmbeheshin në të njëjtën mënyrë. Një furgon i policisë sekrete ndaloi përpara meje, katër burra dolën dhe më shtynë drejt automjetit. Më dërguan në një burg, ku më mbajtën në fshehtësi për tetë vjet. Gjatë asaj kohe, askush nuk e dinte nëse isha gjallë apo vdekur. Policia sekrete i bëri një vizitë gruas sime dhe u shtirën si shokët e mi të burgut. I thanë se kishin marrë pjesë në varrimin tim. Ia copëtuan zemrën.

Mijëra besimtarë nga kishat e të gjitha denominacioneve u burgosën në atë kohë. U burgosën jo vetëm klerikë, por edhe fshatarë të thjeshtë, djem dhe vajza të reja, që dëshmonin për besimin e tyre. Burgjet ishin plot, dhe në Rumani, si në të gjitha vendet komuniste, të ishe në burg do të thoshte të torturoheshe.

Ndonjëherë torturat ishin të tmerrshme. Preferoj të mos flas shumë për atë që kam kaluar, është shumë e dhimbshme. Kur i kujtoj, s'mund të vë më gjumë në sy gjithë natën.

Në librin *Në fshehtësinë e Zotit* rrëfej shumë detaje të përvojave tona me Perëndinë në burg.


Tortura të tmerrshme

Një pastor me emrin Floresku, u torturua me shufra hekuri dhe thika të nxehta. E rrahën shumë. Më pas, minj arash të uritur u dërguan në qeli përmes një tubi të gjerë. S'mund të flinte, sepse i duhej të mbronte veten gjatë gjithë kohës. Nëse e kapte dremitja për një çast, sulmohej nga minjtë.

E detyruan të qëndronte në këmbë për dy javë, natë e ditë. Komunistët donin ta detyronin të tradhtonte vëllezërit e tij, por ai rezistoi me vendosmëri. I sollën të birin katëmbëdhjetë vjeçar në burg dhe filluan ta qëllonin në sy të tij, duke thënë se do të vazhdonin ta rrihnin derisa pastori t'u tregonte çfarë donin. I gjori burrë gati u çmend. Duroi sa mundi, dhe më pas i thirri djalit: «Aleksandër, duhet t'u them atë që duan! S'mund të duroj të të rrahin më!» Djali iu përgjigj: «Baba, mos ma bëj padrejtësinë e të pasurit një tradhtar për baba. Qëndro i fortë! Nëse më vrasin, do të vdes me fjalët: 'Jezus dhe atdheu im'». Komunistët të tërbuar nga zemërimi, iu sulën djalit dhe e rrahën për vdekje, me gjakun që spërkati muret e qelisë. Ai vdiq duke lëvduar Perëndinë. Vëllai ynë i dashur, Floresku, nuk ishte më kurrë i njëjti më pas.

Na vendosnin në kyçe pranga me gozhdë të mprehta në pjesën e brendshme. Nëse nuk lëviznim fare, nuk pritëshim. Por në qelitë e ftohta, kur dridheshim nga të ftohtët, kyçet na bëheshin copë nga gozhdët.

Të krishterët vareshin përmbys në litarë dhe rriheshin aq ashpër saqë trupat e tyre lëkundeshin sa në një anë në tjetrën prej goditjeve. Vendoseshin edhe në kutitë e akullit ndryshe "qelitë frigorifer", të cilat ishin aq të ftohta, ngaqë pjesa e brendshme mbulohej nga akulli. Më hodhën në njërën prej tyre ndërsa isha veshur mjaft hollë. Mjekët e burgut vështronin përmes një të çare dhe kur dallonin simptomat e ngrirjes për vdekje, atëherë jepnin sinjalin dhe rojat hynin brenda për të na marrë e për të na ngrohur. Sapo ngroheshim, na dërgonin përsëri në qelitë e akullta për të ngrirë. Na nxirrnin, e më pas kur ngrinim për vdekje brenda disa minutave, na nxirrnin përsëri dhe kjo gjë përsëritej e përsëritej!



Madje, edhe sot ka raste kur s' duroj dot të hap frigoriferin.

Na detyronin të qëndronim në kuti të drunjta pak më të mëdha se ne. Kjo nuk të linte hapësirë për të lëvizur. Kishte dhjetëra gozhdë nga çdo anë e kutisë me majat e mprehta, që dilnin përmes drurit. Nuk ishte problem kur qëndronim krejt pa lëvizur, por kur detyroheshim të qëndronim në këto kuti për orë të tëra; kur nuk mundeshim më dhe lëkundeshim prej lodhjes, gozhdët na shponin trupin. Nëse lëviznim ndonjë muskul, priteshim.

Ajo çka u kanë bërë komunistët të krishterëve ia tejkalon çdo kuptimi njerëzor! Kam parë komunistët t'u shkëlqente fytyra nga gëzimi kur i torturonin besimtarët. Thërrisnin ndërsa torturonin të krishterët: «Ne jemi djalli!»

Ne nuk luftojmë kundër mishit dhe gjakut, por kundër principatave dhe fuqive të së keqes. Pamë se komunizmi nuk vjen prej njerëzve, por prej djallit. Është një forcë shpirtërore, një forcë e ligë, dhe mund të mundet vetëm nga një forcë më e madhe shpirtërore, Fryma e Perëndisë.

I kam pyetur shpesh torturuesit: «A nuk keni dhembshuri në zemër?» Zakonisht përgjigjeshin me citime nga Lenini: «S'mund të bësh omëletë pa thyer lëvozhgën e vezës» dhe «S'mund të presësh dru pa shpërndarë ashkla». Thosha përsëri: «I njoh këto citime nga Lenini, por ka një ndryshim. Kur pret një copë dru, ai nuk ndjen asgjë. Por këtu ke të bësh me qenie njerëzore. Çdo rrahje shkakton dhimbje dhe ka nëna që vajtojnë». Ishte e kotë. Janë materialistë. Për ta nuk ekziston asgjë përveç materies dhe për ta njeriu është si një copë dru, si një lëvozhgë veze. Me këtë besim, ata zhyten në thellësi të paimaginueshme të mizorisë.

Mizoria e ateizmit është e vështirë për t'u besuar. Kur një njeri nuk beson në shpërblimin e së mirës apo dënimin e së keqes, atëherë nuk ka arsye pse të jetë human. Nuk e pengon asgjë të shprehë gjithë ligësinë që gjendet tek ai. Torturuesit komunistë thoshin shpesh: «Nuk ka Perëndi, nuk ka jetë pas vdekjes, nuk ka dënim për të keqen. Mund të bëjmë çfarë të duam». Dëgjova një torturues të thoshte: «E falënderoj Perëndinë, të cilit nuk i besoj, që kam jetuar deri në këtë orë që të mund të shpreh të

gjithë ligësinë e zemrës sime». E shprehte këtë me një brutalitet të pabesueshëm në torturat ndaj të burgosurve.


Më vjen shumë keq nëse një krokodil ha dikë, por s'mund t'i vë faj krokodilit! Ai nuk është qenie morale. Kështu që s'mund t'u vësh faj komunistëve. Komunizmi ka shkatërruar çdo ndjenjë morale tek ata. Krenohen që nuk kanë asnjë lloj keqardhjeje në zemër.

Mësova prej tyre. Meqenëse nuk lejonin vend për Jezusin në zemrat e tyre, vendosa të mos lija aspak vend në zemrën time për Satanin.

Kam dëshmuar përpara Komitetit të Sigurisë së Brendshme të Senatit të SHBA-së. Kam përshkruar gjëra të tmerrshme, si për shembull të krishterë të lidhur në kryqe për katër ditë e katër net. Kryqet vendoseshin në dysheme dhe qindra të burgosur duhej të kryenin nevojat e tyre personale mbi fytyrën dhe trupat e personave të kryqëzuar. Më pas, kryqet ngriheshin përsëri dhe komunistët talleshin dhe i përbuznin: «Shikojeni Krishtin tuaj! Sa i bukur që është! Çfarë arome sjell prej qiellit!» Përshkrova se si, pasi pothuajse i kishte ikur mendja prej torturave, një prift u detyrua të merrte jashtëqitje njerëzore dhe urinën dhe t'u jepte Darkën e Zotit të krishterëve. Kjo ndodhi në burgun rumun të Pitestit. Më pas e pyeta priftin pse nuk zgjodhi të vdiste se sa të merrte pjesë në këtë tallje. Ai u përgjigj: «Të lutem, mos më gjyko! Kam vuajtur më tepër se Krishti!» Të gjitha përshkrimet biblike të ferrit dhe dhimbjet e ferrit të Dantes s'mund të krahasohen me torturat në burgjet komuniste.

Kjo është vetëm një pjesë e vogël e asaj që ndodhi një të diel dhe në shumë të diela të tjera në burgun e Pitestit. Të tjerat, as që mund të tregohen. Do të më pushonte zemra nëse do t'i tregoja herë pas here. Janë tepër të tmerrshme dhe të neveritshme për t'u shkruar. Ja çfarë kaluan dhe kalojnë tani vëllezërit tuaj në Krishtin!

Nëse do të vazhdoja të tregoja tmerret e torturave të komunistëve dhe gjithë vetësakrificën e të krishterëve, nuk do të reshtja kurrë. Merreshin vesh torturat, por edhe veprat e tyre heroike. Shembujt heroikë të të burgosurve frymëzonin shumë vëllezër që ishin akoma të lirë.



Një prej heronjve vërtet të mëdhej të besimit ishte pastor Milan Haimoviçi.

Të burgosurit ishin të shumtë në numër dhe rojat nuk na njihnin me emër. Thërrisnin ata, që ishin dënuar për të marre njëzetë e pesë fshikullima kamxhiku për thyerjen e disa prej rregullave të burgut. Nuk numërohen rastet kur pastor Haimoviçi shkonte për të marrë rrahjet në vend të dikujt tjetër. Me anë të këtij veprimi fitoi respektin e të burgosurve të tjerë jo vetëm për vete, por për Krishtin që ai shpallte.

Një prej punëtorëve tanë në kishën e fshehtë ishte edhe një vajzë e re. Policia komuniste zbuloi se ajo shpërndante Ungjillin në fshehtësi dhe u mësonte fëmijëve për Krishtin. Vendosi ta arrestonin. Për ta bërë arrestimin sa më agonizues dhe të dhimbshëm, vendosi ta vononin për disa javë, deri në ditën kur do të martohej. Në ditën e dasmës, dita më e mrekullueshme dhe e gëzueshme në jetën e një vajze, kur ajo u vesh nuse, shpërtheu dera dhe policia sekrete hyri brenda.

Kur nusja pa policinë sekrete, zgjati duart drejt tyre për ta prangosur ndërkohë që ata ia vunë prangat në kyçe plot ashpërsi. Hodhi sytë drejt të dashurit të saj, e më pas puthi prangat dhe tha: «Falënderoj dhëndrin tim qiellor për këtë dhuratë të çmuar, që më ka dhënë në ditën e dasmës. E falënderoj që më konsideron të denjë të vuaj për Të». E tërhoqën zvarrë duke lënë pas në vajtim dhëndrin dhe të krishterët e tjerë. Ata e dinin çfarë u ndodhte vajzave të reja të krishtera në duart e rojave komuniste. Dhëndri e priti me besnikëri. Ajo u lirua pas pesë vitesh, tanimë një grua e shkatërruar, e dërrmuar, që dukej tridhjetë vjet më e madhe, por me bindjen se ishte më e pakta që mund të bënte për Krishtin e saj. Të krishterë të tillë të mrekullueshëm gjenden në kishën e fshehtë.

T'i rezistosh indoktrinimit

Perëndimorët kanë dëgjuar ndoshta për indoktrinimin në luftërat në Kore dhe Vietnam. Vetë unë kam kaluar përmes tij. Është tortura më e tmerrshme.


Duhej të uleshim për shtatëmbëdhjetë orë në ditë, për javë, muaj e vite të tëra duke dëgjuar:

Komunizmi është i mirë!
Komunizmi është i mirë!
Komunizmi është i mirë!
Krishtërimi është i kotë!
Krishtërimi është i kotë!
Krishtërimi është i kotë!
Hiq dorë!
Hiq dorë!
Hiq dorë!

Disa të krishterë më kanë pyetur se si mund t'i rezistosh indoktrinimit. Ka vetëm një metodë rezistence ndaj tij: «larja e zemrës». Nëse zemra është e pastruar nga dashuria e Jezu Krishtit, dhe nëse zemra e do Atë, atëherë mund t'u rezistosh të gjitha torturave. Çfarë s'do të bënte një nuse e dashur për dhëndrin? Çfarë s'do të bënte një nënë e dashur për fëmijën e saj? Nëse e doni Krishtin siç e donte Maria, që e mbajti si foshnjë në krahë, nëse e doni Jezusin ashtu si nusja dhëndrin e saj, atëherë mund t'u rezistoni torturave të tilla.

Perëndia nuk do të na gjykojë sipas masës së rezistencës, por sipas dashurisë. Të krishterët që vuanin për besimin e tyre nëpër burgje mund të donin. Jam dëshmitar që ata mund ta donin Perëndinë dhe njerëzit.

Torturat dhe brutaliteti vazhdonin pa reshtur. Kur humbisja ndjenjat apo trullosesha aq shumë saqë torturuesit s'kishin ndonjë shpresë për ndonjë rrëfim nga unë, më kthenin në qeli. Qëndroja atje i shtrirë, pa përkujdesje dhe gjysmë i vdekur për të rifituar pak fuqi që ata të mund të merrshin përsëri me mua. Shumë të burgosur vdisnin në këtë fazë, por në njëfarë mënyre mua më kthehej gjithnjë fuqia. Në vitet që pasuan, në disa burgje të ndryshme, më thyen katër vertebra në shtyllën kurrizore, dhe shumë kocka të tjera. Më prenë në dymbëdhjetë vende. Më dogjën e më bënë tetëmbëdhjetë vrima në trup.



Kur familja ime dhe unë dolëm nga Rumania përkundrejt një pagese dhe na çuan në Norvegji, mjekët në Oslo duke parë këto dhe shenjat në mushkëri prej tuberkulozit, deklaruan se ishte mrekulli që isha gjallë! Sipas librave të tyre mjekësorë, duhej të kisha vdekur që prej katër vjetësh. E di që kjo është mrekulli. Perëndia është Perëndi i mrekullive.

Besoj se Perëndia e bëri këtë mrekulli që ju të mund të dëgjoni zërin tim të thërrasë në emër të kishës së fshehtë në vendet e persekutuar. Ai lejoi njërin të dilte gjallë dhe të shpallte me zë të lartë mesazhin e vuajtjeve tuaja, vëllezër besnikë.

Liri e shkurtër e më pas sërish i arrestuar

Erdhi viti 1956. Kisha tetë vjet e gjysmë në burg. Kisha rënë shumë në peshë, kisha marrë shenja të tmerrshme, më kishin rrahur dhe shkëlmuar brutalisht, më kishin tallur, kisha vuajtur nga uria, më kishin bërë presion, më kishin marrë në pyetje, më kishin kërcënuar dhe më kishin lënë pas dore. Asnjë prej këtyre gjërave nuk kishte dhënë rezultatin që prisnin rrëmbyesit e mi. Kështu që, të shkurajuar dhe në mes protestash kundër burgosjes sime, më liruan.

Më lejuan të kthehesha në pozicionin tim të vjetër si pastor vetëm për një javë. Bëra dy predikime dhe më pas më morën dhe më thanë se s'mund të predikoja më, dhe as të merresha me aktivitete fetare të mëtejshme. Çfarë kisha thënë? I kisha këshilluar besimtarët të kishin «durim, durim dhe më tepër durim». «Pra, po u thua të kenë durim se amerikanët do të vijnë dhe do t'i çlirojnë», – më akuzoi policia. Kisha thënë gjithashtu se, ashtu si kthehet rrota, ndryshojnë edhe kohët. «Po u thua se komunistët nuk do të vazhdojnë të qeverisin! Këto janë gënjeshtra kundërrevolucionare!», – ulërinin ata. Kështu që ky ishte fundi i shërbesës sime publike.

Ndoshta autoritetet besonin se do të kisha frikë t'i kundërshtoja dhe të vazhdoja të jepja dëshmi në fshehtësi. Pikërisht këtu gaboheshin. Në mënyrë të fshehtë dhe me mbështetjen e familjes sime, iu ktheva punës që bëja më parë.

Përsëri u dëshmoja grupeve të fshehta që ishin besnikë, duke lëvizur si fantazma nën mbrojtjen e atyre që mund t'u zihej besë. Këtë herë kisha vurrata për të vërtetuar mesazhin tim për ligësinë e pikëpamjes ateiste, për të inkurajuar shpirtrat e lëkundur për t'i besuar Perëndisë dhe për të qenë të guximshëm. Drejtoja një rrjet sekret ungjilltarësh, që ndihmonin njëri-tjetrin për të ndarë Ungjillin nën sytë e verbër të komunistëve. Për më tepër, nëse një njeri mund të jetë aq i verbër sa të mos shohë dorën e Perëndisë të veprojë, ndoshta s'mund të shohë as atë të një ungjilltari.


Në fakt, interesi i pareshtur i policisë për aktivitetet e mia dhe vendodhjen dha rezultate. U zbulova përsëri dhe më burgosën. Për ndonjë arsye, familjen time nuk e burgosën këtë herë, ndoshta për shkak të gjithë publicitetit që më ishte bërë. Kisha bërë tetë vjet e gjysmë burg dhe më pas dy vjet liri relative. Më burgosën përsëri edhe për pesë vjet e gjysmë.

Burgimi im i dytë ishte në shumë mënyra më keq se i pari. E dija mirë se çfarë më priste. Kushtet fizike u përkeqësuan pothuajse menjëherë, megjithatë vazhduam punën e kishës së fshehtë ku të mundeshim, në burgjet komuniste.

Bëmë një marrëveshje: Ne predikonim dhe ata na rrihnin

Ishte e ndaluar rreptësisht t'u predikojë të burgosurve të tjerë, siç ndodh në vendet e robëruara sot. Dihej që kushdo që kapej duke predikuar, pësonte rrahje të ashpra. Disa prej nesh vendosën të paguanin çmimin e privilegjit të predikimit, kështu që i pranuan kushtet e tyre. Ishte një marrëveshje: ne predikonim dhe ata na rrihnin. Ne ishim të lumtur që predikonim; ata ishin të lumtur që na rrihnin, kështu që të gjithë ishim të lumtur.

Skena e mëposhtme ka ndodhur aq herë, sa që s'mund të llogaritet. Një vëlla po u predikonte të burgosurve të tjerë kur rojat hynë papritur duke i zënë në befasi. E tërhoqën zvarrë përgjatë korridorit për në «dhomën e tyre të rrahjes». Pas një kohe rrahjesh, që dukej sikur s'kishte fund, e sollën dhe e hodhën në dyshemenë e



burgut të përgjakur e të nxirë. Ngadalë, ai ngriti trupin e dërrmuar, rregulloi në dhembje rrobat dhe tha: «Tani, vëllezër, ku e lashë kur na ndërprenë?» Vazhdoi mesazhin e tij të Ungjillit!

Kam parë gjëra të bukura!

Ndonjëherë predikuesit ishin njerëz të thjeshtë, pa pozitë, të frymëzuar nga Fryma e Shenjtë, të cilët shpesh predikonin shumë bukur. Zemra e tyre ishte në Fjalë, sepse të predikojë në kushte të tilla nuk ishte e lehtë. Më pas vinin rojat dhe pasi e nxirrnin jashtë predikuesin e rrihnin gati për vdekje.

Në burgun e Gerlës, një i krishterë i quajtur Grecu, u dënua me rrahje deri në vdekje. Procesi zgjati disa javë, gjatë të cilave ai rrihej shumë ngadalë. Goditej një herë në fund të këmbëve me një shkop gome dhe më pas në ijë. Pas disa minutash rrihej përsëri dhe kjo përsëritej. Rrihej në testikuj. Më pas mjeku i bënte një injeksion. E merrte veten dhe i jepej ushqim i mirë për të rifituar forcat, më pas rrihej përsëri, derisa vdiq gjatë këtyre rrahjeve të ngadalta dhe të përsëritura. Një prej atyre, që kryesonte këtë torturë, ishte një anëtar i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste, emri i të cilit ishte Rek.

Gjatë rrahjeve, Reku i tha diçka Grecut që komunistët ua thoshin shpesh të krishterëve: «E di, unë jam Perëndi. Kam pushtetin e jetës dhe të vdekjes tënde. Ai që ndodhet në qiell s'mund të vendosë për të të mbajtur në jetë. Çdo gjë varet prej meje. Nëse unë dua, ti jeton. Nëse dua, ti vritesh. Jam Perëndi!» Në këtë mënyrë e tallte të krishterin.

Vëlla Grecu, në situatën e tij të tmerrshme, i dha Rekut një përgjigje interesante, të cilën e dëgjova më pas nga vetë Reku. I tha: «Ti nuk e ke idenë se sa gjë të thellë the. Çdo vemje është në të vërtetë një flutur, nëse zhvillohet siç duhet. Ti nuk je krijuar për të qenë torturues, një njeri që vret. Je krijuar për të qenë si Perëndia, me jetën e Tij në zemër. Shumë persekutues si ti, ashtu si edhe Pali, e kanë kuptuar se është e turpshme për njeriun të kryejë krime të shëmtuara, se ata mund të bëjnë gjëra më të mira. Kështu që janë bërë bashkëpjesëtarë të natyrës hyjnore. Jezusi u tha çifutëve të kohës së vet: 'Ju jeni perëndi'.

Më besoni, z. Rek, thirrja jote e vërtetë është të jesh i ngjashëm me Perëndinë, të kesh karakterin e Perëndisë, dhe jo të një torturuesi».


Në atë çast, Reku nuk ua vuri veshin fjalëve të viktimës, ashtu si e shpërfilli Sauli i Tarsit dëshminë e bukur të Stefanit, që u vra në praninë e tij. Por ato fjalë punuan në zemrën e tij dhe Reku e kuptoi më vonë që kjo ishte thirrja e vërtetë.

Mësuam një mësim të rëndësishëm nga të gjitha rrahjet, torturat dhe kasaphanës së komunistëve: që shpirti është padroni i trupit. Ne e ndjenim torturën, por shpesh dukej si diçka e largët dhe shumë larg shpirtit, i cili ishte i përhumbur në lavdinë e Krishtit dhe në praninë e Tij me ne.

Vendosëm ta jepnim të dhjetën edhe kur na jepnin një fetë bukë çdo javë dhe supë të papastër çdo ditë. Çdo javë të dhjetë e merrnim copën e bukës dhe ia jepnim vëllait më të dobët si « dhjeta» jonë për Zotin.

Kur një i krishterë u dënua me vdekje, u lejua të shihte gruan para se të ekzekutohej. Fjalët e tij të fundit ndaj së shoqes ishin: «Duhet ta dish se po vdes duke i dashur ata që më vrasin. Ata nuk e dinë se çfarë bëjnë dhe kërkesa ime e fundit është që edhe ti, t'i duash. Mos mbaj hidhërim në zemër, sepse të vranë njeriun e dashur. Ne do të takohemi në qiell». Këto fjalë i bënë përshtypje oficerit të policisë sekrete, që po ndiqte bisedën e tyre. Më vonë ai më tregoi për këtë histori në një burg, ku e kishin dërguar për shkak se ishte bërë i krishterë.

Në burgun Tirgu-Okna ndodhej një i burgosur i quajtur Matçeviçi. E kishin burgosur që në moshën tetëmbëdhjetë vjeçare. Për shkak të torturave ishte sëmurur rëndë me tuberkuloz. Familja e tij në njëfarë mënyre e mori vesh që ai ishte në gjendje të rëndë shëndetësore dhe i dërgoi qindra shishe streptomisine, që mund të bënin ndryshimin midis jetës dhe vdekjes. Oficeri politik i burgut e thirri Matçeviçin, i tregoi pakon dhe tha: «Këtu është mjekimi që mund të të shpëtojë jetën, por nuk të lejohet të marrësh pako nga familja. Personalisht, do të doja të të ndihmoja. Je i ri. Nuk do të doja të vdisje në burg. Më ndihmo që mund të të ndihmoj!



Më jep informacione kundër të burgosurve të tjerë, kështu mund të justifikohem para eprorëve të mi që të dhashë pakon».

Matçeviçi u përgjigj: «Nuk dua të mbetem gjallë dhe të turpërohem kur të shihem në pasqyrë, sepse do të shoh fytyrën e një tradhtari. S'mund ta pranoj një kusht të tillë. Preferoj të vdes». Oficeri i policisë sekrete i shtrëngoi dorën dhe i tha: «Të përgëzoj. Nuk prisja ndonjë përgjigje ndryshe nga ti. Por do të doja të të bëja një propozim tjetër. Disa prej të burgosurve janë bërë informatorët tanë. Ata thonë se janë komunistë dhe ju denoncojnë. Luajnë një rol të dyfishtë. Nuk u besojmë atyre. Do të donim të dinim se deri në ç'masë janë të sinqertë. Për ty ata janë tradhtarë që po të lëndojnë duke na informuar ne për fjalët dhe veprimet e tua. E kuptoj që nuk dëshiron t'i tradhtosh shokët, por na jep informacion për ata që të kundërshtojnë dhe kështu do të shpëtosh jetën!» Matçeviçi u përgjigj po me aq gatishmëri sa herën e parë: «Unë jam një dishepull i Krishtit dhe Ai na ka mësuar t'i duam edhe armiqtë tanë. Njerëzit që na tradhtojnë na lëndojnë shumë, por s'mund ta shpërblej të keqen me të keqe. S'mund të jap informacion as kundër tyre. Më vjen keq dhe lutem për ta! Nuk dua të kem ndonjë lidhje me komunistët». Matçeviçi u kthye nga diskutimi me oficerin politik dhe vdiq në të njëjtën qeli në të cilën ndodhesha unë. E pashë të vdiste duke lavdëruar Perëndinë. Dashuria mposhti edhe dëshirën e natyrshme për jetën.

Nëse një njeri i varfër është adhurues i muzikës, ai jep edhe monedhën e fundit për të dëgjuar një koncert. Nuk ndihem i mërëzitur që kam humbur kaq vite në burg. Kam parë gjëra të bukura. Kam qenë një ndër heronjtë më të dobët të besimit, por kam pasur privilegjin të jem në të njëjtin burg me shenjtorë të mrekullueshëm, heronj të besimit që mund të barazohen me të krishterët e shekullit të parë. Ata shkuan me gëzim drejt vdekjes për Krishtin. Bukuria shpirtërore e shenjtorëve dhe e heronjve të tillë s'mund të përshkruhet kurrë.

Gjërat që them nuk janë të veçanta. Gjërat e mbinatyrshme janë bërë të natyrshme për të krishterët në kishën e fshehtë, të cilët i janë kthyer dashurisë së parë.


Përpara se të hyja në burg, e doja shumë Krishtin. Tani, pasi kam parë Nusen e Krishtit (Trupin e Tij Shpirtëror) në burg, them se e dua kishën e fshehtë pothuajse po aq sa dua edhe vetë Krishtin. Kam parë bukurinë e saj, shpirtin e saj të sakrificës.

Çfarë i ndodhi gruas dhe djalit tim?

Më larguan prej gruas sime dhe nuk e dija ç'i kishte ndodhur. Vetëm pas shumë vitesh mësova se edhe atë e kishin burgosur. Gratë e krishtera vuanin më shumë se burrat në burg. Vajzat dhunoheshin nga rojat brutalë. Talljet dhe ndyrësitë janë të tmerrshme. Gratë detyroheshin të punonin shumë në ndërtimin e një kanali, duke plotësuar të njëjtën ngarkesë pune si burrat. Punonin me lopatë për të hequr dheun në dimër. Prostitutat bëheshin mbikëqyrëse dhe konkurronin në torturimin e të krishterave. Gruaja ime ka ngrënë bar si bagëtitë për të qëndruar gjallë. Të burgosurat e uritura hanin minj dhe gjarpërinj në këtë kanal. Një nga gjërat që i gëzonte rojat të dielave ishte t'i hidhnin gratë në Danub dhe më pas t'i nxirrnin përsëri, për të qeshur me to, për t'i tallur për trupin e lagur, i hidhnin dhe i nxirrnin përsëri. Gruan time e hodhën në Danub në këtë mënyrë.

Djali im u la të endej rrugëve. Mihai kishte besuar shumë që nga fëmijëria dhe kishte qenë shumë i interesuar për çështjet e besimit. Në moshën nëntë vjeçare, kur prindërit iu morën, kaloi një krizë besimi. U hidhërua dhe vuri në dyshim gjithë besimin e tij. Kishte probleme që nuk i kanë zakonisht fëmijët në moshën e tij. I duhej të mendonte për të siguruar jetesën.

Ishte krim të ndihmoje familjet e martirëve të krishterë. Dy zonja, që e ndihmuan, u arrestuan dhe u rrahën aq keq sa që mbetën të gjymtuara. Një zonjë që rrezikoi jetën dhe e mori Mihain në shtëpinë e saj u dënua me tetë vjet burg për krimin se kishte ndihmuar familjet e të burgosurve. I hoqën dhëmbët dhe i thyen kockat. Edhe ajo mbeti e gjymtuar për gjithë jetën duke mos qenë më kurrë në gjendje të punojë.



«Mihai, besoji Jezusit!»

Në moshën njëmbëdhjetë vjeçare, Mihai filloi të fitonte jetesën si punëtor i përhershëm. Vuajtja kishte shkaktuar tronditje në besimin e tij, por pas dy vitesh burgim të Sabinës, ai u lejua ta takonte. Shkoi në burgun komunist dhe pa të ëmën pas hekurave. Ishte shumë pis, e dobët, me duart tërë kallo, dhe kishte veshur uniformën e shëmtuar të një të burgosure. Me zor e njohu. Fjalët e para të saj ishin: «Mihai, besoji Jezusit!» Rojat, me një tërbim të egër, e tërhoqën larg tij dhe e nxorën jashtë. Kjo ishte minuta e kthimit të tij në besim. Ai e dinte se, nëse Krishti mund të duhej në rrethana të tilla, Ai sigurisht që ishte Shpëtimtari i vërtetë. Ai tregoi më pas: «Nëse Krishtërimi nuk do të kishte ndonjë argument tjetër në favor të tij, atëherë fakti se e ëma besonte në të, i kishte mjaftuar». Kjo ishte dita kur ai e pranoi plotësisht Krishtin.

Në shkollë, kishte një betejë të vazhdueshme për ekzistencë. Ishte nxënës i mirë dhe si shpërblim i dhanë një shall të kuq, shenjë e anëtarësisë në Pionierët e Rinisë Komuniste. Djali im tha: «Nuk do ta vë kurrë shallin e atyre, që kanë futur në burg babanë dhe nënën time». Për këtë u përjashtua nga shkolla. Pasi humbi një vit, hyri përsëri në shkollë, duke e fshehur faktin, që ishte biri i një të burgosuri të krishterë.

Më vonë, iu desh të shkruante një tezë kundër Biblës. Në këtë tezë shkroi: «Argumentet kundër Biblës janë të pakta dhe citimet kundër saj nuk janë të vërteta. Sigurisht që profesori nuk e ka lexuar Biblën. Bibla është në harmoni me shkencën». U përjashtua përsëri. Këtë herë iu desh të humbiste dy vjet shkollë.

Në fund, iu lejua të studionte në seminar. Atje i mësuan «teologjinë Marksiste». Çdo gjë shpjegohej sipas modelit të Karl Marksit. Mihai protestoi hapur në klasë, dhe studentët e tjerë u bashkuan me të. Rezultati ishte përjashtimi, kështu që s'mundi t'i mbaronte studimet teologjike.

Një herë në shkollë, kur një profesor mbajti një fjalim ateist, ai u ngrit dhe kundërshtoi, duke i thënë se çfarë përgjegjësie mbante mbi vete ndërsa drejtonte aq shumë të rinj në rrugë të gabuar.

E gjithë klasa mbajti anën e tij. Ishte e nevojshme që dikush të kishte guximin të fliste i pari, e më pas të gjithë të tjerët t'i mbanin anën. Për t'u arsimuar, ai përpiquej vazhdimisht të fshihte faktin që ishte djali i Vurmbrandit, një i burgosur i krishterë. Por shpesh zbulohet dhe përsëri vinte skena e njohur: thirrej nga zyra e drejtorit të shkollës dhe përjashtohet.

Mihai vuante shumë edhe nga uria. Shumë familje të të krishterëve të burgosur në vendet komuniste vdisnin nga uria. Ishte krim t'i ndihmoje.

Do t'ju tregoj vetëm një rast të një familjeje, që e njoh personalisht. Një vëlla hyri në burg për shkak të punës së tij në kishën e fshehtë. La pas gruan me gjashtë fëmijë. Vajzat e tij më të mëdha, shtatëmbëdhjetë dhe nëntëmbëdhjetë vjeç s'mund të gjenin punë. I vetmi që jep punë në një vend komunist është shteti, dhe ai nuk punëson fëmijë të «kriminelëve» të krishterë. Ju lutem mos e gjykoni këtë histori sipas standardeve morale; merrni vetëm faktet. Dy vajzat e një martiri të krishterë, edhe vetë të krishtera, u bënë prostituta për të siguruar për vëllezërit më të vegjël dhe nënën e sëmurë. Vëllai i tyre më i vogël katërmëdhjetë vjeçar u çmend kur i pa dhe iu desh ta fusnin në një azil. Vite më vonë, kur babai i burgosur u kthye, lutja e tij e vetme ishte: «Perëndi më dërgo përsëri në burg. S'mund të duroj ta shoh këtë gjë». Lutja iu përgjigj dhe ai u burgos përsëri për krimin se u kishte dëshmuar fëmijëve për Krishtin. Vajzat e tij nuk ishin më prostituta, por zunë punë, sepse plotësonin kërkesat e policisë sekrete, duke u bërë informatore. Si vajzat e një martiri të krishterë, mirëpriteshin me nderim në çdo shtëpi. Ato dëgjonin dhe më pas i raportonin çdo gjë policisë sekrete. Mos thoni vetëm që kjo është e shëmtuar dhe imorale, sigurisht që është, por pyeteni veten, a mos vallë është edhe faji juaj që ndodhin tragjedi të tilla, që familje të tilla të krishtera janë lënë vetëm dhe nuk janë ndihmuar nga ju që jeni të lirë!

KAPITULLI 3

Shpengimi dhe lirimi për të punuar në perëndim

Plot katërmbëdhjetë vjet i kalova në burg. Gjatë gjithë kësaj kohe nuk pashë asnjëherë një Bibël apo ndonjë libër tjetër. Kisha harruar si të shkruaja. Për shkak të urisë, drogave dhe torturave, e kisha harruar Shkrimin e Shenjtë. Por në ditën që mbusha katërmbëdhjetë vjet, pavarësisht harresës, më erdhi ndër mend vargu: «Kështu Jakobi shërbeu shtatë vjet për Raketën; dhe iu dukën pak ditë, sepse e dashuronte». Shumë shpejt pas kësaj u lirova përmes një amnistie të përgjithshme, që u dha në vendin tonë, nën ndikimin e opinionit publik amerikan.

E pashë përsëri gruan time. Më kishte pritur me besnikëri për katërmbëdhjetë vjet. Filluam një jetë të re në varfëri, sepse atyre që arrestoheshin u merrej gjithçka.

Priftërinjve dhe pastorëve që u liruan, iu lejua të drejtonin kisha të vogla. Më dhanë edhe mua një kishë në Orsova. Departamenti komunist i kulteve më tha se atje kishte tridhjetë e pesë anëtarë dhe më paralajmëruan që nuk duhej të bëheshin tridhjetë e gjashtë! Më thanë gjithashtu se duhej të isha agjenti i tyre, t'i raportoja policisë për çdo anëtar dhe ta mbaja rininë larg. Ja si i përdorin komunistët kishat si «mjetet» e tyre të kontrollit.

E dija se, nëse predikoja, do vinin shumë për të më dëgjuar. Kështu që nuk u përpoqa asnjëherë të punoja në kishën zyrtare. Përkundrazi, shërbeva përsëri në kishën e fshehtë, duke ndarë gjithë bukurinë dhe rrezikun e kësaj pune.

Gjatë viteve në burg, Perëndia kishte punuar në mënyrë të mrekullueshme. Kisha e fshehtë nuk ishte më e braktisur dhe e

harruar. Amerikanët dhe të krishterë të tjerë kishin filluar të na ndihmonin dhe të luteshin për ne.


Një pasdite, ndërsa po pushoja në shtëpinë e një vëllai në një qytezë provinciale, ai më zgjoi dhe më tha: «Kanë ardhur vëllezër nga jashtë vendit». Në perëndim kishte të krishterë që nuk na kishin harruar apo braktisur. Të krishterët e thjeshtë kishin organizuar një punë të fshehtë në ndihmë të familjeve të martirëve të krishterë, dhe po sillnin fshehurazi ndihma dhe literaturë të krishterë.

Në një dhomë tjetër gjeta gjashtë vëllezër, që kishin ardhur për të bërë këtë punë. Pasi biseduam gjerë e gjatë, më thanë se kishin dëgjuar se në këtë adresë ishte dikush që kishte kaluar katërmbëdhjetë vjet në burg, dhe do të donin ta takonin. U thashë se isha unë ai person. Thanë: «Prisnim të shihnim një njeri melankolik. S'mund të jesh ti ky person, sepse ti je plot gëzim». I sigurova që isha i burgosuri, se isha i gëzuar për shkak të ardhjes së tyre dhe për faktin që nuk ishim më të harruar. Filloi të vinte kështu ndihmë e vazhdueshme në kishën e fshehtë dhe përmes kanalesh sekrete merrnim shumë Bibla dhe literatura të tjera të krishtera, si edhe ndihmë për familjet e martirëve të krishterë. Tani, me ndihmën e tyre, mundëm të punonim në kishën e fshehtë shumë më mirë.

Nuk na dhanë vetëm Fjalën e Perëndisë, por pamë se sa na donin. Na sollën një fjalë ngushëllimi. Gjatë viteve të indoktrinimit, kishim dëgjuar: «Askush nuk ju do më, askush nuk ju do më, askush nuk ju do më». Tani shihnim të krishterë amerikanë dhe anglezë, që rrezikonin jetën për të na treguar se na donin. Më vonë i ndihmuam të zhvillonin një teknikë pune në fshehtësi, që të mund të hynin në shtëpi të rrethuar nga policia sekrete pa u dalluar.

Vlera e Biblave të ardhura fshehurazi në këtë mënyrë s'mund të kuptohet nga një amerikan apo një i krishterë anglez, që «noton» mbi Bibla.

Unë dhe familja ime nuk do të kishim mbijetuar pa ndihmën materiale dhe lutjet e të krishterëve jashtë vendit. E njëjta gjë është e vërtetë për shumë pastorë të kishës së fshehtë dhe martirë



në vendet komuniste. Mund të dëshmoj nga përvoja ime për materialet dhe për më tepër për ndihmën morale që na është dhënë nga misione të veçanta të krijuara për këtë qëllim në botën e lirë. Për ne, këta besimtarë ishin si engjëj të dërguar nga Perëndia!

Për shkak të punës së rifilluar në kishën e fshehtë, isha në rrezik të madh të një arrestimi tjetër. Në këtë kohë, dy organizata të krishtera, Misioni Norvegjez për Çifutët dhe Aleanca e Hebrenjve të Krishterë, i pagoi qeverisë komuniste një shumë prej 10 000 dollarësh për mua, pesëfish më shumë nga çmimi standard i një të burgosuri politik. Tani mund të largohesha nga Rumania.

Pse u largova nga Rumania komuniste

Nuk do të isha larguar nga Rumania, pavarësisht rreziqeve, nëse drejtuesit e kishës së fshehtë nuk do të më kishin urdhëruar ta përdorja këtë mundësi për t'u larguar nga vendi, për të qenë «zëri» i kishës së fshehtë në botën e lirë. Ata dëshironin t'ju flisja juve në botën perëndimore, në emër të tyre për vuajtjet dhe nevojat e tyre. Erdha në perëndim, por zemra ime mbetet me ata. Nuk do të isha larguar kurrë nga Rumania nëse nuk do ta kisha kuptuar nevojën e madhe që ju të dëgjoni për vuajtjet dhe punën e guximshme të kishës së fshehtë, por ky është misioni im.

Përpara se të largohesha nga Rumania, më thirrën dy herë në policinë sekrete. Më thanë se paratë për mua ishin marrë. (Rumania shet qyetarët e vet për para, për shkak të krizës ekonomike që komunizmi ka sjellë në vendin tonë.) Më thanë: «Shko dhe prediko Krishtin sa të duash, por mos na prek ne! Mos thuaj asnjë fjalë kundër nesh! Do të themi sinqerisht se çfarë plani kemi për ty nëse tregon se çfarë ka ndodhur. Së pari, për 1 000 dollarë mund të gjejmë dikë që të të vrasë ose të të rrëmbejë». (Kam qenë në të njëjtën qeli me një peshkop ortodoks, Vasile Leul, i cili ishte rrëmbyer në Austri dhe ishte sjellë në Rumani. Ia shkulën të gjithë thonjtë e duarve. Kam qenë me të tjerë nga Berlioni. Rumunët kanë rrëmbyer edhe nga Italia dhe Parisi. Më thanë më tej: «Mund të të shkatërrojme edhe moralisht duke sajuar dhe bërë publike një

histori tënden me një vajzë, vjedhje apo ndonjë mëkat të rinisë. Perëndimorët, veçanërisht amerikanët, mashtrohen lehtë».

Pasi më kërcënuan, më lejuan të vija në perëndim. Ata ishin shumë të sigurt në indoktrinimin që kishin ushtruar tek unë. Në perëndim, ka shumë persona që kanë kaluar të njëjtat gjëra si unë, por qëndrojnë në heshtje. Disa prej tyre kanë lavdëruar madje komunizmin, pasi kanë qenë torturuar nga komunistët. Komunistët ishin të sigurt se edhe unë do të qëndroja në heshtje.

Kështu që në dhjetor të vitit 1965, unë dhe familja ime u lejuam të largoheshim nga Rumania.

Akti im i fundit para se të largohesha ishte të shkoja te varri i kolonelit që kishte dhënë urdhrin për arrestimin tim dhe kishte urdhëruar vitet e mia të torturave. Vendosa një lule në varrin e tij. Duke vepruar kështu, përkushtova veten për t'ua sjellë gëzimin e Krishtit komunistëve, që janë aq bosh shpirtërisht.

E urej sistemin komunist, por i dua njerëzit. E urej mëkatën, por e dua mëkatarin. I dua komunistët me gjithë zemrën time. Komunistët mund t'i vrasin të krishterët, por s'mund të vrasin dashurinë e tyre, madje edhe ndaj atyre që i vranë. Nuk kam as hidhësinë apo mërinë më të vogël ndaj komunistëve dhe torturuesve të mi.

KAPITULLI 4

Mposhtja e komunizmit me dashurinë e Krishtit

Judenjtë kanë një legjendë, sipas së cilës, kur etërit e tyre u shpëtuan nga Egjipti dhe egjiptasit u mbytën në Detin e Kuq, engjëjt iu bashkuan këngëve të triumfit të kënduara nga izraelitët. Dhe Perëndia u tha engjëjve: «Judenjtë janë njerëz dhe mund të gëzojnë për largimin e tyre, por prej jush pres të kuptoni më tepër. A nuk janë edhe egjiptasit krijesat e mia? A nuk i dua unë edhe ata? Si nuk ndjeni keqardhje për fatin e tyre tragjik?»

Jozueu 5:13 thotë: «Por ndodhi që, ndërsa Jozueu ishte afër Jerikos, ngriti sytë dhe pa, dhe ja, një njeri i qëndronte përpara, me një shpatë të zhveshur, Jozueu i doli përballë dhe i tha: “A je ti për ne o për armiqtë tanë?”».

Nëse ai që takoi Jozueu do të kishte qenë vetëm një njeri, përgjigjja mund të kishte qenë «Jam për ju» ose «Jam për armiqtë tuaj,» ose madje edhe «Jam asnjans». Këto janë të vetmet përgjigje të mundshme për pyetje të tilla. Por kjo qenie që takoi Jozueu ishte nga Perëndia, kështu që kur u pyet nëse Ai ishte pro apo kundër Izraelit, dha një përgjigje që nuk pritej dhe të vështirë për t’u kuptuar: «Jo». Çfarë do të thotë «jo?»


Ai vinte nga një vend, ku nuk ka pro apo kundër, një vend ku të gjithë dhe gjithçka kuptohet, shihet me keqardhje dhe dhembshuri, dhe duhet me dashuri të zjarrtë.

Ka një nivel njerëzor në të cilin komunizmi duhet të luftohet. Në këtë nivel duhet të luftojmë edhe kundër komunistëve, duke qenë mbështetësit e këtij ideali të egër dhe mizor. Por të krishterët janë më tepër se thjesht njerëz; ata janë fëmijët e Perëndisë,

bashkëpjesëtarë të natyrës hyjnore. Kështu që, torturat e duruara në burgjet komuniste nuk më kanë bërë të urrej komunistët. Ata janë krijesa të Perëndisë; si mund t'i urrej ata? Por as miq s'mund të jem me ta. Miqësi do të thotë një shpirt në dy kraharorë. Unë nuk jam një shpirt me komunistët. Ata e urrejnë nocionin e Perëndisë. Unë e dua Perëndinë. Nëse do të më pyesnin:

«A jeni pro komunistëve apo kundër tyre?», përgjigja ime do të ishte komplekse. Komunizmi është një nga kërcënimet më të mëdha të njerëzimit. Jam plotësisht kundër tij dhe dëshiroj ta luftoj derisa të përmbysët. Por, në shpirt, jam ulur në vendet qiellore me Jezusin. Jam ulur në sferën e «jo» – së në të cilën urrehen gjithë krimet e komunistëve, por vetë komunistët kuptohen dhe duhen, një sferë në të cilën ka qenie engjëjlore, që përpiqen t'i ndihmojnë të gjithë të arrijnë qëllimin më të lartë të jetës njerëzore, që do të thotë të bëhesh si Krishti. Kështu që, qëllimi im është t'u shpërndaj Ungjillin komunistëve, t'u jap lajmin e mirë për Krishtin, që është Zoti im, i cili i do komunistët. Ai vetë ka thënë se do çdo njeri dhe që më mirë lë nëntëdhjetë e nëntë dele të drejta se sa të lejojë që ajo që doli jashtë rruge të humbasë. Apostujt e tij dhe të gjithë mësuesit e mëdhenj të Krishtërit e kanë mësuar këtë dashuri universale në emrin e Tij. Shën Makari ka thënë: «Nëse dikush i do të gjithë njerëzit me pasion, por thotë se vetëm njërin s'mund ta dojë, ky njeri nuk është më i krishterë, sepse dashuria e tij nuk është gjithëpërfshirëse». Shën Agustini na mëson: «Nëse i gjithë njerëzimi do të kishte qenë i drejtë dhe do të kishte vetëm një njeri mëkatar, Krishti do të kishte ardhur për të duruar të njëjtin kryq për këtë njeri. Ai i do të gjithë individualisht». Mësimi i krishterë është i qartë. Komunistët janë njerëz dhe Krishti i do ata. Kështu vepron edhe çdo njeri, që ka mendjen e Krishtit. Ne i duam mëkatarët, megjithëse e urrejmë mëkatin.

Ne e njohim dashurinë e Krishtit ndaj komunistëve për shkak të dashurisë sonë ndaj tyre. Kam parë të krishterë në burgjet komuniste me njëzetë kilogramë zinxhirë në këmbë, të torturuar me shufra hekuri të nxehtë, me fytyrë të mbushur me forcë me kripë. I kam parë të liheshin pa ujë, të uritur, të fshikulluar, duke vuajtur nga të



ftohtët dhe sërish duke u lutur me pasion për komunistët. Kjo është e pashpjegueshme nga ana njerëzore! Është dashuria e Krishtit, e cila u derdh në zemrat tona.

Më vonë, komunistët që na torturonin u dërguan në burg. Nën komunizëm, komunistët, madje edhe drejtuesit komunistë, futen në burg pothuajse po aq shpesh sa edhe kundërshtarët e tyre. Tani torturuesit dhe të torturuarit ishin në të njëjtën qeli. Dhe ndërsa jo të krishterët tregonin urrejtje ndaj përndjekësve të tyre të mëparshëm dhe i rrihnin, të krishterët i mbronin, madje duke rrezikuar edhe vetë të rriheshin dhe të akuzoheshin si bashkëpunëtorë me komunizmin. Kam parë të krishterë të jepnin copën e tyre të fundit të bukës (na jepnin vetëm një fetë në javë) dhe ilaçe që të mund të shpëtonin jetën e torturuesit të sëmurë komunist, i cili ishte tani një i burgosur.


Këto janë fjalët e fundit të Luliu Maniut, një i krishterë dhe ish-kryeministri i Rumanisë, i cili vdiq në burg:

«Nëse komunistët përmbysen në vendin tonë, do të jetë detyra më e shenjtë e çdo të krishteri të dalë në rrugë dhe të rrezikojë jetën e vet për t'i mbrojtur nga tërbimi i drejtë i turmave që kanë tiranizuar».

Në ditët e para të kthimit tim në besim, u ndjeva sikur nuk do të mund të jetoja më gjatë. Duke ecur rrugëve, ndieja një dhembje fizike për çdo grua apo burrë që më kalonte pranë. Ishte si një thikë në zemër, kaq përvëluese ishte pyetja nëse ai apo ajo ishin të shpëtuar. Nëse një anëtar i bashkësisë mëkatonte, qaja me orë të tëra. Dëshira për shpëtimin e të gjithë shpirttrave më ka mbetur në zemër dhe komunistët nuk bëjnë përjashtim.

Në qelinë e izolimit, s'mund të luteshim si më parë. Ishim tej mase të uritur, na drogonin derisa sillleshim si idiotë. Ishim pa fuqi dhe kockë e lëkurë. Lutja shembullore ishte shumë e gjatë për ne, s'mund të përqendroheshim për ta thënë. Lutja ime e vetme, që e përsërisja herë pas here ishte: «Jezus, të dua».

Dhe më pas, një ditë të lavdishme mora përgjigje nga Jezusi: «Ti më do? Tani do të të tregoj se sa të dua unë». Menjëherë ndieva



një zjarr në zemër, që digjte si nxehtësia e diellit. Dishepujt për në Emaus thanë se u digjeshin zemrat kur Jezusi u fliste. Kështu ndodhi edhe me mua. E njihja dashurinë e Atij, që dha jetën në kryq për të gjithë ne. Një dashuri e tillë s'mund t'i përjashtojë komunistët, sado të rënda të jenë mëkatet e tyre.


Komunistët kanë kryer dhe vazhdojnë të kryejnë tmerre, por «dashuria është e fortë si vdekja, xhelozia është e ashpër si Sheoli... Ujërat e mëdha nuk do të mund ta shuajnë dashurinë, dhe as lumenjtë s'do mund ta përmbysin». (Kantiku i Kantikëve 8:6,7). Ashtu si edhe varri këmbëngul t'i ketë të gjithë, të pasur e të varfër; të rinj e të moshuar; njerëz nga të gjitha racat, kombet dhe nga të gjitha bindjet politike; shenjtore dhe kriminelë, në të njëjtën mënyrë dashuria është gjithëpërfshirëse. Krishti, dashuria e mishëruar, dëshiron që të gjithë njerëzit të vijnë tek Ai, përfshirë edhe komunistët.

Një pastor, që ishte rrahur shumë rëndë, e flakën në qelinë time. Ishte gjysmë i vdekur, me gjakun që i rridhte nga fytyra dhe trupi. E pastruam. Disa të burgosur mallkuan komunistët. Duke u ankuar nga dhembjet, ai tha: «Ju lutem, mos i mallkoni! Mbani qetësi! Do të doja të lutesha për ata».

Si mundëm të ishim të gëzuar, madje edhe në burg

Kur hedh shikimin pas te katërmbëdhjetë vitet e burgut, kujtoj që shpesh ka qenë një kohë shumë e lumtur. Të burgosurit e tjerë, madje edhe rojat, habiteshin se sa të lumtur mund të ishin të krishterët edhe nën rrethanat më të tmerrshme. S'mund të ndalonim së kënduari, megjithëse rriheshim për këtë. Mendoj se edhe bilbilat do të këndonin, edhe nëse do ta dinin që do të vriteshin për këtë arsye. Të krishterët në burg kërcenin nga gëzimi. Si mund të ishin kaq të lumtur në kushte kaq tragjike?

Meditoja shpesh në burg për fjalët e Jezusit për dishepujt: «Lum sytë që shohin atë që shihni ju» (Luka 10:23). Dishepujt sapo ishin kthyer nga një udhëtim në Palestinë, ku kishin parë tmerre. Palestina ishte vend i shtypur. Kudo kishte mjerim të tmerrshëm të



njerëzve të tiranizuar. Dishepujt u ndeshën me sëmundje, epidemi, uri dhe fatkeqësi. Ata shkuan në shtëpitë e patriotëve të futur në burg, ndërsa linin pas vetes prindër dhe gra duke vajtuar. Nuk ishte botë e bukur për t'u parë.

Përsëri Jezusi tha: «Lum sytë që shohin atë që shihni ju». Kjo për shkak se ata nuk kishin parë vetëm vuajtjen. Kishin parë edhe Shpëtimtarin. Për herë të parë disa krimba të shëmtuar, vemje që zvarriten në gjethe, e kuptuan se, pas kësaj ekzistence të mjerë, vjen një jetë si një flutur e bukur shumëgjyreshe, e aftë për t'u hedhur nga një lule në tjetrën. Kjo ishte edhe lumturia jonë.

Rreth meje gjendeshin «Jobë», disa më të sulmuar se edhe vetë Jobi. Por e dija fundin e historisë së tij, se si ai mori dy herë më tepër nga ç'kishte më parë. Kisha rreth meje njerëz si Llazari, lypsari, të uritur e të mbuluar me plagë. Por e dija që engjëjt do t'i dërgonin në gjirin e Abrahamit. I pashë siç do të ishin në të ardhmen. Te martiri i dobët, i rreckosur dhe i papastër pranë meje shihja shenjtorin e kurorëzuar të së nesërmes.

Duke i parë njerëzit në këtë mënyrë, jo siç janë, por si do të jenë, mund të shoh gjithashtu tek persekutues si Sauli i Tarsit, një apostull Pal të së ardhmes. Dhe disa tashmë janë bërë të tillë. Shumë oficerë të policisë sekrete, tek të cilët dëshmuam, u bënë të krishterë dhe ishin të lumtur të vuanin në burg për shkak se kishin gjetur Krishtin. Megjithëse na qëllonin me kamxhik, po ashtu si Pali, te rojat e burgut shikonim potencialin e rojës në Filipi, i cili u kthye në besim. Ëndërronim që shumë shpejt ata do të pyesnin: «Çfarë duhet të bëj që të shpëtohem?» Tek ata që tallnin të krishterët e lidhur në kryqe dhe i ndotnin me jashtëqitje, shihnim turmën e Golgotës, të cilët më pas rrihnin kraharorin nga frika se kishin mëkatuar.

Burgu na dha shpresën për shpëtimin e komunistëve. Pikërisht aty na u zhvillua një ndjenjë përgjegjësie ndaj tyre. Mësuam t'i donim ndërsa torturoheshim prej tyre.

Pjesa më e madhe e familjes sime u vra. Në shtëpinë time, vrasësi i tyre u kthye në besim. Ishte vendi më i përshtatshëm. Kështu që në burgjet komuniste lindi ideja e misionit të krishterë ndaj komunistëve.


Perëndia i sheh gjërat ndryshe nga ne, ashtu si edhe ne i shohim ndryshe nga një milingonë. Nga këndvështrimi njerëzor, të lidhesh në kryq dhe të të ndotin me jashtëqitje është gjë e tmerrshme. Megjithatë, Bibla i quan vuajtjet e martirëve «trishtim i lehtë». Të jesh në burg për katërmbëdhjetë vjet është periudhë shumë e gjatë. Bibla e quan «vetëm për një moment;» na tregon që këto gjëra «prodhojnë një peshë të pamasë e të pashoqe të amshueshme lavdie» (2 Korintasve 4:17). Kjo na jep të drejtën të supozojmë se krimet e tmerrshme të komunistëve, të cilat janë të pajustificueshme për ne, janë më të lehta në sytë e Perëndisë se sa në sytë tanë. Tirania e tyre, që ka zgjatur pothuase një shekull të tërë, mund të jetë para Perëndisë, për të cilin një mijë vjet janë si një ditë, vetëm një moment i daljes nga udha. Ata kanë ende mundësi të shpëtohen.

Portat e qiellit nuk janë të mbyllura për komunistët. As drita nuk është shuar për ta. Ata mund të pendohen si gjithë të tjerët. Dhe ne duhet t'i thërrasim në pendesë.

Vetëm dashuria mund t'i ndryshojë komunistët dhe terroristët (një dashuri që mund të dallohet qartë nga kompromisi me filozofinë jo të krishtera, të praktikuara nga shumë drejtues kishash). Urrejtja të verbon. Hitleri ishte një antikomunist, por njeri që urrente. Kështu që, në vend që t'i mposhte ata, i ndihmoi të fitonin një të tretën e botës.

Disa drejtues misioni duket se nuk e kanë studiuar shumë historinë e kishës. Si u fitua Norvegjia për Krishtin? Duke fituar mbretin Olaf. Rusia e mori Ungjillin për herë të parë kur mbreti i saj, Vladimiri, u fitua për Krishtin. Hungaria u fitua me Shën Stefanin, mbretin e saj. E njëjta gjë me Poloninë. Në Afrikë, atje ku drejtuesi i fisit është fituar për Krishtin, është fituar i gjithë fisi, sepse fisi e ndjek. Ne i themelojmë misionet fokusuar te njerëzit e thjeshtë, të cilët mund të bëhen të krishterë shumë të mirë, por që nuk kanë shumë ndikim dhe s'mund ta ndryshojnë gjendjen.

Duhet të fitojmë udhëheqësit, drejtues të politikës, ekonomisë, shkencës dhe arteve. Ata i japin formë shpirtit të njeriut. Duke i fituar ata, fitohen drejtuesit dhe njerëzit me ndikim.



Nga pikëpamja misionare, komunizmi ka një avantazh në krahasim me sistemet e tjera shoqërore, sepse është më i centralizuar. Nëse presidenti i SHBA-së beson në mormonizëm, Amerika nuk do bëhet mormone për këtë shkak. Por nëse udhëheqësit komunistë bëhen të krishterë, ndoshta i gjithë vendi mund të arrihet. Kaq i madh është ndikimi i udhëheqësve.

A mund të kthehen këta udhëheqës në besim? Sigurisht, sepse ata nuk janë të lumtur dhe janë të pasigurt, ashtu si viktimat e tyre. Pothuajse të gjithë udhëheqësit komunistë në Rusi përfunduan në burg ose u vranë nga shokët e tyre. E njëjta gjë ndodhi edhe në Kinë. Madje edhe ministrat e Brendshëm si Iagoda, Jezhovi, Beria, të cilët dukej se kishin gjithë pushtetin në dorë, përfunduan si antirevolucionari i fundit: me një plumb në qafë. Vite më parë Shelepin, ministri i Brendshëm i Bashkimit Sovjetik, dhe Rankoviç, ministri i Brendshëm i Jugosllavisë u flakën tutje si rreca të ndotura.

Si mund ta sulmojmë shpirtërisht komunizmin

Regjimi komunist nuk bën askënd të lumtur, as përfituesit e vet. Madje edhe ata dridhen se ndonjë natë furgoni i policisë sekrete mund t'i marrë për shkak se ka ndryshuar linja partiake.

Kam njohur shumë udhëheqës komunistë. Janë njerëz me barrë shumë të rëndë dhe vetëm Jezusi mund t'u japë çlodhje.

Të fitosh udhëheqësit komunistë për Krishtin mund të thotë të shpëtosh botën nga shkatërrimi bërthamor, të shpëtosh njerëzimin nga uria, sepse shumë prej të ardhurave shkojnë për armatime të kushtueshme. Të fitosh udhëheqësit komunistë mund të thotë përfundim të tensionit ndërkombëtar. Të fitosh udhëheqësit komunistë do të thotë të mbushësh me gëzim Krishtin dhe engjëjt e Tij. Shumë zona të tjera në të cilat misionarët punojnë shumë, siç është Guinea e Re apo Madagaskari, mund të ndjekin Krishtin nëse fitohen udhëheqësit komunistë, dhe kjo do t'i japë Krishtërit një vrull krejt të ri.

Kam njohur komunistë të kthyer në besim. Edhe unë vetë isha militant ateist në rininë time. Ateistët dhe komunistët e kthyer në besim e duan shumë Krishtin, sepse kanë mëkatuar shumë.

Në punën misionare është nevoja të mendohet në mënyrë strategjike. Nga pikëpamja e shpëtimit, të gjithë shpirtat janë të barabartë; nga pikëpamja e strategjisë misionare, nuk janë të barabartë. Është më e rëndësishme të fitosh një njeri me ndikim, i cili më pas mund të fitojë mijëra, se sa t'i flasësh një njeriu në xhungël duke siguruar shpëtimin vetëm për të. Kështu që edhe Jezusi zgjodhi ta përfundonte shërbesën e Tij, jo në ndonjë fshat të vogël, por në Jeruzalem, qendra shpirtërore e botës. Për të njëjtën arsye Pali, u përpoq aq shumë të arrinte në Romë.

Bibla thotë se fara e gruas do të shtypë kokën e gjarprit (Zanafilla 3:15). Ne e kilikosim gjarprin në bark, duke e bërë të qeshë. Sot gjarpri vazhdon të zvarritet në Kinë, Korenë e Veriut, Vietnam dhe Laos. Ka shtete në Lindjen e Mesme ku nuk lejohet asnjë ndërtesë kisha.

Gjendja e vështirë e vendeve të tilla të robëruara duhet të vihet re nga drejtuesit e kishave dhe misioneve, si edhe nga çdo i krishterë me logjikë.


Duhet të heqim dorë nga puna rutinë. Është shkruar: «Mallkuar qoftë ai që e bën punën e Zotit shkel e shko» (Jeremia 48:10). Kisha duhet të fillojë një sulm shpirtëror të drejtpërdrejtë kundër principatave në vendet e robëruara. Luftërat fitohen vetëm me anë të sulmit, asnjëherë përmes një strategjie mbrojtjeje.

Psalmi 107:16 thotë se Perëndia ka këputur shufrat prej hekuri. Perdja e hekurt ishte një gjë e vogël për Atë.

Kisha e hershme punonte në fshehtësi dhe triumfoi. Duhet të mësojmë përsëri të punojmë në të njëjtën mënyrë.

Deri në epokën komuniste, nuk e kuptova kurrë pse kaq shumë njerëz në Dhiatën e Re janë quajtur me pseudonime: Simeoni, i cili u quajt Niger, Gjoni u quajt Mark, e kështu me radhë. Ne vazhdojmë të përdorim emrat e fshehtë në punën tonë në vendet e robëruara.

Asnjëherë nuk e kisha kuptuar më parë se pse Jezusi, duke dashur të organizonte darkën e fundit, nuk dha një adresë, por tha: «Shkoni në qyet dhe atje do të takoni një njeri që bart një kanë plot me ujë» (Marku 14:13). Tani e kuptoj. Edhe ne japim sinjale të fshehta njohjeje në punën e kishës së fshehtë.



Nëse biem dakord të punojmë në këtë mënyrë, të kthehemi te metodat e Krishtërit të hershëm, mund të kemi rezultat për Krishtin në këto vende të mbyllura.

Por kur takoj disa drejtues kishash në perëndim, në vend të dashurisë për komunistët, e cila do të kishte çuar kohë më parë në organizimin e punës misionare në vendet komuniste, shoh se politika e tyre është në anën e komunistëve. Nuk e gjeta dhembshurinë e samaritanit të mirë ndaj shpirtrave të humbur të shtëpisë së Karl Marksit.

Një njeri beson vërtet, jo tek ajo që reciton në kredon e tij, por vetëm te gjërat për të cilat është gati të vdesë. Të krishterët e kishës së fshehtë e kanë vërtetuar se janë gati të vdesin për besimin e tyre. Rrjeti ynë ndërkombëtar i misionit vazhdon sot punën sekrete në vendet e robëruara, që do të thotë burgim, tortura dhe vdekje nëse kapen në një vend të tillë. Unë besoj në gjërat që shkruaj.

Kam të drejtën të pyes: A do të ishin gati drejtuesit e kishave në Amerikë që krijojnë miqësi me komunizmin të vdisnin për besimin e tyre? Kush i ndalon ata të heqin dorë nga pozitat e tyre të larta në perëndim për t'u bërë pastorë zyrtarë në lindje, duke u marrë atje, në vend, me komunistët? Prova e një besimi të tillë nuk është dhënë ende nga ndonjë drejtues kisha i perëndimit.

Fjalët njerëzore dalin prej nevojës së njeriut për të kuptuar veten dhe tjetrin si një mënyrë e të shprehurit të ndjenjave ndaj njëri-tjetrit. Nuk ka fjalë njerëzore për t'i shprehur në mënyrë të përshtatshme misteret e Perëndisë dhe lartësitë e jetës shpirtërore. Në të njëjtën mënyrë nuk ka fjalë njerëzore për të përshkruar thellësinë e mizorisë djallëzore. A mund të shprehet me fjalë se çfarë ndjen një njeri, që është gati për t'u hedhur nga nazistët në një furrnaltë apo të shohë fëmijën e tij të hidhet aty?

Kështu që nuk ka vlerë të përpiqemi të përshkruajmë se çfarë kanë vuajtur dhe vuajnë akoma të krishterët nën komunizëm.

Isha në burg me Lukreci Patraskanun, njeriu që solli komunizmin në fuqi në Rumani. Shokët e tij e shpërblyen duke e futur në burg. Megjithëse ishte i shëndetshëm mendërisht, e shtruan në një spital psikiatrik me të çmendur, derisa u çmend edhe ai. Të njëjtën gjë

bënë me Ana Paukerin, ish-Sekretarja e Shtetit. Të krishterëve u jepet shpesh një lloj i ngjashëm trajtimi. I fusin në elektroskok dhe i lidhin me këmisha force.

Bota u tmerrua për atë që ndodhi në rrugët e Kinës. Në sy të të gjithëve, garda e kuqe ushtroi terror. A mund ta imagjini se çfarë u ndodh të krishterëve në një burg kinez, ku askush tjetër nuk sheh! Dëgjova se, kur një shkrimtar i njohur kinez dhe të krishterë të tjerë refuzuan të mohonin besimin e tyre, u prenë veshët, gjuhën dhe këmbët. Të krishterët janë edhe sot në burgjet kineze.

Por më e keqja që bëjnë komunistët nuk është të torturojnë dhe vrasin trupin e njerëzve. Ata shkatërrojnë mendjet e njerëzve dhe helmojnë rininë dhe fëmijët. Kanë vendosur njerëzit e tyre në pozita udhëheqësie në kisha për t'i drejtuar të krishterët dhe për të shkatërruar kishat. U mësojnë të rinjve të mos i besojnë Perëndisë dhe Krishtit, por t'i urrejnë këta emra.


Me çfarë fjalësh mund ta përshkruajmë tragjedinë e martirëve të krishterë, të cilët, pasi u kthyen në shtëpi pas vitesh burgimi, u pritën me përbuzje nga fëmijët e tyre, që ndërkohë ishin bërë ateistë militantë?

Ky libër është shkruar jo aq shumë me bojë, se sa me gjakun e zemrave të përgjakura.

Ashtu si në librin e Danielit, ku tre të rinjtë që ishin hedhur në furrën e zjarrit nuk mbanin erë tymi kur dolën prej saj, kështu edhe të krishterët që kanë qenë në burgjet komuniste nuk mbajnë erë hidhësie kundër komunistëve.

Një lule, nëse e shkel me këmbë, të shpërblen duke të dhënë aromë. Në të njëjtën mënyrë të krishterët, të torturuar nga komunistët, i shpërblenin torturuesit e tyre me dashuri. Ne sollëm shumë prej rojave të burgut të Krishti. Dhe na ka pushtuar një dëshirë: t'u japim komunistëve që na kanë bërë të vuajmë, më të mirën që kemi, shpëtimin që vjen nga Zoti ynë Jezu Krisht.

Si shumë vëllezër në besim, as unë nuk e pata privilegjin e një vdekjeje martiri në burg. U lirova dhe madje munda edhe të dal prej Rumanisë për në perëndim.



Në perëndim gjeta në shumë drejtues kishash ndjenjën e kundërt të asaj që zotëronte kisha e fshehtë në ish-perden e hekurt. Shumë të krishterë në perëndim nuk kanë dashuri për ata në vendet e robëruara. Provë për këtë është se nuk bëjnë asgjë për shpëtimin e tyre. Kanë misione për të bindur të krishterët e një denominacioni të ndryshojnë në një tjetër, por shumë prej tyre nuk kanë misione në vendet e robëruara, duke deklaruar se një punë e tillë është «kundër ligjit!» Ata nuk kanë dashuri për ta. Përndryshe do të kishin krijuar me kohë një mision të tillë, në dukje të pamundur, si Uilliam Keri që i deshi indianët, dhe Hudson Tejlëri kinezët dhe krijuan misionet përkatëse.

Por nuk është mjaft që nuk i duan njerëzit në vendet e robëruara dhe nuk bëjnë asgjë për t'i fituar për Krishtin. Për shkak të vetëkënaqësisë, neglizhencës, dhe ndonjëherë duke vepruar si bashkëpunëtorë, disa drejtues kishash në perëndim forcojnë ateistët në mosbesimin e tyre. Ata i ndihmojnë komunistët të hyjnë në kishat perëndimore dhe të fitojnë udhëheqësi në kishat në botë. I ndihmojnë të krishterët të mbeten të pavetëdijshëm për rrezikun e komunizmit.

Duke mos i dashur komunistët dhe njerëzit në vendet e tjera të robëruara, dhe duke mos bërë asgjë për t'i fituar për Krishtin (nën preteksin se nuk lejohen të veprojnë në këtë mënyrë, sikur të krishterët e parë kërkuan leje nga Neroni për të shpërndarë Ungjillin), drejtuesit e kishës perëndimore nuk e duan as tufën e tyre, nëse nuk i lejojnë të marrin pjesë në këtë betejë shpirtërore rreth botës.

Mësimet e historisë shpërfillen

Në shekujt e parë, Krishtërimi lulëzoi në Afrikën e Veriut. Prej andej erdhi Shën Agustini, Shën Sipriani, Shën Athanasi dhe Tertuliani. Të krishterët e Afrikës së Veriut lanë pas dore vetëm një detyrë: të fitonin muhamedanët për Krishtin. Rezultati ishte që muhamedanët pushtuan Afrikën e Veriut dhe çrënjosën Krishtërimin. Afrika e Veriut u përket edhe sot myslimanëve, dhe

tani quhet nga misionet e krishterë «blloku i të pakthyeshmëve». Le të mësojmë diçka nga historia!


Në kohën e reformimit, interesat fetare të Husit, Luterit dhe Kalvinit përputheshin me interesat e evropianëve për të hequr qafe zgjedhën e Papës, e cila në atë kohë ishte një fuqi shtypëse politike dhe ekonomike. Në të njëjtën mënyrë, edhe sot, interesat e kishës së fshehtë në shpalljen e Ungjillit regjimeve tirane dhe viktimave të tyre përputhen me interesin jetësor të të gjithë popujve të lirë për të vazhduar së jetuari në liri.

Shumë tiranë kanë armë bërthamore; për t'i sulmuar ushtria duhet të fillojë një luftë të re botërore me qindra miliona viktima. Shumë udhëheqës perëndimorë janë indoktrinuar, madje nuk dëshirojnë që udhëheqës të tillë të përmbysen. E kanë thënë shumë shpesh. Dëshirojnë që varësia ndaj drogës, dhuna, kanceri dhe tuberkulozi të zhduken, por jo sisteme dashakeqe si komunizmi, i cili ka shkaktuar më tepër viktima se të gjitha këto të marra së bashku.

Ilia Ehrenburg, shkrimtar sovjetik, thotë se, nëse Stalini nuk do të kishte bërë asgjë tjetër në jetën e tij, veçse të kishte shkruar emrat e viktimave të tij të pafajshme, nuk do t'i kishte mjaftuar jeta për ta përfunduar punën. Në Kongresin e njëzetë të Partisë Komuniste Krushovi tha: «Stalini likuidoi mijëra komunistë të ndershëm dhe të pafajshëm... Nga njëqind e tridhjetë e nëntë anëtarë dhe kandidatë të Komitetit Qendror që u zgjodhën në Kongresin e shtatëmbëdhjetë, nëntëdhjetë e tetë, pra shtatëdhjetë për qind, më vonë u arrestuan dhe u vranë».

Merreni me mend tani se çfarë u ka bërë të krishterëve. Krushovi hodhi poshtë Stalinin, por vazhdoi të bënte të njëjtën gjë. Që në vitin 1959, gjysma e kishave të Rusisë Sovjetike që mbetën hapur, u mbyllën.

Në Kinë, valë barbarizmi u ngritën më keq se sa ato në periudhën e Stalinin. Jeta e dukshme e kishës pushoi plotësisht. Në Rusi dhe Rumani kishte arrestime të reja. (Pas rënies së komunizmit në Bashkimin Sovjetik, qeveria pranoi arrestimet në masë të të krishterëve në Rusi).



Nëpërmjet terrorit dhe mashtrimit, në vendet me një miliardë banorë, një brez i tërë i rinisë është rritur me urrejtje ndaj çdo gjëje perëndimore dhe veçanërisht urrejtje ndaj Krishtërit.

Nuk ishte pamje e pazakontë në Rusi të shihje oficerët lokalë të qëndronin përpara kishave, duke ruajtur nëse kishte ndonjë fëmijë. Ata që shkonin në kishë rriheshin dhe flakeshin jashtë. Shkatërruesit e ardhshëm të Krishtërit perëndimor u rritën me kujdes dhe rregull!

Ka vetëm një forcë që mund t'i ndryshojë qeveritë e këqija. Është e njëjta forcë që i aftësoi shtetet e krishtera t'i zinin vendin perandorisë pagane romake, forca që i bëri të krishterë barbarët teutonë dhe vikingët, forca që përmbysi inkuizicionin e përgjakshëm. Kjo është fuqia e Ungjillit, e përfaqësuar nga kisha e fshehtë, që punon në të gjitha vendet e robëruara.

Të mbështesësh kishën dhe ta ndihmosh atë nuk është vetëm çështje uniteti me vëllezërit tanë që vuajnë. Do të thotë jetë apo vdekje për vendin tënd dhe për kishat tuaja. Të mbështesësh këtë kishë nuk është vetëm në interesin e të krishterëve të lirë, por duhet të jetë gjithashtu politika e qeverive të lira. Kisha e fshehtë i ka fituar tashmë qeveritarët komunistë për Krishtin. Georgiu Dej, kryeministër i Rumanisë, vdiq në besim pasi rrëfeu mëkatet dhe ndryshoi jetën e tij mëkatore. Në shumë vende të robëruara ka anëtarë të qeverisë, që janë të krishterë të fshehtë. Kjo mund të marrë përhapje të gjerë. Atëherë do të mund të presim ndryshim të vërtetë në politikën e disa qeverive, jo ndryshime si ato të Titos dhe Gomulkës, pas së cilave e njëjta diktaturë e një partie mizore ateiste vazhdoi, por me një kthesë drejt Krishtërit dhe lirisë.

Tani ekzistojnë mundësi të mrekullueshme për këtë.

Ata që besojnë në komunizëm, të cilët shumë shpesh janë të sinqertë në atë që besojnë ashtu siç janë të krishterët në besimin e tyre, po kalojnë një krizë të rëndë. Ata besonin vërtet se komunizmi do të krijonte vëllazëri midis kombeve. Tani e shohin se vendet komuniste janë shkatërruar ashtu si vendet e bllokut lindor.

Ata besonin vërtet se komunizmi do të krijonte një parajsë tokësore, në kundërshtim me atë që e quajnë parajsë iluzionare

në qiell. Dhe tani njerëzit e tyre janë të uritur. Gruri duhet të importohet nga vendet kapitaliste. I tillë është rasti me urinë në Korenë e Veriut. E konsideruar një prej vendeve më të izoluar në botë, Korea e Veriut, aktualisht është në prag të një shkatërrimi të plotë. Përmytjet kanë shkatërruar të mbjellat, duke shfarosur furnizimin e tyre me ushqim. Tani, për shkak të dëshpërimit, Korea e Veriut ka filluar të hapë dritaret dhe dyert që pjesa tjetër e botës të hedhë një vështrim mbi atë që ndodhet pas telave me gjemba.


Komunistët kishin besuar tek udhëheqësit e tyre. Tani lexojnë nëpër gazeta se Stalini ishte vrasës në masë dhe Krushovi një idiot. E njëjta gjë me heronjtë e tyre kombëtarë si Rakosi, Gero, Ana Pauker, Rankoviçi dhe kështu me radhë. Komunistët nuk besojnë më në pagabueshmërinë e udhëheqësve të tyre. Janë si katolikët pa një Papë.

Ka një boshllëk në zemrat e tyre. Boshllëku mund të mbushet vetëm nga Krishti. Natyrshëm, zemra njerëzore kërkon Perëndinë. Ka një boshllëk shpirtëror te çdo njeri derisa mbushet nga Krishti. Kjo është e vërtetë për komunistët dhe për të gjithë ata, që ndodhen në vende të tjera të robëruara. Tek Ungjilli gjendet fuqia e dashurisë që mund t'i tërheqë. E kam parë të ndodhë. E di që mund të ndodhë.

Të krishterët, të tallur dhe të torturuar nga komunistët, kanë harruar dhe kanë falur çfarë u është bërë atyre personalisht dhe familjeve të tyre. Ata bëjnë të pamundurën për t'i ndihmuar komunistët të kalojnë krizën dhe të gjejnë rrugën drejt Krishtit. Për këtë punë, kanë nevojë për ndihmën tonë.

Dhe jo vetëm për këtë. Dashuria e krishterë është gjithnjë universale. Me të krishterët, nuk ka anësi. Jezusi tha se dielli i Perëndisë del mbi të mirët dhe të këqijtë. Kjo është e vërtetë edhe për dashurinë e krishterë.

Ata drejtues të krishterë në perëndim, të cilët tregojnë miqësi ndaj komunistëve dhe regjimeve të tjera tiranike e justifikojnë këtë me mësimin e Jezusit, sipas të cilit duhet t'i duam armiqtë tanë. Por Jezusi nuk mësoi asnjëherë se duhet t'i duam armiqtë tanë dhe të harrojmë vëllezërit.



Ata e tregojnë «dashurinë» e tyre duke darkuar me ata, që i kanë larë duart me gjakun e të krishterëve, duke mos u dhënë atyre lajmin e mirë të Krishtit. Ata që shtypen nga tiranët harrohen. Nuk ka dashuri për ta.

Disa dekada më parë, kishat ungjillore dhe katolike të Gjermanisë Perëndimore dhanë 125 milionë dollarë për të uriturit. Të krishterët amerikanë dhanë edhe më shumë.

Ka shumë njerëz të uritur, por s'mund të imagjinoj dikë më të uritur apo më të përshtatshëm për t'u ndihmuar nga të krishterët e lirë se sa martirët e krishterë. Nëse kishat gjermane, britanike, amerikane dhe skandinave mbledhin kaq shumë para për ndihmë, ajo duhet të shkojë për këdo që është në nevojë, por së pari për martirët e krishterë dhe familjet e tyre.

A ndodh kështu tani?

Unë u shpengova nga organizatat e krishtera, kjo vërteton se të krishterët mund të shpengohen. Megjithatë, unë mund të jem rasti i vetëm në Rumani. Dhe fakti i shpengimit tim do t'i akuzojë të krishterët e organizatave në perëndim për lënien pas dore të përmbushjes së detyrës së tyre në raste të tjera.

Të krishterët e parë pyesnin veten nëse kisha e re ishte vetëm për hebrenjtë apo edhe për johebrejtë. Pyetja mori përgjigjen e duhur. Në një formë tjetër, problemi është rishfaqur në shekullin e njëzetë. Krishtërimi nuk është vetëm për perëndimin. Krishti nuk i përket vetëm Amerikës, Anglisë dhe shteteve të tjera demokratike. Kur Ai u kryqëzua, një prej duarve të Tij ishte shtrirë drejt perëndimit, dhe tjetra drejt lindjes. Ai dëshiron të jetë mbreti jo vetëm i hebrenjve, por edhe i johebrejve, i komunistëve dhe i botës perëndimore. Jezusi tha: «Shkoni në mbarë botën dhe predikojini Ungjillin çdo krijese» (Marku 16:15).

Ai dha gjakun e Tij për të gjithë, dhe të gjithë duhet ta dëgjojnë dhe ta besojnë Ungjillin.

Ajo çka na inkurajon të predikojmë Ungjillin në vendet e robëruara është se ata që bëhen të krishterë janë plot dashuri dhe zell. Asnjëherë nuk kam parë, qoftë edhe një të krishterë të vetëm

rus të jetë i vakët në besim. Ish- komunistët e rinj dhe myslimanët bëhen dishepuj të jashtëzakonshëm të Krishtit.

Krishti i do këta njerëz dhe dëshiron t'i çlirojë, sepse Ai i do të gjithë mëkatarët dhe dëshiron t'i çlirojë nga mëkati. Disa drejtues kishash në perëndim e zëvendësojnë këtë, qëndrimin e vetëm të duhur, me një tjetër: me përkrahje ndaj persekutuesve të krishterëve. Ata favorizojnë mëkatarët, duke ndihmuar persekutuesit të ruajnë pushtetin dhe të pengojnë shpëtimin e vetë atyre dhe të viktimave të tyre.


Çfarë gjeta pas liritim tim

Kur u bashkova me gruan pas liritim nga burgu, ajo më pyeti se çfarë planesh kisha për të ardhmen. U përgjigja: «Ideali që kam para meje është jeta e një veçimi shpirtëror». Gruaja m'u përgjigj se edhe ajo kishte pasur të njëjtin mendim.

Kisha qenë shumë dinamik në rininë time. Por burgu, dhe veçanërisht vitet në qelinë e izolimit, më kishin transformuar në një njeri meditues. Të gjitha stuhitë e zemrës ishin fashitur. Nuk e kisha problem komunizmin, madje as që e vija re. Ndihesha i rrethuar nga përqaqimet e Dhëndrit qiellor dhe lutesha për ata, që na torturonin duke i dashur me gjithë zemër.

Kisha shumë pak shpresa për t'u liru. Herë pas here mendoja se çfarë do të bëja nëse lirohesha. E konsideroja gjithmonë që të pushoja diku dhe të vazhdoja jetën e bashkimit të ëmbël në shkretëtirë me Dhëndrin qiellor.

Perëndia është «E Vërteta», Bibla është «e Vërteta rreth së Vërtetës». Teologjia është «e vërteta e së vërtetës rreth së vërtetës». Të krishterët jetojnë në kaq shumë të vërteta rreth së Vërtetës, dhe për shkak të tyre, nuk kanë «Të Vërtetën». Të uritur, të rrahur, të droguar, e kishim harruar teologjinë dhe Biblën. I kishim harruar «të vërtetat rreth së Vërtetës», kështu që jetonim në «Të Vërtetën». Është shkruar: «Biri i Njeriut do të vijë në një orë kur nuk e prisni» (Mateu 24:44). Ne s'mund të mendonim më. Në orët më të errëta të torturave, Biri i Njeriut erdhi te ne, duke i bërë muret e burgut



të ndriçonin si diamante dhe të mbushnin qelitë me dritë. Diku larg, ndjenim zbehtë vetëm fizikisht torturuesit tanë, por shpirti gëzonte në Zotin. Nuk do të kishim hequr dorë nga ky gëzim as për pallatet mbretërore.

Dëshira për të luftuar kundër dikujt apo diçkaje as që më shkonte ndër mend. Nuk kisha dëshirë të luftoja ndonjë luftë, çfarëdoj lufte. Dëshiroja më tepër të ndërtoja tempuj të gjallë për Krishtin. U largova nga burgu me shpresën e viteve të qeta të meditimit.

Por, që prej ditës së lirimit, u përballa me aspektet e komunizmit më të shëmtuara se të gjitha torturat e burgimit. Takova njëri pas tjetrit predikues të mëdhenj dhe pastorë të kishave të ndryshme, madje edhe peshkopë, të cilët thjesht rrëfenin me keqardhje të madhe se ishin informatorë të policisë sekrete kundër bashkësisë së tyre. I pyeta nëse ishin të përgatitur të hiqnin dorë, madje edhe nën rrezikun e burgimit, të gjithë u përgjigjën «jo,» dhe shpjeguan se nuk ishte frika për veten që i pengonte. Më treguan për zhvillimet e reja në kisha, gjëra që nuk ekzistonin para arrestimit tim, që të refuzoje të ishe informator do të thoshte të mbyllej një kishë.

Në çdo qytet kishte një përfaqësues të qeverisë për kontrollin e «kulteve,» një njeri i policisë sekrete komuniste. Ai kishte të drejtë të thërriste këdo prift apo pastor kur të dëshironte dhe e pyeste se kush kishte qenë në kishë, kush e merrte Darkën e Zotit, kush ishte i zellshëm në besim, kush ishte fitues shpirtrash, çfarë rrëfenin njerëzit, dhe kështu me radhë. Nëse nuk përgjigjeshin, pushoheshin dhe një «pastor» tjetër, i cili do të tregonte më tepër, vendosej në vendin e tij. Kur përfaqësuesi i shtetit nuk mund të bënte një zëvendësim të tillë (e cila nuk ndodhte pothuajse kurrë), ai thjesht mbyllte kishën. Kjo ndodh sot në Kinë.

Shumica e drejtuesve të kishave i jepnin informacione policisë sekrete. Disa vepronin pa dëshirë, duke përpjekur të fshihnin disa gjëra, ndërsa të tjerët e bënë të udhës duke e ngurtësuar ndërgjegjen. Disa të tjerë e bënë me pasion dhe tregonin më tepër se ç'u kërkohej.

Kam dëgjuar rrëfime nga fëmijët e martirëve të krishterë, të cilët kishin qenë të detyruar të jepnin informacion për familjet që i kishin mirëpritur, përndryshe kërcënoheshin të mos vazhdonin studimet.

Shkova në Kongresin e Baptistëve, e cila ishte nën shenjën e flamurit të kuq, ku komunistët kishin vendosur se cilët do të ishin «drejtuesit e përzgjedhur». E dija se drejtuesit e të gjitha kishave zyrtare ishin njerëz të emëruar nga Partia Komuniste. Më pas e kuptova se po shihja neverinë për të cilën foli Jezusi.

Gjithmonë ka pasur pastorë dhe predikues të mirë dhe të këqij, por tani për herë të parë në historinë e kishës, Komiteti Qendror i një partie të betuar ateiste, e cila siç ka deklaruar edhe vetë, ka qëllim çrrënjosjen e fesë, vendos se kush e drejton kishën. Për çfarë qëllimi ta drejtosh? Sigurisht për të ndihmuar në çrrënjosjen e fesë.


Lenini ka shkruar:

«Çdo ide fetare, çdo ide e Perëndisë, madje edhe të luash me idenë e Perëndisë, është ndyrësia më e papërshkrueshme e llojit më të rrezikshëm, sëmundje ngjithëse e llojit më të neveritshëm. Miliona mëkate, veprime të ndyra, akte dhune dhe sëmundjet fizike janë shumë më pak të rrezikshme se ideja e vagët shpirtërore e një Perëndie».

Partitë Komuniste të Bashkimit Komunist ishin leniniste. Për ta, feja ishte më keq se kanceri, tuberkulozi apo sifilizi. Ata vendosnin se cilët duhej të ishin drejtuesit fetarë. Drejtuesit e kishave zyrtare bashkëpunonin pak a shumë duke u komprometuar me ta.

Kam parë helmimin e fëmijëve dhe të rinisë me atezimin, dhe kishat zyrtare duke mos pasur as më të voglën mundësi për të kundërvepruar. Në asnjë kishë në kryeqytetin tonë të Bukureshtit s'mund të gjeje një takim të rinjsh apo shkollë të së dielës për fëmijë. Fëmijët e të krishterëve rriten në shkollën e urrejtjes.

Më pas, duke qenë dëshmitar i gjithë kësaj, e urreva komunizmin siç nuk e kisha urreyer nën torturat e tyre.



E urreja jo për shkak të asaj që më kishte bërë mua, por për shkak të së keqes që i shkaktonte lavdisë së Perëndisë, emrit të Krishtit, dhe shpirttrave të një miliard njerëzve nën dominimin e tij.

Fshatarë nga i gjithë vendi erdhën për të më takuar dhe më thanë se si kishte ndodhur kolektivizimi. Ata ishin tani skllëvër të uritur në vetë ish-fushat dhe vreshtat e tyre. Nuk kishin as bukë. Fëmijët e tyre nuk kishin qumësht, fruta, dhe kjo në një vend me pasuri natyrore, që mund të krahasohet me Kananin e lashtë.

Vëllezërit më rrëfyan se regjimi komunist i Leninit i kishte bërë hajdutë dhe gënjeshtarë. Prej urisë u duhej të vidhnin nga ajo që kishte qenë në fillim fusha e tyre, por që tani ishte pronë e përbashkët. Më pas u duhej të gënjenin për të mbuluar vjedhjen e tyre.

Punëtorët më treguan për terrorin në fabrika dhe për shfrytëzimin e fuqisë punëtore në atë mënyrë që kapitalistët as që do ta kishin ëndërruar. Punëtorët nuk e kishin të drejtën e grevës.

Intelektualëve u duhej të mësonin se nuk kishte Perëndi kundër bindjeve të tyre.

E gjithë jeta dhe mendimet e një të tretës së botës në atë kohë u shkatërruan, siç bëhet akoma sot në vendet e izoluara.

Vajza të reja erdhën dhe u ankuan se ishin thirrur nga Organizata Rinore Komuniste, ku ishin qortuar dhe kërcënuar se kishin puthur djem të krishterë. Pas kësaj u kishin dhënë emra të tjerë që mund t'i puthnin!

Çdo gjë ishte tmerrësisht false dhe e shëmtuar.

Më pas takova luftëtarët e kishës së fshehtë, shokët e kohëve të mëparshme, disa prej të cilëve kishin mbetur pa u kapur dhe të tjerë që kishin rifilluar përsëri përpjekjet pasi ishin liruar nga burgu. Ata më telefonuan për të rifilluar luftën bashkë me ta. Ndoqa takimet e tyre të fshehta, ku këndoheshin këngë nga një libër himnesh i shkruar me dorë.

Më erdhi ndër mend Shën Antoni i Madh, i cili kishte qenë në shkretëtirë për tridhjetë vjet. Kishte braktisur botën, duke e kaluar gjithë jetën në agjërim e lutje. Por kur dëgjoji për luftën midis Shën Athanasit dhe Ariusit për hyjninë e Krishtit, e braktisi jetën

medituese dhe shkoi në Aleksandri për të ndihmuar që e vërteta të triumfojë. Më kujtohet Shën Bernardi i Klairvoksit, (Clairvaux) i cili ishte murg lart në male. Por dëgjoi për budallallëkun e kryqëzatave, për të krishterët që vrisnin arabët dhe çifutët e vëllezërit në besim të një lloji tjetër, për të fituar një varr bosh. U largua nga manastiri i tij dhe zbriti nga lartësitë për të predikuar kundër kryqëzatave.


Vendosa të bëj atë që duhet ta bëjnë të gjithë të krishterët: që ndjekin shembullin e Krishtit, të apostullit Pal dhe shenjtorëve të mëdhenj; të hiqja dorë nga dalja në pension dhe të rifilloja luftën. Çfarë lloj lufte do të ishte?

Të krishterët në burgje janë lutur gjithmonë për armiqtë e tyre dhe u kanë dhënë një dëshmi të bukur. Dëshira e zemrës sonë ishte që ata të shpëtoheshin dhe gëzonim sa herë që ndodhte. Por e urreja ligësinë e sistemit komunist dhe dëshiroja të forcoja kishën e fshehtë, forca e vetme që mund ta përmbyste këtë tirani të tmerrshme, me anë të fuqisë së Ungjillit.

Nuk mendoja vetëm për Rumaninë, por edhe për të gjithë botën komuniste. Megjithatë, në përfundim nuk e kam hasur aspak këtë shqetësim.

Shkrimtarët anëmbanë botës protestuan kur dy shkrimtarët komunistë, Siniavski dhe Daniel, u dënuan me burgim nga vetë shokët e tyre, ndërkohë që as kishat nuk protestojnë kur të krishterët burgosen për besimin e tyre.

Kush kujdeset për vëlla Kuzukun, i dënuar sepse kreu krimin e shpërndarjes së botimeve «helmuese» të krishtera, si pjesë nga Bibla dhe librushka përkushtimi të Toreit? Kush e njeh vëlla Prokofievin, i dënuar sepse shpërndau predikime të printuara? Kush e njeh Grunvaldin, një i krishterë hebre i dënuar për akuza të ngjashme në Rusi, të cilit komunistët i morën edhe djalin? E di se çfarë ndieva kur më larguan nga Mihai im dhe vuaj me vëlla Grunvaldin, Ivanenkon, Grani Shevçuk, Taisia Tkaçenkon, Ekaterina Vekazinan, Georgi Vekazin, çiftin Pilat në Lituani, dhe kështu me radhë emrat e heronjve të besimit në shekullin njëzetë e një! Përulëm të puth prangat e tyre, ashtu si të krishterët e parë



puthën prangat e bashkëbesimtarëve të tyre kur çoheshin për t'u hedhur përpara kafshëve të egra.

Disa drejtues kishash në perëndim as që e vrasin mendjen për ta. Emrat e martirëve nuk janë në listën e tyre të lutjeve. Ndërsa ata torturoheshin dhe dënoheshin, drejtuesit zyrtarë ortodoksë dhe Baptistë rusë, që i kishin denoncuar dhe i kishin tradhtuar u pritën me nderim të madh në Nju Delhi, në Gjenevë dhe në konferenca të tjera. Ata i siguruan të gjithë se në Rusi kishte liri të plotë besimi.

Një drejtues i Këshillit Botëror të Kishave e puthi peshkopin bolshevik, Nikodem, kur u dha këtë siguri. Më pas morën pjesë së bashku në banket nën emrin e detyruar të Këshillit Botëror të Kishave, ndërsa shenjtorët në burgje hanin lakër me të brendshme të palara, ashtu siç kisha ngrënë edhe unë në emër të Jezu Krishtit.

Gjërat s'mund të mbeteshin kështu. Kisha e fshehtë vendosi që unë duhej të largohesha nga vendi nëse më jepej mundësia, që të informoja të krishterët në perëndim për atë që po ndodhte.

Kam vendosur të denoncoj komunizmin, megjithatë i dua komunistët. Nuk më duket e drejtë të predikoj Ungjillin pa denoncuar komunizmin.

Disa më thonë «Prediko Ungjillin e pastër!» Kjo më sjell ndër mend policinë sekrete, ndërsa më thoshte të predikoj Krishtin, por të mos e përmendja komunizmin. A është vërtet kështu, që ata që janë për atë që quhet «Ungjill i pastër» janë të frymëzuar nga e njëjta frymë si ata të policisë sekrete komuniste?

Unë nuk e di se çfarë është ky i ashtuquajtur Ungjill i pastër. A ishte predikimi i Gjon pagëzorit i pastër? Ai nuk tha vetëm: «Pendohuni, sepse mbretëria e qiellit është afër!» (Mateu 3:2). Ai gjithashtu «qortoi [Herodin]... për të gjitha të këqijat që kishte bërë Herodi» (Luka 3:19). Iu pre koka, sepse nuk e kufizoi veten ndaj mësimi abstrakt. Jezusi nuk mbajti vetëm një predikim «të pastër» në mal, por gjithashtu edhe atë që disa drejtues kishash tani do ta quanin një predikim të keq: «Mjerë ju farisenj hipokritë! ...O gjarpërinj, pjellë nepërkash!» (Mateu 23:27, 33). Për shkak të këtij predikimi «të papastër» Ai u kryqëzua. Farisenjtë nuk do të ishin shqetësuar për Predikimin në Mal.

Mëkati duhet thirrur në emër. Komunizmi është një nga mëkatet më të rrezikshme në botë sot. Çdo Ungjill, që nuk e denoncon atë, nuk është Ungjill i pastër. Kisha e fshehtë e denoncon, duke rrezikuar lirinë dhe jetën. Aq më tepër në perëndim nuk ka pse të qëndrohet në heshtje në lidhje me të.

Kam vendosur ta denoncoj komunizmin, jo ashtu siç e bëjnë ata, që quhen «ant-komunistë». Hitleri ishte antikomunist dhe ishte jo më pak se një tiran. Ne e urrejmë mëkatin dhe e duam mëkatarin.

Pse vuaj në perëndim

Vuaj më tepër në perëndim se sa në vendin komunist.


Vuajtja ime ka të bëjë para së gjithash me mallin për bukuritë e papërshkrueshme të kishës së fshehtë, kishë që përmbush thënien e vjetër latine, Nudisnudum Christi sequi (Pa ngurrim, ndjekim Krishtin).

Në vendet e robëruara, Biri i Njeriut dhe ata që janë të Tijet nuk kanë ku të mbështesin kokën. Shumë të krishterë nuk ndërtojnë shtëpi për vete. Për çfarë arsye? Do t'u sekuestrohet që në arrestimin e parë. Vetëm fakti që ke një shtëpi të re mund të jetë një tjetër motiv që të të burgosin, sepse të tjerët duan ta marrin. Atje nuk e varros dot babanë tënd, dhe as nuk i jep dot lamtumirën familjes para se të ndjekësh Krishtin. Kush është nëna, vëllai apo motra jote? Në lidhje me këtë, ju jeni si Jezusi. Nëna dhe vëllai janë për ju, ata që kryejnë vullnetin e Perëndisë.

Sa për lidhjet e gjakut, a vlejnë më ato kur nusja padit dhëndrin, fëmijët prindërit, gratë burrat e tyre? Gjithnjë e më tepër mbeten vetëm lidhjet shpirtërore.

Kisha e fshehtë është e varfër dhe e vuajtur, por ka shumë pak anëtarë të vakët.

Një shërbesë fetare në kishën e fshehtë është njësoj si një mijë e nëntëqind vjet më parë në kishën e hershme. Predikuesi nuk njuh ndonjë teologji të përpunuar. Nuk e njuh homilistikën, ashtu siç nuk e njuh as Pjetri. Çdo profesor teologjie do t'i kishte vënë



Pjetrit një notë të dobët për predikimin e tij në ditën e Pentakostit. Vargjet e Biblës nuk janë të mirënjohura në shumë vende, sepse Biblat nuk janë të lejuara. Përveç kësaj, predikuesi ka të ngjarë të ketë qenë në burg prej vitesh, pa pasur një Bibël. Kur shprehin besimin e tyre tek Ati, kjo do të thotë shumë, sepse ka një dramë pas këtij përcaktimi. Në burg, ata i kanë kërkuar përditë Atit të plotfuqishëm bukë dhe në vend të kësaj kanë marrë lakër me ndyrësira të patregueshme. Megjithatë, ata besojnë se Perëndia është një Atë i dashur. Ata janë si Jobi që tha se do t'i besonte Perëndisë edhe sikur Ai ta sakrifikonte. Ata janë si Jezusi, që e quajti Perëndinë «Atë,» madje edhe kur dukej sikur Ai e kishte braktisur në kryq.

Kushdo që ka njohur bukurinë shpirtërore të kishës së fshehtë s'mund të kënaqet më me boshllëkun e disa kishave në perëndim.

Vuaj më tepër në perëndim se sa kam vuajtur në burgun komunist, sepse tani e shoh me sytë e mi qytetërimi perëndimor të vdesë.

Osvald Spengler shkroi te *Rrënimi i Perëndimit*:

Ju po vdisni. Shoh te ju të gjithë njollën karakteristike të shkatërrimit. Mund të vërtetohet se pasuria dhe varfëria juaj më e madhe, kapitalizmi dhe socializmi juaj, luftërat dhe revolucionet tuaja, ateizmi dhe pesimizmi, cinizmi, imoraliteti, martesat e shkatërruara, kontrolli i lindjeve, që po jua thith gjakun dhe po ju vret e po jua heq arsyen, mund t'ua vërtetohet se janë karakteristikë e shenjave të epokave të vdekura të shteteve antike si Aleksandria, Greqia dhe Roma.

Kjo u shkrua që në vitin 1926. Që në atë kohë, demokracia dhe qytetërimi ka vdekur tashmë në gjysmën e Evropës, madje edhe deri në Kubë. Pjesa më e madhe e perëndimit është në gjumë.

Por ka një forcë që nuk fle. Ndërsa në lindje, komunistët janë të zhgënjyer dhe kanë humbur iluzionet e tyre, në perëndim një «komunizëm humanist» ka mbetur i fuqishëm. Humanistët/

komunistët e perëndimit, thjesht nuk u besojnë të gjitha raportimeve për mizoritë, mjerimin dhe persekutimin në vendet komuniste. Ata e ndajnë besimin e tyre me zell të papërtueshëm kudo, në sallonet e shtresës së lartë, në klubet e intelektualëve, në universitete, në lagje të varfra dhe në kisha. Ne të krishterët jemi shpesh me gjysmë zemre në anën e së vërtetës së plotë. Ata janë me gjithë zemër në anën e gënjeshtresë.


Teologët e perëndimit ndërkohë diskutojnë gjëra të parëndësishme. Kjo më kujton se, ndërsa trupat e Muhametit të dytë rrethuan Kostandinopojën në vitin 1493 dhe duhej të vendosej nëse Ballkani do të ishte nën sundimin e krishterë apo mysliman për shekuj me radhë, një këshill i një kishe lokale në qytetin e rrethuar diskutonte problemet e mëposhtme: Çfarë ngjyre ishin sytë e Marisë? Çfarë gjinie kanë engjëjt? Nëse bie një mizë në ujën e bekuar, a shenjtërohet miza apo ndotet uji? Kjo mund të jetë vetëm një legjendë që ka të bëjë me ato kohë, por lexoni me vëmendje revistat e sotme të krishtera dhe do të gjeni se diskutohen pikërisht pyetje të tilla. Kërcënimi i persekutuesve dhe vuajtjet e kishës së fshehtë zor se përmenden ndonjëherë.

Ka diskutime të pafund për çështje teologjike, për rituale, për gjëra jo të rëndësishme.

Në një festë, dikush pyeti: «Nëse do të ishit në një anije që po mbytej dhe do mund të shpëtonit në një ishull të izoluar, duke pasur mundësinë të merrni me vete vetëm një libër nga biblioteka e anijes, cilin do të zgjidhnit?» Dikush u përgjigj: «Biblën,» një tjetër «Shekspirin». Por një shkrimtar dha përgjigjen e duhur: «Do të zgjidhja një libër, që do të më mësonte se si të ndërtoja një varkë dhe të arrija në breg. Atje do të isha i lirë të lexoja çfarë të doja».

Të ruash lirinë për të gjitha denominacionet dhe teologjitë, dhe ta rigjesh atë atje ku kishte humbur për shkak të persekutimit të përhapur fetar, është më e rëndësishme se sa të këmbëngulësh mbi një opinion të caktuar teologjik.

«E vërteta do t'ju bëjë të lirë,» – tha Jezusi (Gjoni 8:32). Vetëm liria mund të japë të vërtetën. Në vend që të bëjmë debate për



gjërat e parëndësishme, duhet të bashkohemi në këtë luftë për liri kundër tiranisë në këtë botë.

Unë vuaj duke ndarë vuajtjet gjithnjë e në rritje të kishës në vendet e robëruara. Duke qenë se kam kaluar vetë përmes këtyre vuajtjeve, e di se çfarë heqin ata.

Në qershor të vitit 1966, gazeta sovjetike «Izvestia dhe Dervenskais Jizn» akuzoi baptistët rusë se po i mësonin anëtarët e tyre të vrisnin fëmijët për t'u pastruar nga mëkatet. Kjo është një akuzë e vjetër e ritualit të vrasjes që ngrihej edhe kundër judenjve.

Por unë e di ç'do të thotë kjo. Isha në një burg në Kluj, në vitin 1959, me një të burgosur, Lazaroviçi, i akuzuar se kishte vrarë një vajzë. Ai ishte vetëm tridhjetë vjeç, por flokët i ishin thinjur brenda natës për shkak të torturave. Dukej si një njeri i moshuar. Ia kishin shkukur thonjtë për ta detyruar të rrëfente një krim, që nuk e kishte kryer. Pas një viti torturash, u vërtetua pafajësia dhe u lirua, por liria s'kishte më asnjë kuptim për të. Do të ishte përgjithmonë njeri i shkatërruar.

Të tjerë lexojnë ndonjë artikull gazete dhe qeshin me akuzat e marra që bënte shtypi sovjetik kundër baptistëve gjatë epokës komuniste. Unë e di se çfarë do të thoshte kjo për të akuzuarit.

Është e tmerrshme të jesh në perëndim dhe të kesh përherë imazhe të ngulitura para syve.

Çfarë i ndodhi kryepeshkopit Jermogen të Kalugës (BRSS) dhe shtatë peshkopëve që protestuan kundër bashkëpunimit ekstrem me regjimin sovjetik siç praktikohej nga patriarku Aleksei dhe kryepeshkopi Nikodim, të cilët ishin mjete në duart e komunistëve? Nëse nuk do t'i kisha parë peshkopët që protestuan në Rumani të vdisnin pranë meje në burg, nuk do të kisha qenë edhe aq i shqetësuar për ta.

Priftërinjtë Nikolai Elishman dhe Gleb Jakunin u disiplinuan nga patriarku, sepse kishin kërkuar liri fetare për kishën. Perëndimi di vetëm kaq, por unë isha në burg me atë Ioan nga Vladimireshti, Rumani, të cilit i ndodhi e njëjta gjë. Në sipërfaqe ndodhi një «disiplinim» kishtar, por drejtuesit tanë zyrtarë të kishës, si shumë drejtues kishash zyrtare në vendet komuniste, punonin krah për


krah me policinë sekrete. Ata që ishin disiplinuar prej tyre iu nënshtruan një «disipline» më efektive: tortura, rrahje dhe drogimi i të burgosurve.

Dridhem për shkak të vuajtjeve të të persekutuarve në vende të ndryshme. Dridhem kur mendoj për fatin e përjetshëm të torturuesve të tyre. Dridhem për të krishterët në perëndim, që nuk i ndihmojnë vëllezërit e tyre të persekutuar.

Thellë në zemër, do të doja ta ruaja bukurinë e vreshtit tim dhe të mos përfshihesha në një luftë kaq të madhe. Do të doja shumë të isha diku në qetësi dhe çlodhje. Por nuk është e mundur. Kur komunistët pushtuan Tibetin, u dhanë fund atyre që ishin të interesuar vetëm në çështje shpirtërore. Në vendin tonë ata u dhanë fund atyre, që shkëputeshin prej realitetit. Kishat dhe manastiret u shpërbënë, duke ruajtur vetëm aq sa ishte e nevojshme për të mashtruar të huajt. Qetësia dhe pushimi për të cilin kisha nevojë do të ishte një arratisje prej realitetit dhe i rrezikshëm për shpirtin tim.

E kam bërë këtë luftë megjithëse ishte shumë e rrezikshme për mua. Më rrëmbyen në rrugë në vitin 1948 dhe më burgosën me emër të rremë. Ana Pauker, sekretarja jonë e shtetit në atë kohë, i tha ambasadorit suedez, Zotit Patrik von Reutersæarde: «Oh, Vurmbrandi tani është duke shëtitur nëpër rrugët e Kopenhagenit». Ministri suedez kishte në xhep letrën time, që thoshte se ia kisha dalë mbanë të arratisesha prej burgut; ai e dinte që po e gënjenin. Një gjë e tillë mund të ndodhë përsëri. Nëse më vrasin, vrasësi do të jetë caktuar nga komunistët. Askush tjetër s'ka ndonjë motiv për të më vrarë. Nëse dëgjoni zëra për rrënimin tim moral, vjedhje, homoseksualizëm, kurorëshkelje, papërgjegjshmëri politike, gënjeshtër apo ndonjë gjë tjetër, do të jetë përmëshja e kërcënimit të policisë sekrete: «Ne do të të shkatërrojmë moralisht».

Një burim shumë i mirinformuar më tha se komunistët rumunë vendosën të më vrasin pas dëshmisë që dhashë në senatin e SHBA-së në fund të viteve '60-të. Por s'mund të qëndroj në heshtje. Dhe detyra juaj është të hetoni me qetësi atë që them. Edhe nëse mendoni se, pas gjithë asaj që kam kaluar, vuaj nga kompleksi i persekutimit, mund të pyesni veten se ç'është kjo fuqi e frikshme



e komunistëve që i bën qytetarët e saj të vuajnë nga komplekse të tilla. Çfarë fuqie është ajo që i detyron njerëzit nga Gjermania Lindore komuniste ta marrin fëmijën në një buldozer dhe ta kalojnë përmes telave me gjemba, duke rrezikuar të qëllohet me të gjithë familjen?

Perëndimi fle dhe duhet të zgjohet për të parë përgjërimitin e kombeve të robëruara.



Njerëzit që vuajnë, shpesh kërkojnë një rrugë shpëtimiti, dikë mbi të cilin ta hedhin fajin. Të gjithë dikë të tillë ta lehtëson barrën, por unë s'mund ta bëj.

S'mund t'ua hedh fajin disa drejtuesve të kishave në perëndim që bëjnë kompromis me ata, që urrejnë të krishterët. E keqja nuk vjen prej tyre. Këta drejtues janë vetë viktimat e një të keqeje më të vjetër. Nuk e krijuan ata rrëmujën në kishë; ata e gjetën.

Që kur kam ardhur në perëndim, kam marrë pjesë në shumë seminare teologjike. Atje kam dëgjuar leksione mbi historinë e kabanave dhe këngëve liturgjike, për ligjet kanonike, që kanë kohë, që s'përdoren apo për disiplinën e kishës që nuk ekziston më. Kam dëgjuar që disa studentë të teologjisë mësojnë se historia biblike e krijimit nuk është e vërtetë, as ajo e Adamit, e përmbytjes, as mrekullitë e Moisiut. Disave u mësohet se profecitë u shkruan pas përmbushjes së tyre, që lindja nga një e virgjër është një mit; po kështu edhe ringjallja e Jezusit, që kockat e Tij kanë mbetur diku në një varr; që Ungjijtë nuk janë të vërtetë; dhe që Zbulesa është libri i një të marri, megjithatë, Bibla është një libër i shenjtë! (Kjo të lë me imazhin e një libri të shenjtë ku me sa thuhet, ka më tepër gënjeshtër se në një gazetë komuniste kineze.)

Këto janë disa nga gjërat, që drejtuesit e kishës perëndimore i mësojnë në seminare. Kjo është atmosfera në të cilën jetojnë. Pse duhet t'i qëndrojnë besnikë një Zoti për të cilin thuhet gjëra kaq të çuditshme? Pse duhet t'i qëndrojnë besnikë një kishë në të cilën mund të mësohet lirshëm që Perëndia është i vdekur?

Disa drejtues të denominacioneve nuk janë pjesë e Nuses së Krishtit. Ata janë drejtues në një kishë në të cilën shumë veta, ka kohë që e kanë tradhtuar Zotin. Kur takojnë dikë të kishës së fshehtë, një martir, e shohin çuditshëm.

S'mund ta gjykojmë gjithmonë njeriun vetëm për një pjesë të qëndrimit të tij. Nëse do të vepronim në këtë mënyrë, do të ishim si farisenjtë në sytë e të cilëve Jezusi shihej si i keq, sepse nuk i respektonte rregullat e tyre për të shtunën. Ata i mbyllnin plotësisht sytë ndaj asaj që do të kishte qenë e admirueshme të Jezusi, madje edhe në sytë e tyre.

Të njëjtët drejtues kishash, që kanë një qëndrim të gabuar ndaj komunizmit mund të jenë të drejtë dhe të sinqertë në shumë gjëra të tjera. Ata mund të ndryshojnë për sa u përket gjërave që janë gabim.

Një herë isha me një peshkop ortodoks në Rumani. Ai ishte një njeri i komunistëve, që denonconte delet e veta. I mora dorën dhe i tregova shëmbëlltyrën e djalit plangprishës. Ndodhi një mbrëmje në kopshtin e tij. I thashë: «Shiko se me çfarë dashurie e pret Perëndia një mëkatar që kthehet. Ai e pret me kënaqësi edhe një peshkop nëse pendohet». I këndova këngë të krishtera. Ky njeri u kthye në besim.


Isha në burg në të njëjtën qeli me një prift ortodoks, i cili me shpresën se do të lirohej, shkroi leksione ateiste. Fola me të dhe ai e grisi atë çka kishte shkruar, duke rrezikuar që të mos lirohej kurrë.

S'mund të fajësoj asnjë për të lehtësuar barrën që kam në zemër.



Kam edhe një dhembje tjetër. Madje edhe miqtë më të afërt më keqkuptojnë. Disa më akuzojnë për zemërim dhe mëri ndaj komunistëve, dhe e di që kjo s'është e vërtetë.

Shkrimtari mozaik, Klaud Montefiore, tha se qëndrimi i Jezusit ndaj skribëve dhe farisenjve, denoncimi i Tij publik ndaj tyre, është



kundër urdhërimit të Tij për të dashur armiqtë tanë dhe për t'i bekuar ata që na mallkojnë. Dr. E.R. Methju, dekan i Katedrales së Shën Palit në Londër, tashmë në pension, nxori si konkluzion se kjo ishte një mungesë lidhjeje logjike dhe një kundërshti te Jezusi. Ai jep arsyetimin se Jezusi nuk ishte intelektual!

Përshtypja e Montefiores për Jezusin ishte e gabuar. Jezusi i donte farisenjtë, megjithëse i paditi publikisht. Edhe unë i dua komunistët, edhe njerëzit e tyre në kishë, megjithëse i denoncoj ata.

Më thonë vazhdimisht: «Harroji komunistët! Puno vetëm me gjëra shpirtërore!»

Takova një të krishterë që kishte vuajtur nga nazistët. Më tha se ishte plotësisht në anën time për aq kohë sa dëshmoja për Krishtin, por nuk duhej të thosha asnjë fjalë të keqe kundër komunizmit. E pyeta nëse të krishterët që luftonin kundër nazizmit në Gjermani e kishin gabim dhe nëse duhej të kufizoheshin të flisnin vetëm për Biblën, pa thënë asnjë fjalë kundër tiranit Hitler. Përgjigjja ishte: «Por Hitleri vrau gjashtë milionë judenj! Dikush duhet të flasë kundër tij». Iu përgjigja: «Komunizmi ka vrarë tridhjetë milionë rusë dhe miliona kinezë e të tjerë me radhë. Ata kanë vrarë edhe judenj. A duhet të protestojmë ne vetëm kur vriten judenjtë dhe jo kur vriten rusë apo kinezë?» Përgjigjja ishte: «Kjo është tjetër gjë». Nuk mora shpjegim.

Policia më rrahu si gjatë sundimit të Hitlerit edhe gjatë komunizmit, dhe s'mund ta bëja ndryshimin. Të dyja ishin shumë të dhimbshme.

Krishtërimi duhet të luftojë kundër shumë aspekteve të mëkatit, jo vetëm kundër komunizmit. Ne nuk jemi të dhënë vetëm pas këtij problemi, por komunizmi është një armik i tmerrshëm i Krishtërimit dhe më i rrezikshmi. Kundër tij, duhet të bashkohemi.

A mund ta them përsëri? Qëllimi më i lartë i njeriut është të bëhet si Krishti. Parandalimi i kësaj është qëllimi i komunistëve. Ata janë kryesisht kundër fesë. Besojnë se, pas vdekjes, njeriu bëhet kripë dhe minerale, asgjë tjetër. Dëshirojnë që e gjithë jeta të jetohet në nivelin e materies.

Ata njohin vetëm masat. Fjala e tyre është e demonit në Dhiatën e Re kur u pyet se si e kishte emrin: «Jemi legjion». Personaliteti individual, një prej dhuratave të Perëndisë për njerëzimin, duhet të shtypet. Ata burgosën dikë, sepse e gjetën me një libër të Alfred Adler, *Psikologjia Individuale*. Oficerët e policisë sekrete thërrisnin: «Ah, individual, gjithmonë individual! Pse jo kolektiv?»

Jezusi dëshironte që të ishim individë. Kështu nuk ka mundësi kompromisi midis komunizmit dhe nesh. Komunistët e dinë këtë. Në revistën e tyre *Nauka i Religia (Shkenca dhe Feja)*, kanë shkruar: «Feja nuk përputhet me komunizmin. Është armiqësore ndaj saj... Përbajtja e programit të Partisë Komuniste është grusht vdekjeprurës për fenë... Është një program për krijimin e një shoqërie ateiste në të cilën njerëzit do ta heqin qafe skllavërinë fetare».

A mund të bashkëjetojë Krishtërimi me komunizmin? Komunistët i përgjigjen në këtë mënyrë kësaj pyetjeje: «Partia Komuniste është një grusht vdekjeprurës për fenë!»

KAPITULLI 5

Kisha e fshehtë, e përhapur kudo dhe e pathyeshme

Kisha e fshehtë punon në kushte shumë të vështira. Ateizmi është feja shtetërore në të gjitha vendet komuniste. Ata japin liri relative që të moshuarit të besojnë, por fëmijët dhe rinia nuk duhet të besojë. Çdo gjë në këto shtete dhe në lloje të tjera shtetesh të robëruara, radioja, televizioni, kinemaja, teatri, shtypi dhe shtëpitë botuese, kanë si qëllim shfarosjen e besimit të Jezu Krishti.

Kisha e fshehtë ka shumë pak mjete për të kundërshtuar forcat e mëdha të shtetit totalitar. Pastorët e kishës së fshehtë në Rusi nuk kishin asnjë trajnim teologjik. Ka pastore kinezë sot, që nuk e kanë lexuar asnjëherë të gjithë Biblën.

Do t'ju tregoj se si janë vajosur një pjesë e tyre. Ne takuam një të ri rus, i cili ishte pastor i fshehtë. E pyeta se kush e kishte vajosur. Ai u përgjigj: «Ne nuk kishim ndonjë peshkop për të na vajosur. Peshkopi zyrtar nuk do të vajoste asnjë që nuk ishte aprovuar nga Partia Komuniste. Kështu që dhjetë prej të krishterëve të rinj shkuam te varri i një peshkopi, i cili kishte vdekur si martir. Dy prej nesh vendosëm duart mbi varrin e tij dhe të tjerët formuan një rreth rrotull nesh. I kërkua Frymës së Shenjtë të na vajoste. Jemi të sigurt që u vajosëm nga duart e gozhduara të Jezusit». Për mua, vajosja e këtij të riu është e vlefshme para Perëndisë!

Njerëzit me vajosje të tillë, që nuk kanë pasur kurrë ndonjë trajnim teologjik dhe që shpesh nuk e njohin shumë Biblën (si ungjilltarët në Bangladesh), vazhdojnë punën e Krishtit.

Është si kisha në shekujt e parë. Çfarë seminaresh ndoqën ata, që e kthyen botën përmbys për Krishtin? A dinin të gjithë të lexonin? Dhe prej kujt i merrnin Biblat? Ishte Perëndia që u fliste atyre.


Ne të kishës së fshehtë nuk kemi katedrale, por a ka katedrale më të bukur se qielli që vështronim kur mblidheshim fshehurazi në pyje? Cicërime e zogjve zuri vendin e organos. Aroma e luleve ishte temjani ynë. Veshja prej zhelesh e një martiri të sapoliruar nga burgu ishte më mbreslënëse se veshjet prifërore. Kishim hënën dhe yjet si qirinj. Engjëjt ishin ata që i ndiznin.

S'mund ta përshkruaj bukurinë e kësaj kisha! Shpesh, pas një shërbese të fshehtë, të krishterët kapeshin dhe burgoseshin. Atje, të krishterët i mbanin prangat me kënaqësinë e një nuseje që vë në gisht një unazë të çmuar të dhuruar nga i dashuri i saj. Gjendja në burg ka baticat e zbaticat e veta. Por ata ndiejnë të marrin puthjen dhe përqafimin e Tij, dhe për këtë, nuk do ta ndryshonin vendin as me mbretërit. Të krishterë vërtet të gëzuar kam gjetur në Bibël, në kishën e fshehtë dhe në burg.

Kisha e fshehtë është e shtypur, por ka shumë miq, edhe në policinë sekrete apo mes anëtarëve të qeverisë. Ndonjëherë këta besimtarë sekretë e mbrojnë kishën e fshehtë.

Nën perandorinë e mëparshme sovjetike, gazetat ruse ankoheshin për numrin gjithnjë në rritje të «jobesimtarëve sa për sy e faqe». Këta, shpjegonte shtypi rus, janë një numër i madh burrash e grash që punojnë në çdo nivel të pushtetit komunist, në zyrat e qeverisë, në departamentet e propagandës, dhe kudo tjetër, të cilët në pamje të parë janë komunistë, por në zemër janë besimtarë dhe anëtarë të kishës së fshehtë.

Shtypi komunist tregoi historinë e një vajze të re që punonte në departamentin e propagandës. Pas pune, thanë ata, ajo dhe bashkëshorti i saj mblidhnin një grup të rinjsh nga apartamentet e tjera në shtëpinë e tyre për studime Bible dhe takime lutjesh të fshehta. Kjo po ndodh akoma në mbarë botën. Ka dhjetëra mijëra «jobesimtarë në dukje». Ata mendojnë se është më mirë të mos ndjekin kishat zyrtare të njohura, ku do të binin në sy dhe



ku dëgjohej vetëm një Ungjill jo i plotë. Zgjedhin të qëndrojnë në pozitë e autoritetit dhe përgjegjësisë nga të cilat mund të dëshmojnë qetësisht dhe duke dhënë fryte për Krishtin.

Kisha e fshehtë besnike ka mijëra anëtarë në vende të tilla. Ata zhvillojnë takime të fshehta në bodrume, papafingo, apartamente dhe fusha.

Në Rusinë ish-komuniste, askush nuk e kishte më mendjen tek diskutimet për pagëzimin ose jo të fëmijëve të vegjël, për pagabueshmërinë ose jo të papës, as edhe të diskutonin mbi çështjet para apo pas mijëvjecarit. S'mund t'i interpretonin profecitë dhe nuk grindeshin për to, por habitesha edhe me veten se sa mirë mund t'ua vërtetonin ateistëve ekzistencën e Perëndisë.

Përgjigjet e tyre ndaj ateistëve ishin të thjeshta:

«Nëse do t'ju ftonin në një festë me të gjitha llojet e mishrave më të mirë, a do të besonit se askush nuk i ka gatuar? Por natyra është një banket i përgatitur për ne! Ka domate, pjeshkë, mollë, qumësht dhe mjaltë. Kush i ka përgatitur gjithë këto gjëra për njerëzimin? Natyra është e verbër. Nëse nuk beson te Perëndia, si e shpjegon që e verbra natyrë ia ka dalë mbanë të përgatisë pikërisht gjërat për të cilat kemi nevojë me bollëk dhe shumëllojshmëri të tillë?»

Ata vërtetojnë se ekziston jeta e përjetshme. Dëgjova dikë t'i drejtohej një ateisti:

«Imagjinoni sikur të mund të flisnit me një embrion në barkun e nënës dhe t'i thoshit se jeta embrionike është shumë e shkurtër e më pas vjen jeta e vërtetë, jeta më e gjatë. Si do të përgjigjej embrioni? Do të jepte të njëjtën përgjigje që japin ateistët kur u flasim për parajsën dhe ferrin. Do të thoshte se jeta në barkun e nënës është jeta e vetme dhe çdo gjë tjetër është marrëzi fetare».


Por, nëse embrioni do të mund të mendonte, do të thoshte me vete: «Krahët po më rriten. Nuk kam nevojë për ta. Nuk

mundem as t'i shtrij. Por pse rriten? Ndoshta rriten për një fazë të ardhshme të ekzistencës sime, në të cilën do të më duhet të punoj me ta. Rriten edhe këmbët, por më duhet t'i mbaj të përkulur në kraharor. Por pse rriten? Ndoshta ka jetë në një botë më të madhe, ku do të më duhet të eci. Sytë zmadhohen, megjithëse jam i rrethuar nga errësira e plotë dhe nuk kam nevojë për ta. Pse kam sy? Ndoshta do të pasojë një botë plot dritë dhe ngjyra».

Kështu, nëse embrioni do të reflektonte mbi zhvillimin e tij, do të dinte që ka jetë jashtë barkut të nënës, pa e parë atë. Është e njëjta gjë me ne. Për sa kohë jemi të rinj, kemi fuqi, por s'kemi mend për ta përdorur siç duhet. Me kalimin e viteve, pasi jemi pjekur në njohuri dhe urtësi, na pret makina e vdekjes për në varr. Pse ishte e nevojshme kjo njohuri dhe urtësi kur s'mund ta përdorim më? Pse rriten krahët, këmbët dhe sytë në një embrion? Për jetën që do të vijë më pas. Kështu është edhe me ne këtu. Rritemi në përvojë, njohuri dhe urtësi për atë që do të vijë më pas. Jemi të përgatitur të shërbejmë në një nivel më të lartë që vjen pas vdekjes».

Për Jezusin, komunistët botonin se Ai nuk kishte ekzistuar kurrë. Punëtorët e kishës së fshehtë i përgjigjeshin lehtë: «Çfarë gazete ke në xhep? Është Pravda e sotme apo e së djeshmes? Më lejo t'i hedh një sy. Aha! 4 Janar 1964. Kur e nisi numërimin viti 1964? Ju thoni se Jezusi nuk ka ekzistuar kurrë, por përsëri i numëroni vitet që prej lindjes së Tij. Koha ekzistonte edhe para Tij, por kur Ai erdhi, njerëzimit iu duk se gjithçka që kishte qenë më parë kishte qenë e kotë dhe se koha e vërtetë filloi vetëm në atë çast. Vetë gazeta juaj komuniste është provë që Jezusi nuk është trillim».

Pastorët në perëndim zakonisht mendojnë se ata që vijnë në kishë janë të bindur për të vërtetat kryesore të Krishtërit, por s'është e vërtetë. Rrallë dëgjon një predikim që vërteton të vërtetën e besimit tonë, por pas perdes së hekurt, njerëzit që nuk kanë mësuar asnjëherë se si ta vërtetojnë këtë, u kanë dhënë personave të kthyer në besim një themel shumë serioz.



Nuk ka një vijë të qartë ndarëse me anë të së cilës mund të themi se ku përfundon kisha e fshehtë, e cila është shtylla kryesore e Krishtëritimit, dhe ku fillon kisha zyrtare. Ato janë të ndërthurura. Disa pastorë të kishave zyrtare në vendet e robëruara vazhdojnë një shërbesë të fshehtë paralele, që shkon përtej kufijve të vendosur nga qeveritë e tyre.

Kisha zyrtare, kisha e bashkëpunëtorëve me komunistët, ka një histori të gjatë. Filloi menjëherë pas revolucionit socialist rus me «Kishën e Gjallë» të drejtuar nga një peshkop i quajtur Sergius. Një prej bashkëpunëtorëve të tij deklaroi se «Marksizmi është Ungjilli i shkruar me shkronja ateiste». Çfarë teologjie e bukur!

Ne kemi pasur shumë si Sergiusi në çdo shtet.

Në Hungari, midis katolikëve, ishte Atë Balogu. Ai dhe disa pastorë protestantë i ndihmuan komunistët të merrnin kontrollin e plotë të shtetit.

Në Rumani, komunistët erdhën në fuqi me ndihmën e një prifti ortodoks të quajtur Burducea, një ish-fashist, i cili për të shlyer mëkatet e së shkuarës ndaj të Kuqve, u bë edhe më i «Kuq» se shefat e tij. Ky prift qëndronte pranë Vishinskit, Sekretarit Sovjetik të Shtetit, dhe buzëqeshi në shenjë miratimi kur ky i fundit deklaroi në themelimin e qeverisë së re komuniste: «Kjo qeveri do të ndërtojë një parajsë tokësore dhe nuk do të keni më nevojë për atë qielloren».

Për ata si Nikolai i Ruisë, është e vërtetuar se janë informatorë të qeverisë. Majori Deriaban, nga policia sekrete ruse, dëshmoi se Nikolai ishte agjenti i tyre.

Kjo ishte situata në pothuajse të gjitha denominacionet. Udhëheqësia e Rumanisë Baptiste ishte e imponuar me forcë, duke denoncuar të krishterët e vërtetë. Në Rusi, udhëheqësia e Baptistëve veprroi në të njëjtën mënyrë. Presidenti i Adventistëve rumunë, Takiçi, më tregoi se kishte qenë informator i policisë sekrete që ditën e parë që kishin ardhur në pushtet.

Në vend që të mbyllnin çdo kishë, megjithëse mbyllën me mijëra, komunistët me dinakëri vendosën të lejonin disa kisha zyrtare të mbeteshin të hapura dhe t'i përdornin si dritare përmes të cilave


të vëzhgonin, kontrollonin dhe si përfundim të shkatërronin të krishterët dhe Krishtërimin.

Vendosën se ishte më mirë që struktura e kishës të mbetej, në mënyrë që ta kthenin në një mjet të komunistëve për të kontrolluar të krishterët dhe për të mashtruar vizitorët, që vinin në vendin e tyre. Kjo situatë ekziston ende në kishën kineze (TSPM), edhe pse tanimë jemi në shekullin dhe mijëvjeçarin e ri! Kjo kishë e «vetme e ligjshme» në Kinë përfaqëson më pak se njëzetë për qind të të krishterëve kinezë.

Në Rumani, më ofruan një kishë të tillë me kushtin që si pastor t'i raportoja policisë sekrete rreth anëtarëve të mi. Duket sikur perëndimorët, të mësuar me gjërat «bardhezi» (ose është në një lloj forme ose nuk është fare) nuk mund ta kuptojnë këtë. Por kisha e fshehtë nuk do të pranojë kurrë kisha të kontrolluara si zëvendësuese për Ungjillëzimin efikas dhe plot kuptim ndaj «çdo krijese», duke përfshirë edhe të rinjtë.

Në kishat zyrtare ka një jetë të vërtetë shpirtërore, pavarësisht nga shumë drejtues të rrezikshëm. (Kam përshtypjen se në shumë kisha të perëndimit situata është e ngjashme. Bashkësitë janë besnike ndonjëherë, pavarësisht drejtuesve të tyre kryesorë dhe jo për shkak të tyre.)

Në Rusi, liturgjia ortodokse mbeti e pandryshuar, dhe ushqueu zemrat e anëtarëve të kësaj kishe, madje edhe nëse predikimet u bënë qejfin komunistëve. Luteranët, presbiterianët dhe protestantë të tjerë këndonin të njëjtat himne të vjetër. Madje edhe predikimet e informatorëve duhet të përmbanin diçka nga Shkrimi. Njerëzit në Kinë sot janë kthyer në besim nën ndikimin e atyre që i dinë se janë tradhtarë. Ata e dinë se do t'i tregohet policisë për kthimin e tyre në besim. U duhet ta fshehin besimin pikërisht prej atij që ua dha me anë të predikimit të tij të korruptuar. Kjo është mrekullia e madhe e Perëndisë e cituar te Levitiku 11:37 në një gjuhë simbolike: «Dhe në rast se një pjesë e trupave të tyre të pajetë [që sipas ligjit të Miosiut janë të papastër] bie mbi çfarëdo lloj fare që mbillet, kjo do të mbetet e pastër».



Për hir të drejtësisë duhet të themi se jo të gjithë drejtuesit e kishës zyrtare, madje as të gjithë drejtuesit kryesorë, janë njerëz të besuar të komunistëve.

Anëtarët e kishës së fshehtë janë shumë të dukshëm në kishat zyrtare, përveç disave që duhet të mbeten në fshehtësi. Ata e shohin se Krishtërimi nuk është një besim pa themel, por një besim që lufton. Kur policia sekrete erdhi për të mbyllur manastirin e Vladimireshtit në Rumani dhe të tjerë në shumë vende në Rusi, patën një kohë të vështirë. Disa komunistë i kanë paguar me jetë krimet e përpjekjeve për të ndaluar fenë.

Por kishat zyrtare po pakësohen gjithnjë e më tepër. Pyes veten nëse në të gjithë Bashkimin Sovjetik, ka pasur pesë apo gjashtë mijë kisha nën komunizëm. (Shtetet e Bashkuara, me të njëjtën popullsi, kishin treqind mijë të tilla dekada më parë!) Dhe këto «kisha» ishin shumë shpesh vetëm dhoma të vogla, jo një «kishë» siç e përfytyrojmë sot. Vizitorët e huaj shihnin një kishë të mbushur plot në Moskë, e cila ishte e vetmja kishë protestante në qytet, dhe shenjë e lirisë që ekzistonte. «Madje edhe kishat janë të tejmbushura!» – raportonin ata me gëzim. Nuk e shihnin tragjedinë e kishës protestante për shtatë milionë shpirtra! Edhe kishat njëdhomëshe nuk mund të arriheshin prej tetëdhjetë për qind të Bashkimit Sovjetik. Këto turma ishin ose të harruara ose të arritura me metoda të fshehta Ungjillëzimi. Nuk kishte zgjidhje tjetër.

Sa më tepër të dominojë komunizmi në një vend, aq më tepër i duhet kishës të fshihet. Në vendin e kishave të mbyllura zyrtare zhvilloheshin takimet e organizatave antifetare.

Si «ushqehet» kisha e fshehtë përmes literaturës ateiste

Kisha e fshehtë di ta përdorë edhe literaturën ateiste, duke u ushqyer përmes saj në të njëjtën mënyrë si u ushqye Elia nga sorrat. Ateistët harxhojnë shumë mund dhe zell në talljen dhe kritikën ndaj vargjeve të Biblës.


Ata botojnë libra të quajtur *Bibla Komikë* dhe *Bibla për Besimtarë dhe Jobesimtarë*. Duke u përpjekur të tregonin se çfarë marrëzie ishte Shkrimi, citonin shumë vargje nga Bibla. Sa shumë gëzonim për to! Libri u botua në miliona kopje dhe ishte plot me vargje nga Bibla, që ishin tej mase të bukur, madje edhe kur komunistët talleshin me to. Vetë kritika ishte aq e kotë, saqë asnjë nuk e merrte seriozisht. Në të shkuarën, «heretikët» e djegur nga inkuizicioni dërgoheshin në turrën e druve në një procesion, të veshur me lloj lloj veshjesh tallëse të pikturuara me flakët e ferrit dhe djaj. Çfarë shenjtorësh që ishin këta heretikë! Në të njëjtën mënyrë, vargjet e Biblës mbeten të vërteta, madje edhe nëse i citon Djalli.

Shtëpia botuese komuniste ishte shumë e kënaqur që merrte mijëra letra duke kërkuar ribotime të librave ateistë, që citonin vargje nga Bibla për t'u tallur me to. Ata nuk e dinin që këto letra vinin nga kisha e fshehtë, e cila kishte një mundësi tjetër për të marrë Shkrimin.

Ne dinim gjithashtu si t'i përdornim në favorin tonë edhe takimet ateiste.

Një profesor i komunizmit tha në një takim se Jezusi nuk ishte asgjë tjetër veçse një magjistar. Profesori kishte para tij një kanë me ujë. Hodhi pluhur në të dhe uji u bë i kuq. «Kjo është e gjithë mrekullia», – shpjegoi ai. «Ai kishte fshehur në mëngë pak pluhur të tillë dhe më pas pretendoi se e kishte kthyer ujin në verë në mënyrë të mrekullueshme, por unë mund të bëj më tepër se Jezusi; mund ta kthej verën përsëri në ujë» dhe hodhi në lëng një pluhur tjetër që u bë përsëri i tejudkshëm. Pas kësaj hodhi pluhur tjetër dhe u bë përsëri i kuq.

Një i krishterë u ngrit dhe tha: «Na keni mahnitur me atë që jeni në gjendje të bëni, shoku profesor. Do t'ju kërkonim vetëm një gjë më shumë, pijeni një shishe nga vera juaj!» Profesori tha: «Këtë s'mund ta bëj. Pluhuri ishte helm». I krishteri iu përgjigj: «Ky është e gjithë ndryshimi midis teje dhe Jezusit». Ai, me verën e Tij, na ka dhënë gëzim për dy mijë vjet, ndërsa ju na helmoni me verën tuaj». I krishteri shkoi në burg, por lajmi i këtij incidenti u përhap deri larg dhe forcoi shumë njerëz të besimit.



Ne jemi Davidë të vegjël, por jemi më të fortë se Goliathi i ateizmit, sepse Perëndia është në anën tonë. E vërteta na përket neve.

Në një rast tjetër, një komunist po jepte leksione mbi ateizmin. Të gjithë punëtorëve të fabrikës iu kërkua ta ndiqnin; midis tyre kishte shumë të krishterë. Ata qëndruan të qetë duke dëgjuar të gjitha argumentet kundër Perëndisë dhe marrëzinë e besimit të Krishti. Lektor i u përpoq të vërtetonte se nuk kishte botë shpirtërore, as Perëndi, asnjë Krisht, nuk kishte jetë pas vdekjes, njeriu është vetëm materie pa shpirt. Përsëriti herë pas here se ekziston vetëm materia.

Një i krishterë u ngrit dhe kërkoi të fliste. Iu dha leje. Ai mori karrigen e tij portative dhe e hodhi poshtë. Qëndroi për një çast duke e vështruar. Më pas shkoi dhe i dha një shuplakë në fytyrë lektorit komunist, i cili u zemërua shumë. U skuq në fytyrë nga tërbimi. Shau rëndë dhe thirri komunistët e tjerë që ta arrestonin. Ai e pyeti: «Si guxon të më japësh një shuplakë? Për ç'arsye?»

I krishteri iu përgjigj: «Ti sapo vërtetove që je gënjeshtar. The se gjithçka është materie... asgjë tjetër. Unë ngrita një karrige dhe e hodha poshtë. Ajo është vërtet materie. Karrigia nuk u zemërua. Është vetëm materie. Kur të dhashë një shuplakë, ti nuk reagove si karrigia. Reagove ndryshe. Materia nuk zemërohet, por ti po. Kështu që, shoku profesor, e ke gabim. Njeriu është më tepër se sa materie. Jemi genie shpirtërore!»

Në shumë mënyra të tilla, të krishterët e zakonshëm të kishës së fshehtë vërtetoheshin të kundërtën e argumenteve të përpunuara ateiste.

Në burg, oficeri politik më pyeste ashpër: «Sa gjatë do të vazhdosh ta mbash fenë tënde të marrë?» I thashë: «Kam parë shumë ateistë që në shtratin e vdekjes u penduan se kishin qenë të paperëndishëm, dhe i thirrën Krishtit. A mund ta imagjinoni që një i krishterë të pendohet, kur i afrohet vdekja dhe të thërrasë Marksini apo Leninin për ta shpëtuar prej besimit të tij?» Oficeri qeshi: «Përgjigje e zgjuar». Vazhdova: «Kur një inxhinier ka ndërtuar një urë, fakti që një mace mund ta kalojë nuk vërteton se ura është e mirë. Duhet të kalojë një tren për të vërtetuar forcën

e saj. Fakti që mund të jesh ateist kur gjithçka shkon mirë nuk vërteton të vërtetën e ateizmit. Ajo nuk të mban në momentet e krizës së madhe». Përdora librat e Leninit për t'i vërtetuar atij se, edhe pasi u bë kryeministër i Bashkimit Sovjetik, vetë Lenini u lut kur gjërat shkuan keq.

Ne ishim të qetë dhe mund të prisnim në qetësi zhvillimin e ngjarjeve. Komunistët ishin të shqetësuar dhe organizonin fushata antifetare. Me anë të kësaj, ata vërtetuan atë që ka thënë Shën Agustini: «E shqetësuar është zemra derisa gjen prehje te Ti».


Pse mund të fitohen edhe komunistët?

Nëse kisha e fshehtë ndihmohet nga të krishterët në botën e lirë, do të fitojë zemrat e komunistëve dhe do të ndryshojë pamjen e botës. Do të fitohen, sepse nuk është e natyrshme të jesh komunist. Edhe qeni dëshiron të ketë kockën e tij. Zemrat e komunistëve rebelohen kundër rolit, që duhet të luajnë dhe absurditeteve që detyrohen të besojnë.

Komunistët si individë mbronin idenë që «materia është gjithçka,» që ne jemi një grusht kimikatesh të organizuara në një lloj forme, që pas vdekjes do të jemi përsëri kripëra dhe minerale. Kështu që ishte e mjaftueshme t'i pyesje: «Si është e mundur që komunistët në shumë vende kanë dhënë jetën për besimin e tyre? A mund' të sakrifikojnë veten mineralet për të mirën e të tjerëve?» Nuk kanë përgjigje për këtë.

Dhe më pas vjen çështja e brutalitetit. Njerëzit nuk u krijuan si brutalë dhe s'mund të durojnë të jenë të tillë për shumë kohë. E kemi parë këtë në rënien e sunduesve nazistë, disa prej të cilëve kryen vetëvrasje ndërsa u penduan dhe rrëfyan krimet e tyre.

Numri i madh i deheve në vendet komuniste nxjerr në pah dëshirën për një jetë më kuptimplotë, të cilën s'mund ta jepnin komunistët. Rusët janë në përgjithësi njerëz të thellë, zemërgjerë dhe bujarë. Komunizmi është i cekët dhe sipërfaqësor. Njeriu kërkon jetë të thellë dhe kur nuk e gjen në asnjë vend, e kërkon tek alkooli. Ai shpreh tek alkoolizmi tmerret e tij për jetën brutale dhe mashtruese



që duhet të jetojë. Për disa çaste alkooli e bën të lirë, siç mund ta bënte të lirë përgjithmonë e vërteta nëse do të mund ta njihte.

Në Bukuresht, gjatë pushtimit rus (1947-1989), një herë ndjeva një impuls të parezistueshëm për të hyrë në një tavernë. I thashë edhe gruas të vinte me mua. Kur hymë, pamë një kapiten rus me një armë në dorë duke i kërcënuar të gjithë që t'i jepnin ende për të pirë. I ishte refuzuar, sepse ishte tashmë shumë i dehur. Njerëzit i kishte zënë paniku. Shkova te pronari, i cili më njohu dhe i kërkova t'i jepte liker kapitenit, duke premtuar se do të ulesha me të dhe ta ruaja që të qëndronte i qetë. Na dhanë shishe vere njëra pas tjetrës. Në tavolinë kishte tri gota. Kapiteni me mirësjellje i mbushte të treja dhe i pinte të treja. Unë dhe gruaja ime nuk pimë. Megjithëse ishte i dehur, ishte i vetëdijshëm. Ishte mësuar me alkool. I fola për Krishtin dhe më dëgjoji me vëmendje, gjë që nuk e prisja.

Kur përfundova, më tha: «Tani që më ke thënë se kush je, do të tregoj kush jam unë. Jam një prift ortodoks, isha nga të parët që mohuan besimin kur filloi persekutimi i madh nën Stalinin. Shkoja nga një fshat në tjetrin për të dhënë leksione duke thënë se nuk ka Perëndi dhe se si prift kisha qenë mashtrues. “Jam mashtrues dhe të tillë janë të gjithë priftërinjtë e tjerë”, – u thosha atyre. Më vlerësuan shumë për zellin tim, kështu që u bëra oficer i policisë së fshehtë. Dënimi im nga Perëndia ishte që me këtë dorë më duhej të vrisja të krishterët, pasi i torturoja, dhe tani pi e pi për të harruar ç’kam bërë. Por nuk funksionon».

Shumë komunistë kryejnë vetëvrasje. Kështu vepruan edhe poetët e tyre të mëdhenj, Esenini dhe Maiakovski, po ashtu edhe Fadevi. Ai sapo kishte përfunduar romanin e tij të titulluar *Lumturia*, ku shpjegonte se lumturi do të thoshte të punoje pa u lodhur për komunizmin. Ishte aq i lumtur saqë vrau veten pasi kishte përfunduar romanin. Një gënjeshtër e tillë ishte e padurueshme për shpirtin e tij. Jofe, Tomkin, udhëheqës të mëdhenj dhe luftëtarë për komunizmin në kohën e Carit, nuk mundën të shihnin si ishte komunizmi në të vërtetë. Edhe ata përfunduan në vetëvrasje.

Komunistët nuk janë të lumtur. Nuk janë të lumtur as diktatorët e tyre dhe as Stalini nuk ishte! Pasi kishte vrarë pothuajse të

gjithë shokët e tij të vjetër, kishte frikë të vazhdueshme se mos e helmonin apo e vrisnin. Kishte tetë dhoma gjumi, ku mund të mbyllej e të ishte i sigurt si në një kasafortë banke. Askush nuk e mori vesh kurrë se në cilën dhomë flinte në net të ndryshme. Nuk hante asnjëherë nëse kuzhinieri nuk e provonte ushqimin në praninë e tij. Komunizmi nuk bën të lumtur askënd, as vetë diktatorët e tij. Ata kanë nevojë për Krishtin.

Duke kthyer në besim ata që persekutojnë të krishterët, ne do të çlironim jo vetëm viktimat e tyre, por edhe vetë persekutuesit.

Kisha e fshehtë përfaqëson nevojën më të thellë të njerëzve në skllavëri në vendet e robëruara. Ndhimohen!



Një tipar dallues i kishës së fshehtë është zjarri i saj i besimit.

Një pastor që maskohet nën emrin «George» tregon në librin e tij për kishën e fshehtë të Perëndisë incidentin e mëposhtëm:

«Një kaptiten i ushtrisë ruse shkoi te një pastor në Hungari dhe i kërkoi ta takonte vetëm. Kapiteni i ri ishte shumë i prerë dhe i vetëdijshëm për rolin e tij si pushtues. Kur e çuan në një dhomë të vogël konference dhe u mbyll dera, përkuli kokën para kryqit që varej në mur.


“Ju e dini që kjo është gënjeshtër” – i tha pastorit. “Është thjesht një hile që ju pastorët e bëni për të mashtruar të varfërit dhe për ta bërë më të lehtë për të pasurit t’i mbajnë në padije. Hë pra, jemi vetëm. Pranoje që asnjëherë nuk ke besuar vërtet se Krishti është Biri i Perëndisë!”

Pastori buzëqeshi. “Djaloshi im i gjorë, sigurisht që e besoj. Është e vërtetë.”

“Nuk dua të m’i bësh mua këto lojëra!” – thirri kapiteni. “Kjo është serioze. Mos u tall me mua!”

Nxori revolverin dhe ia afroi trupit të pastorit.

“Nëse nuk e pranon që është gënjeshtër, do të të qëlltoj!”



“S’mund ta pranoj, sepse është e vërtetë. Zoti ynë është vërtet Biri i Perëndisë,” – tha pastori.

Kapiteni flaku revolen në dysheme dhe përqafoi njeriun e Perëndisë. Sytë iu mbushën me lot.

“Është e vërtetë!” – thirri ai. “Është e vërtetë! Edhe unë e besoj, por nuk isha i sigurt nëse njerëzit do të vdisnin për këtë besim derisa e zbulova vetë. Oh, faleminderit! Keni forcuar besimin tim. Tani e di se mund të vdes për Krishtin. Ti më ke treguar si”».

Di edhe raste të tjera. Kur rusët pushtuan Rumaninë, dy ushtarë të armatosur hynë në një kishë me armë në duar dhe thanë: «Ne nuk besojmë në fenë tuaj. Ata që nuk e braktisin menjëherë do të qëllohen! Ata që duan ta braktisin besimin të kalojnë në të djathtë!» Disa shkuan në të djathtë dhe u urdhëruan të largohen nga kisha e të shkojnë në shtëpi. Ata u larguan për të shpëtuar jetën e tyre. Kur rusët ishin vetëm me pjesën që mbeti të të krishterëve, i përqaftuan dhe u thanë: «Edhe ne jemi të krishterë, por donim të kishim bashkësi vetëm me ata, që e konsiderojnë të vërtetën aq të vlefshme sa të vdesin për të».

Njerëz të tillë luftuan për Ungjillin dhe luftojnë edhe sot në vendet komuniste të Azisë Juglindore. Ata luftojnë jo vetëm për Ungjillin, por edhe për liri.

Në shtëpitë e shumë prej të krishterëve perëndimorë, kalohen orë duke dëgjuar muzikë jo të krishterë. Në shtëpitë tona mund të dëgjohet muzikë, por vetëm për të mbuluar bisedat për Ungjillin dhe punën e kishës së fshehtë që fqinjët të mos dëgjojnë dhe të informojnë policinë sekrete.

Sa gëzojnë të krishterët e kishës së fshehtë në rastet e rralla kur takojnë një të krishterë serioz nga perëndimi!

Ai që po i shkruan këto rreshta është njeri i parëndësishëm, por është zëri i atyre që s’mund të flasin; i atyre që s’mund të shprehen dhe nuk përfaqësohen në perëndim. Në emër të tyre ju kërkoi seriozitet në besim dhe në zgjidhjen e problemeve të

Krishtërimin. Në emër të tyre, ju kërkoj lutje dhe ndihmë praktike për ata që janë besnikë, që po vuajnë në kishën e fshehtë në vendet komuniste dhe në vendet e tjera të robëruara sot.



Duhet t'i fitojmë komunistët. Së pari, sepse Perëndia është në anën tonë. Së dyti, sepse mesazhi ynë i përgjigjet nevojës më të thellë të zemrës.


Komunistët që kishin qenë në burg në kohën e nazizmit më kanë rrëfyer se janë lutur në orët e vështira. Kam parë oficerë komunistë të vdesin me fjalët «Jezus, Jezus» në buzë.

Do të fitojmë, sepse e gjithë trashëgimia kulturore e popullit tonë është në anën tonë. Rusët mund të ndalojnë të gjitha shkrimet e të krishterëve modernë, por ka ende libra të Tolstoit dhe Dostojevskit dhe njerëzit mund të gjejnë dritën e Krishtit në ta. Është e njëjta gjë me Gëten në Gjermaninë Lindore, Shienkeviçin në Poloni e të tjerë me radhë. Shkrimtari më i madh rumun ishte Sadoveanu. Komunistët e kanë botuar librin e tij *Jetët e shenjtoreve* nën titullin *Legjenda e shenjtoreve*. Por edhe me këtë titull shembulli i jetës së shenjtoreve është frymëzues.

Ata s'mund t'i përjashtojnë prodhimet e Rafaelit, Mikelanxhelos dhe të Leonardo da Vinçit nga historia e artit. Këto piktura flasin për Krishtin.

Kur bisedoj me një komunist për Krishtin, nevoja e tij më e thellë shpirtërore është të bëhet aleati dhe ndihmësi im. Vështirësia më e madhe për të nuk është t'u përgjigjet argumenteve të mia. Vështirësia më e madhe është të shuajë zërin e ndërgjegjes së vet, e cila është në anën time.

Kam njohur personalisht profesorë të Marksizmit, të cilët, para se të jepnin leksion mbi ateizmin, i luteshin Perëndisë të mund t'i ndihmonte. Kam njohur komunistë që kanë shkuar në një takim të fshehtë kisha larg vendit të tyre. Kur zbuloheshin, e mohonin. Më pas qanin dhe pendoheshin që nuk kishin pasur guximin ta mbronin besimin që i nxiti të shkonin në takim. Edhe ata njerëz janë.



Kur një person vjen në besim, madje edhe një besim primitiv, ky besim rritet dhe zhvillohet. Jemi të sigurt se do të fitojë, sepse ne të kishës së fshehtë e kemi parë të fitojë vazhdimisht.

Krishti i do komunistët, madje edhe «armiqtë e tjerë të besimit». Ata mund të fitohen dhe duhet të fitohen për Krishtin. Kushdo që dëshiron të kënaqë dëshirën e zjarrtë të zemrës së Jezusit për shpëtimin e shpirtave të të gjithë njerëzimit, duhet të mbështesë kishën e fshehtë në punën e saj. Jezusi tha: «Mësoni të gjitha kombet». Ai nuk tha asnjëherë se na duhet leje nga qeveria për të Ungjillëzuar. Besnikëria ndaj Perëndisë dhe Urdhërimi i Madh na nxit të shkojmë përtej kufijve, drejt njerëzve në vendet e robëruara.

Ne mund t'i arrijmë duke punuar me kishën e fshehtë që tashmë ekziston atje.

Kush bënte pjesë në kishën e fshehtë


Kisha e fshehtë përbëhet nga tre grupe. Grupi i parë janë mijëra e mijëra ish-pastorë e priftërinj, të cilët i kanë dëbuar nga kishat e tyre dhe nga njerëzit për të cilët kujdeseshin, sepse nuk kompromentonin Ungjillin. Shumë pastorë e priftërinj të tillë janë burgosur për vite me radhë dhe janë torturuar për besimin e tyre. Janë liruar dhe kanë rifilluar punën e tyre në kishën e fshehtë, duke shërbyer në fshehtësi dhe duke pasur rezultate. Megjithëse komunistët dhe lloje të ngjashme qeverisjeje i mbyllën kishat e tyre apo i zëvendësuan drejtuesit me njerëz «më të besueshëm,» këta pastorë vazhduan shërbesën me më tepër sukses se kurrë më parë, duke punuar në fshehtësi në takimet e kishës së fshehtë nëpër stalla, papafingo, bodrume dhe në fusha gjatë natës ose kudo që besimtarët mblidheshin në fshehtësi. Këta njerëz janë «martirët e gjallë,» që nuk do të reshtin me shërbesën e tyre dhe që rrezikojnë tortura të tjera dhe arrestime.

Pjesa e dytë e kishës së fshehtë është ushtria e madhe e njerëzve të thjeshtë të përkushtuar. Një në çdo pesë persona në botë jetojnë në Kinën komuniste, ku mijëra të krishterë të thjeshtë ungjillëzojnë pa «leje». Persekutimi ka nxjerrë gjithmonë të krishterë më të

mirë, një i krishterë që dëshmon është një i krishterë që fiton njerëz për Krishtin. Persekutimi komunist pati efekt të kundërt dhe nxori të krishterë seriozë e të përkushtuar, që rrallë gjenden në vendet e lira. Këta njerëz s'mund ta kuptojnë se si një i i krishterë të mos ketë dëshirën për të fituar për Krishtin çdo njeri që takon.

Ylli i Kuq (gazeta e ushtrisë ruse) sulmonte të krishterët rusë, duke thënë: «Adhuresve të Krishtit u pëlqen të zgjasin kthetrat e tyre të pangopura mbi këdo». Por të jetuarit si të krishterë bëri që të fitonin dashurinë dhe respektin e bashkëfshatarëve dhe të fqinjve. Në çdo qytet apo fshat, të krishterët ishin banorët më të pëlqyer dhe më të dashur. Kur një nënë ishte tepër e sëmurë për t'u kujdesur për fëmijët e saj, do të ishte një nënë e krishterë, që vinte dhe kujdesej për ta. Kur një burrë ishte tepër i sëmurë për të prerë dru për zjarr, do të ishte një burrë i krishterë, që e ndihmonte. Ata e jetonin jetën si të krishterë dhe kur fillonin të dëshmonin për Krishtin, njerëzit i dëgjonin dhe i besonin, sepse e kishin parë Krishtin në jetën e tyre. Meqenëse askush, përveç një pastori të licencuar s'mund të flasë në një kishë zyrtare, miliona të krishterë të përkushtuar në çdo cep të botës komuniste fitojnë shpirtra, dëshmojnë dhe shërbejnë në treg, në burimin e fshatit, kudo që shkojnë. Gazetat komuniste e pranojnë se shitësit e krishterë të mishit shpërndanin fletushka të Ungjillit, duke i përdorur si ambalazh për mishin që shisnin. Shtypi komunist pohonte se të krishterët që punonin në poste me autoritet në shtëpitë botuese komuniste hynin fshehtas natën, ndiznin makineritë dhe botonin disa mijëra kopje literaturë të krishterë, dhe e mbyllnin përsëri para se të lindte dielli. Shtypi komunist gjithashtu ka pohuar se fëmijët e të krishterëve në Moskë merrnin Ungjijtë nga «disa burime,» i kopjonin disa pjesë të tyre me dorë, dhe i fusnin në xhepat e palltove të mësuesve të tyre, që vareshin në dollapët e shkollës. Grupi i njerëzve të thjeshtë është një forcë misionare shumë e fuqishme dhe efektive në fitimin e shpirtrave të njerëzve në çdo vend komunist.

Këta miliona besimtarë vërtet të përkushtuar dhe të zjarrtë në kishën jozyrtare janë pastruar prej vetë flakëve të persekutimit, që komunistët besonin se do t'i shkatërronte.



Në Kubën komuniste, janë hapur mijëra kisha-shtëpi pavarësisht nga përndjekja e qeverisë. Këshilli Ekumenik i Kubës është i përbërë kryesisht nga drejtues marksistë kishash.

Grupi i tretë dhe shumë i rëndësishëm i kishës së fshehtë janë pastorët besnikë në kishën zyrtare, por që i kanë ndaluar dhe janë kthyer në «kisha» të heshtura. Kisha e fshehtë nuk është e ndarë nga kisha zyrtare. Gjatë sundimit të komunizmit në Poloni, Hungari dhe në ish-Jugosllavi, shumë prej pastorëve të kishave zyrtare punonin në fshehtësi në kishën e fshehtë. Në disa vende ka bashkëveprim midis të dyjave edhe në ditët e sotme. Këta pastorë nuk lejohen të flasin për Krishtin jashtë kishave të tyre të vogla njëdhomëshe. Nuk lejohen të kenë takime fëmijësh apo të rinjsh. Ata që nuk janë të krishterë kanë frikë të vijnë. Këta pastorë nuk lejohen të shkojnë dhe të luten në shtëpitë e anëtarëve të kishës kur ata janë sëmurë. Ata kufizohen nga çdo anë nga rregullat komuniste, që i bëjnë «kishat» e tyre të kota.

Shumë shpesh ata përballen me kontrollet që tallen me «lirinë e fesë,» guxojnë, duke rrezikur lirinë e tyre, të zhvillojnë shërbesë paralele në fshehtësi që i shmanget kufizimeve të qeverisë. Pastorët u shërbejnë fëmijëve dhe të rinjve në fshehtësi. Në Lindjen e Mesme, në Afrikën e Veriut dhe në Azi, ungjillëzohet në fshehtësi në shtëpitë dhe bodrumet e të krishterëve. Ata marrin dhe u shpërndajnë në fshehtësi literaturë të krishterë shpirtrove të uritur. Rrezikojnë lirinë e tyre duke shpërfillur në fshehtësi kufizimet zyrtare dhe duke u shërbyer shpirtrove të uritur rreth tyre. Në pamje të parë të dëgjueshëm e të bindur, ata rrezikojnë jetën duke shpërndarë Fjalën e Perëndisë. Shumë njerëz të tillë u zbuluan, u arrestuan në ish-Bashkimin Sovjetik dhe u dënuan me disa vite burgim.

Të tjerë burra e gra arrestohen akoma edhe sot. Ata janë pjesë e rëndësishme e kishës së fshehtë në vendet e robëruara.

Ish-pastorët që kanë qenë të përjashtuar nga kishat e tyre, besimtarët e thjeshtë dhe pastorët zyrtarë që zhvillojnë në fshehtësi një shërbesë më të gjerë seç u lejohet, të gjithë këta punojnë në kishën e fshehtë «jozyrtare». Kisha e fshehtë do të jetojë derisa

komunizmi apo çdo kundërshtar tjetër të mundet. Në disa vende, një pjesë është më aktive se tjetra, por janë të gjithë atje, duke punuar për Krishin dhe duke rrezikuar shumë.

Dikush që udhëtonte shpesh në vendet komuniste dhe që ishte shumë i interesuar në çështjet fetare, kur u kthye shkroi se nuk kishte takuar ndonjë person të kishës së fshehtë.

Është si të udhëtosh në Afrikën Qendrore në mes të fiseve të paarsimuar dhe në kthim të thuash: «I mora në pyetje dhe pashë nëse flisnin në prozë. Të gjithë më thanë që jo». E vërteta është se ata të gjithë flasin në prozë, por nuk e dinin këtë.

Të krishterët e dekadës së parë nuk e dinin që ishin të krishterë. Nëse do t'i pyesje për fenë e tyre, do të thoshin se ishin judenj, izraelitë, besimtarë në Jezusin si Mesia, vëllezër, shenjtorë, fëmijë të Perëndisë. Emri «i krishterë» iu dha shumë kohë më vonë nga të tjerë për herë të parë në Antioki.

Asnjë nga ndjekësit e Luterit nuk e dinte që ishte luteran. Luteri protestoi me vendosmëri kundër këtij emri.

«Kisha e nëndheshme» është emri i dhënë nga komunistët, si edhe nga perëndimorët që bënë kërkime mbi situatën fetare në Lindje për organizatën e fshehtë, që u krijua spontanisht në vendet komuniste. Anëtarët e kishës së fshehtë nuk e quajnë organizatën e tyre me këtë emër. Ata e quajnë veten të krishterë, besimtarë, fëmijë të Perëndisë. Por kryejnë punë në fshehtësi, takohen në fshehtësi, shpërndajnë Ungjillin në takime klandestine, që ndiqen pikërisht nga ata të huaj që deklarojnë se s'e kanë parë kishën e fshehtë. Është emër i përshtatshëm i dhënë nga kundërshtarët dhe nga ata, që e shohin me dashuri nga jashtë këtë organizatë të fshehtë të mrekullueshme.

Mund të udhëtosh vite me radhë në të gjithë perëndimin dhe të mos takosh asnjëherë një rrjet ndërkombëtar spiunazhi, por kjo nuk do të thotë se nuk ekziston. Është marrëzi t'u shfaqesh udhëtarëve kureshtarë.

Në kapitullin tjetër, do të citoj disa artikuj të botuar dekada më parë nga shtypi sovjetik, që vërteton ekzistencën dhe rëndësinë gjithnjë e më të madhe të kësaj kishë të fshehtë guximtare.

KAPITULLI 6

Si e mposht Krishtërimi komunizmin?

Ju kam treguar për përvojën në ndarjen e mesazhit të Krishtit në fshehtësi në ushtrinë sovjetike dhe në Rumaninë komuniste. Ju kam bërë thirrje të ndihmoni t'u predikojmë Krishtin komunistëve dhe njerëzve të shtypur prej tyre. Mos është sfida ime «vizionare» dhe «e pamundur?» Mos nuk është realiste?

A ekziston tani kisha e fshehtë në Azinë komuniste dhe në vende të tjera të robëruara? A është ende e mundur veprimtaria në fshehtësi në këto vende?

Këtyre pyetjeve mund t'u përgjigjemi me lajme shumë të mira.

Komunistët festuan një gjysmë shekulli sundim të komunizmit, por fitorja e tyre ishte disfatë. Fitoi Krishtërimi – jo komunizmi. Shtypi rus, të cilin organizata jonë e shqyrtonte me imtësi, bënte veç propagandë negative për kishën e fshehtë. Kisha e fshehtë ruse u bë aq e fortë sa që punonte gjysmë-haptas, duke i frikësuar komunistët. Tani udhëheqësia aktuale e ish-Bashkimit Sovjetik konfirmon raportet e shtypit komunist.

Mos harroni, kisha e fshehtë në mbarë botën është si një ajsberg. Pjesa më e madhe ndodhet nën sipërfaqe, por shpesh një pjesë e vogël vepron haptas.

Në faqet që pasojnë kam paraqitur një përmbledhje të shkurtër të disa prej veprimtarive të tyre të suksesshme në shekullin e njëzetë.

Maja e ajsbergut

Më 7 nëntor të vitit 1988 në Suhumi (Kaukaz), kisha e fshehtë organizoi një takim të madh të hapur. Shumë besimtarë erdhën nga qytete të tjera për ta ndjekur. Pas një thirrjeje për t'u penduar, dyzetë e shtatë të rinj pranuan Krishtin dhe u pagëzuan në çast në Detin e Zi, njësoj si në kohët biblike.


Pas disa dekadash të diktaturës komuniste, duke mos pasur Bibla, libra të tjerë të krishterë apo mundësi të ndiqnin seminare, pastorët e kishës së fshehtë nuk mund të quheshin teologë të trajnuar. Por as Filipi, dhjaku, nuk ishte. Gjithsesi, kur një eunuk, me të cilin kishte folur ndoshta për një orë, e pyeti: «Ja uji! Çfarë më pengon të pagëzohem?» Filipi i tha: «Nëse ti beson me gjithë zemër, mund ta bësh»... Filipi dhe eunuku u futën në ujë dhe ai e pagëzoi». (Veprat 8:36-38).

Ka mjaft ujë në Detin e Zi, kështu që kisha e fshehtë rivendosi praktikat e kohërave biblike. Sot, megjithëse partia komuniste nuk qeveris më në Rusi, të krishterët në disa prej ish-Republikave Sovjetike përballeshin me persekutime.

Uchitelskaia Gazeta (Revista e Mësuesit) e 23 gushtit të vitit 1966, publikoi se një demonstratë u organizua në rrugët e Rotsov-on-Don-it nga baptistët, të cilët refuzonin ta regjistronin bashkësinë e tyre dhe t'u bindeshin të ashtuquajturve «drejtues» të caktuar nga komunistët.

Kjo ka ndodhur më 1 maj. Ashtu si Jezusi kryente mrekulli të shtunën për të sfiduar farisenjtë kundërshtarë, në të njëjtën mënyrë kisha e fshehtë zgjedh ndonjëherë festat komuniste për të sfiduar ligjet e tyre. 1 maji është festë në të cilën komunistët zhvillojnë demonstrata të mëdha, të cilat detyrohen të gjithë t'i ndjekin. Në këtë ditë, një forcë tjetër e madhe në Rusi, kisha e fshehtë, u shfaq në rrugë.

Çdo besimtar në Rusi e njihte «Manifestin sekret» të botuar nga të krishterët ungjillorë në Barnaul, ku përshkruhet se si motër Hmara, nga fshati i Kulundës, mori lajmin se i shoqi kishte vdekur në burg. Mbeti e ve me katër fëmijë të vegjël. Kur mori kufomën e të



shoqit, pa shenjat e prangave në duar. Duart, gishtërinjtë dhe pjesa e poshtme e këmbëve ishin të djegura në mënyrë të tmerrshme. Kishte shenja thikash në pjesën e poshtme të stomakut. Këmba e djathtë ishte e ënjtur. Në të dyja këmbët kishte shenja rrahjesh. I gjithë trupi ishte plot plagë prej torturave të tmerrshme.

Çdo besimtar që mori pjesë në demonstratën publike në Rostov-mbi-Don e dinte se ky mund të ishte edhe fati i tij, por kjo s'ë ndali.

Ata e dinin se ky martir, që kishte dhënë jetën për Perëndinë vetëm tre muaj pas kthimit të tij në besim, u varros para një turme të madhe besimtarësh që kishin parrulla me thëniet:

«Për mua, jeta është Krishti dhe vdekja fitim» (Filipianëve 1:21).

«Mos kini frikë nga ata që vrasin trupin, sepse nuk mund të vrasin shpirtin» (Mateu 10:28).

«Unë pashë nën altar shpirtrat e atyre që ishin therur për shkak të Fjalës së Perëndisë» (Zbulesa 6:9).

Shembulli i këtij martiri frymëzoi të krishterët në Rostov-mbi-Don. U mblodhën rreth një shtëpie të vogël. Kishte njerëz ngado, disa në çatitë aty pranë, të tjerë nëpër pemë, si Zakeu. U kthyen në besim tetëdhjetë vetë, pjesa më e madhe të rinj. Njëzetë e tre prej tyre ishin ish-komsomols (anëtarë të Organizatës Rinore Komuniste)!

Të krishterët përshkuan qytetin duke ecur në drejtim të lumit Don, ku u pagëzuan besimtarët e rinj.

Automjetet të mbushura plot me policë komunistë mbërritën pa humbur kohë. Policia rrethoi besimtarët në breg të lumit, duke dashur të arrestonte vëllezërit organizatorë. (Nuk mund t'i arrestonin të gjithë, të një mijë e pesëqind personat!) Besimtarët ranë menjëherë në gjunjë, dhe në lutje të zjarrta, i kërkuan Perëndisë të mbronte njerëzit e Tij dhe t'i lejonte të kishin mundësi ta zhvillonin shërbesën atë ditë. Duke qëndruar krah për krah, ata rrethuan vëllezërit që drejtonin shërbesën me shpresën që të ndalonin arrestimin e tyre. Situata u tensionua.

Uchitelskaia Gazeta raportoi se organizata «e paligjshme» baptiste në Rostov kishte një shtëpi të fshehtë botuese. (Në Rusi, fjala «Baptist» përfshinte evangjelistët dhe pentakostalët) Në këto botime të fshehta, të rinjtë thirreshin për të qëndruar në besimin e tyre, dhe prindërve të krishterë u kërkohesh të bënin atë që edhe unë mendoj se është veprim i matur: «Merrni fëmijët tuaj në varrime me qëllim që të mos shqetësohen për gjërat e përkohshme». Prindërit inkurajoheshin t'u jepnin arsimim të krishterë fëmijëve të tyre si një kundërhelm ndaj ateizmit me të cilin helmoheshin në shkollat komuniste.

Uchitelskaia Gazeta përfundoi artikullin duke pyetur: «Pse ndërhyjnë me kaq ndrojtje mësuesit në jetën e familjeve në të cilat fëmijët marrosen prej fesë?».

Uchitelskaia Gazeta përshkruan gjithashtu çfarë ndodhi në gjyqin e punonjësve të fshehtë, që kishin pagëzuar në fshehtësi: «Besimtarët e rinj, të thirrur si dëshmitarë, ishin mosbesues dhe përbuzës ndaj gjykatës komuniste. U sollën me zemërim dhe fanatizëm. Vajzat e reja spektatore vështronin me admirim të akuzuarit dhe me mospëlqim publikun ateist».


Anëtarët e kishës së fshehtë kanë rrezikuar rrahje dhe burgim për të kërkuar më tepër liri përpara selisë së Partisë Komuniste në Rusi.

Ne zotërojmë një dokument, që është dërguar në perëndim përmes rrugëve të fshehta. Ky dokument është nga Komiteti «i paligjshëm» i Kishave Bapteste Ungjillore i Bashkimit Sovjetik (krejt ndryshe nga «Unioni Baptist» i kontrolluar nga komunistët dhe i drejtuar nga tradhtari Karev, i cili lëvdonte mirësinë e vrasjeve në masë të të krishterëve dhe lartësonte «lirinë» që mbretëronte atje).

Në këtë dokument sekret, na tregohet edhe për një demonstratë publike heroike pikërisht në Moskë.

Po përkthej manifestin:

Komunikatë urgjente.



Të dashur vëllezër dhe motra! Bekime dhe paqe nga Perëndia Ati ynë dhe nga Zoti Jezu Krisht. Nxitojmë t'ju themi se përfaqësuesit e kishave të të Krishterëve Baptistë Ungjillorë, që shkojnë deri në pesëqind vetë, të cilët kanë udhëtuar për në Moskë në 16 Maj 1966 për ndërhyrje tek organet qendrore të pushtetit, shkuan në ndërtesën e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të BRSS-së me kërkesën që të priten dhe të dëgjohen.

I dërguam një peticion Sekretarit të Përgjithshëm, Brezhnjev. It.

Manifesti deklaronte më tej se këta pesëqind njerëz qëndruan tërë ditën përpara ndërtesës. Ishte demonstrata e parë publike në Moskë kundër komunizmit dhe kjo u krye përmes kishës së fshehtë. Në fund të ditës dërguan një peticion të dytë, që i adresojë Brezhnjev, në të cilin ankoheshin se njëfarë «shoku» Stroganov refuzonte t'ia transmetonte kërkesat e tyre Brezhnjev duke i kërcënuar.

Pesëqind përfaqësuesit mbetën në rrugë gjatë gjithë natës pavarësisht nga shiu. Megjithëse u fyen gojarisht dhe makinat që kalonin u hidhnin baltë, mbetën deri në mëngjes para ndërtesës së Partisë Komuniste!

Të nesërmen, të pesëqind vëllezërve iu propozua të hynin në një ndërtesë për të takuar disa zyrtarë më të ulët komunistë. Por «duke e ditur se besimtarët që kishin takuar autoritetet shpesh rriheshin kur hynin në një ndërtesë ku nuk kishte dëshmitarë, ata refuzuan njëzëri dhe vazhduan të prisnin për t'u pranuar nga Brezhnjevi».

Më pas ndodhi e pashmangshmeja.

Në 1:45 pasdite, erdhën njëzetë e tetë autobusë dhe filloi hakmarrja e ashpër ndaj besimtarëve. «Ne krijuam një rreth, duke kapur duart me njëri-tjetrin dhe kënduam himnin “Ditët më të mira të jetës sonë janë ditët kur bartim kryqin”. Njerëzit e policisë sekrete filluan të na rrihnin, të rinj e të moshuar. I nxirrnin burrat nga rreshti dhe i rrihnin në fytyrë dhe në kokë, më pas i hidhnin në asfalt. Disa prej vëllezërve tanë i tërhoqën zvarrë prej flokësh


për në autobus. Kur përpiqeshin të largoheshin, rriheshin derisa humbisnin ndjenjat. Pasi i mbushën autobusët me besimtarë, policia i dërgoi në një vend të panjohur. Nga autobusët e policisë sekrete dëgjoreshin këngët e vëllezërve dhe motrave. E gjithë kjo ndodhi para syve të një turme të madhe njerëzish».

Dhe tani vjen diçka edhe më e bukur: Pasi të pesëqind personat u arrestuan dhe u torturuan, vëlla G. Vins dhe një vëlla tjetër drejtues, i quajtur Horev (barinjte e vërtetë të tufës së Krishtit), patën përsëri guximin të shkonin në të njëjtin Komitet Qendror të Partisë Komuniste, pikërisht ashtu si Jezusi filloi predikimin e tij publik pas arrestimit të Gjon Pagëzorit në të njëjtin vend dhe me të njëjtat fjalë për të cilat vuajti Gjon Pagëzori: «Pendohuni, sepse mbretëria e qiellit është afër» (Mateu 4:17).

Vinsi dhe Horevi pyetën se ku ndodheshin të arrestuarit dhe kërkuan lirim të tyre. Këta dy vëllezër të guximshëm thjesht u zhdukën. Më pas erdhi lajmi që ishin dërguar në burgun Leftorovskaia.

A ishin të frikësuar këta të krishterë të kishës së fshehtë? Jo! Të tjerë rrezikuan menjëherë lirinë e tyre, duke botuar manifestin që kemi sot para nesh për të na treguar historinë e ngjarjes duke u thënë atyre: «Sepse juve ju është dhënë hiri për hir të Krishtit, jo vetëm që të besoni në të, por edhe të vuani për të» (Filipianëve 1:29). Ata nxisnin vëllezërit «që të mos lëkundet askush në këto pikëllime, sepse ju e dini se për këtë jemi caktuar» (Thesalonikasve 3:3). Ata citonin gjithashtu Hebrenjve 12:2 dhe u bënë thirrje besimtarëve të shihnin «te Jezusi, kreu dhe plotësonjësi i besimit, i cili, për gëzimin që ishte përpara tij, duroi kryqin duke e përçmuar fyerjen».

Kisha e fshehtë kundërshtoi hapur helmimin ateist të rinisë në Rostov dhe Moskë dhe në mbarë Rusinë. Ata luftuan kundër helmit komunist dhe kundër drejtuesve tradhtarë të kishës zyrtare, për të cilët shkruajnë në një prej manifesteve të tyre të fshehta: «Në ditët e sotme Satani dikton dhe “kisha” pranon të gjitha vendimet që janë kundër urdhërimeve të Perëndisë» (cituar në *Pravda Ukraini* më 4 tetor 1966).



Pravda Vostoka botoi gjyqin kundër vëlla Aleksei Neverovit, Boris Garamashovit dhe Aksen Zubovit, të cilët organizonin grupe për të dëgjuar transmetimet në radio të Ungjillit nga Amerika. I regjistronin këto mesazhe në kaseta dhe më pas i qarkullonin.

Akuzoheshin gjithashtu për organizimin e takimeve të fshehta Ungjillëzimi nën formën e «ekskursioneve» dhe «rretheve artistike». Në këtë mënyrë kisha e fshehtë funksionon siç funksiononte kisha e hershme në katakombet e Romës.

Sovietskaia Moldavia e 15 shtatorit të vitit 1966, shkroi se kisha e fshehtë shumëfishonte librushka me shaptilograf. Ata mblihdeshin në vende publike, megjithëse kjo ishte e ndaluar me ligj, dhe shkonin nga një vend në tjetrin për të dëshmuar për Krishtin.

E njëjta gazetë tregon se në një tren nga Reni për në Çisinau, tre djem të rinj dhe katër vjaza këndonin një himn të krishterë: «Le t'ia përkushtojmë rininë tonë Krishtit». Reporterit shfaqte revoltimin e tij ngaqë këta të krishterë predikonin «në rrugë, në stacione, në trena, autobusë dhe madje, edhe në institucionet shtetërore». Përsëri kjo ishte puna e kishës së fshehtë në Rusi gjatë periudhës komuniste.

Kur në gjyq u lajmërua dënimi i këtyre të krishterëve se këndonin himne të krishtera në publik, të dënuarit ranë në gjunjë dhe thanë: «Dorëzohemi në duart e Perëndisë. Të falënderojmë o Zot, që na ke lejuar të vuajmë për këtë besim». Më pas publiku, i drejtuar nga «fanatiku» Madan, këndoi në sallën e gjyqit himnin për të cilin vëllezërit e tyre sapo ishin dënuar me burgim dhe tortura.

Më 1 maj, të krishterët e fshatrave Kopceag dhe Zaharovka, duke mos pasur një kishë, organizuan një shërbesë të fshehtë në pyll. Zakonisht ata organizonin takime me pretendimin se kishin një festë datëlindjeje. (Shumë familje të krishtera me katër ose pesë persona mund të kishin tridhjetë e pesë «datëlindje» në vit për të mbuluar takimet e fshehta!)

As burgu dhe as torturat s'mund t'i frikësojnë të krishterët e kishës së fshehtë. Siç ndodhi edhe në kishën e hershme, persekutimi vetëm sa thelloi përkushtimin e tyre.

Pravda Ukraini i datës 4 tetor 1966, thoshte për vëlla Prokofievin, një prej drejtuesve të kishës së fshehtë ruse, se ai kishte qenë tashmë tri herë në burg, por sapo lirohej, fillonte të organizonte përsëri shkolla të fshehta të së dielës dhe për këtë u arrestua sërish. Ai shkroi në një manifest të fshehtë: «Duke iu nënshtruar rregullave njerëzore [ligjeve komuniste], kisha zyrtare e ka privuar veten nga bekimet e Perëndisë».

Dhe mos e imagjinoni asnjëherë burgun si në perëndim kur dëgjoni për një vëlla të dënuar në vendet e robëruara. Atje, burg do të thotë të vuash nga uria, torturat dhe indoktrinimi.

Nauka i Religia (Shkenca dhe Feja) No. 9 i vitit 1966 raportoi se të krishterët shpërndanin literatura Ungjilli duke i vendosur brenda gazetës *Ogoniok*. Shpërndanin gjithashtu edhe libra me kopertinën e *Ana Kareninës* (roman i Leon Tolstoit), brenda të cilave kishte pjesë nga Bibla.


Përveç kësaj, besimtarët këndonin këngë të krishtera në publik. Me melodinë e «Internacionales komuniste» ata këndonin fjalë që lëvdonin Krishtin (*Kazakstanskaia Pravda* 30 qershor 1966).

Në një letër sekrete të botuar në Kulunda (Siberi), të krishterët thonë se udhëheqësia zyrtare «Baptiste» ka «shkatërruar kishën dhe shërbëtorët e saj të vërtetë në botë, në të njëjtën mënyrë siç e tradhtuan Jezu Krishtin kryeprihtërinjtë, skribët dhe farisenjtë duke ia dërguar Pilatit». Por kisha e fshehtë besnike vazhdon të funksionojë.

Nusja e Krishtit vazhdon t'i shërbejë Atij. Vetë komunistët e pranonin se kisha e fshehtë kishte fituar edhe komunistë për Krishtin. Po, ata mund të fitohen!

Bakinskii Rabochi 27 prill 1966, ribotoi një letër nga Tania Ciugunova (një anëtare e Organizatës Rinore Komuniste) e cila u fitua për Krishtin. Kjo letër u kap nga autoritetet komuniste.

E dashur teze Nadia,
të dërgoj bekime nga Zoti ynë i dashur. Teze Nadia, sa shumë që më do Ai! Ne nuk jemi asgjë para Tij. Teze Nadia, besoj se i kupton këto fjalë: «Duajini armiqtë, bekojini ata



që ju mallkojnë, bëjuni mirë atyre që ju urrejnë dhe lutuni për ata që ju keqtrajtojnë».

Kur kjo letër u kap, Peter Serebrenikovi, vëllai që solli atë dhe shumë kumunistë të tjerë te Krishti, u burgos. Gazeta komuniste citoi nga një prej predikimeve të tij: «Ne duhet të besojmë te Shpëtimtari siç besuan të krishterët e parë. Për ne, ligji kryesor është Bibla. Nuk njohim asnjë tjetër. Duhet të nxitojmë t'i shpëtojmë njerëzit nga mëkati, veçanërisht të rinjtë». Ai tha se ligji Sovjetik ndalon ndarjen e Krishtit me të rinjtë, duke shtuar: «Për ne ligji i vetëm është Bibla» një përgjigje normale ku një diktaturë mizore ateiste sundon vendin.

Gazeta komuniste më pas përshkroi një pamje «të egër»: «Djem dhe vajza të vegjël këndojnë himne shpirtërore. Marrin pagëzimin sipas ritualit dhe bartin mësimin e ligë dhe të rrezikshëm të dashurisë ndaj armiqve». Artikulli deklaronte gjithashtu se shumë djem dhe vajza të reja të anëtarësuar në Organizatën Rinore Komuniste janë në të vërtetë të krishterë! Përfundonte me fjalët: «Sa e pafuqishme duhet të jetë shkolla komuniste, sa e mërzitshme dhe e privuar nga drita...që pastorët janë në gjendje të na i rrëmbejnë nxënësit nën hundën e edukatorëve të tyre indiferentë».

Në *Kazakstanskaia Pravda* të 30 qershorit 1966, komunistët u tmerruan kur zbuluan se nxënësi me notat më të mira ishte një djalë i krishterë!

Kirgizskaia Pravda e 17 janarit 1966, citonte një fletushkë të krishterë të kishës së fshehtë ndaj nënave: «Le të bashkojmë forcat tona dhe lutjet për t'ia përkushtuar Perëndisë jetën e fëmijëve tanë që kur janë në djep! Le t'i shpëtojmë fëmijët tanë nga ndikimi i botës».

Këto përpjekje kanë qenë të suksesshme. Gazetat komuniste janë dëshmi e faktit që Krishtërimi u shpërnda mes të rinjve.

Një gazetë nga Keliabinsku, Rusi, përshkruante se si një vajzë e re e Organizatës Komuniste, Nina, u bë e krishterë duke marrë pjesë në një takim të fshehtë.

Sovietskaia Justitia No. 9 të vitit 1966 përshkruan një takim të tillë të fshehtë. «Është zhvilluar në mesnatë. Të fshehur, mosbesues


madje edhe ndaj vetë hijes së tyre, njerëzit erdhën nga anë të ndryshme. Vëllezërit mbushnin dhomën e errët, që kishte tavan shumë të ulët. Kishte aq shumë njerëz sa që nuk kishte vend për të qëndruar në gjunjë. Për shkak të mungesës së ajrit, drita në një llambë primitive gazi u fik. Djersa u rridhte çurg në fytyrë. Në rrugë, një prej shërbëtorëve të Zotit ruante se mos vinte policia». Nina tha se në një takim të tillë ajo u prit me përqafile, ngrohtësi dhe përkujdesje. «Ata kishin shumë besim dhe njohje, i besonin Perëndisë. Ai i merr nën mbrojtjen e Tij. Le të më kalojnë pranë pa më përshëndetur Komsomolsët (anëtarët e Organizatës Rinore Komuniste)! Le të më shohin me përbuzje dhe le të më thërrasin, “Baptiste” njësoj sikur të më jepnin një shuplakë! Le të bëjnë si të duan! Nuk kam nevojë për ta».

Shumë komunistë të rinj si ajo, kanë marrë vendimin për t'i shërbyer Krishtit deri në fund.

Kazakstanskaia Pravda e 18 gushtit 1967, përshkruante gjyqin e vëllezërve Klasen, Bondar dhe Telegin. Nuk na tregohet se çfarë dënimi u jepet atyre, por krimi i tyre u bë i ditur: u kishin mësuar fëmijëve për Krishtin.

Sovietskaia Kirghizia e 15 qershorit 1967, ankohej se të krishterët «provokonin zbatimin e masave administrative kundër vetes». Kështu që autoritetet e pafajshme komuniste, që provokoheshin vazhdimisht për të arrestuar të krishterët nga vetë këta të krishterë kokëfortë që nuk kënaqeshin vetëm me lirinë, arrestuan edhe një grup tjetër. Krimi i tyre ishte zotërimi i një shtypshkronje jo të ligjshme, me pesëmbëdhjetë kektografe dhe gjashtë makineri lidhjesh për libra, në të cilën botohej literaturë e krishterë.

Pravda e 21 Shkurtit të vitit 1968, raportoi se mijëra gra dhe vajza u zbuluan se mbanin rripa dhe kordele ku ishin shkruar vargje dhe lutje. Autoritetet kërkuan dhe zbuluan se personi që kishte nxjerrë këtë modë të re, (të cilën mund t'ia rekomandoja edhe perëndimit), ishte jo më pak se një anëtar i krishterë i policisë komuniste, vëlla Stasiuk i Liubertcit. Gazeta lajmëroi arrestimin e tij.



Përgjigjet që japin të krishterët e kishës së fshehtë kur dërgohen para gjyqit komunist, janë hyjnisht të frymëzuara. Një gjykatës pyeti: «Pse i ke tërhequr njerëzit në sektin tënd të ndaluar?» Një motër e krishterë u përgjigj: «Qëllimi ynë është të fitojmë të gjithë botën për Krishtin».

«Feja juaj është anti-shkencore», – tha gjykatësi i një gjyqi tjetër, në të cilin vajza e akuzuar, studente, u përgjigj: «A e njihni më tepër shkencën se sa Ajnshtajni apo Njutoni? Ata ishin besimtarë. Universi ynë mban emrin e Ajnshtajnit. Kam mësuar në shkollë të mesme që ai është universi i Ajnshtajnit, i cili shkruan: “Nëse e pastrojmë judaizmin e profetëve dhe Krishtërimin siç ka mësuar Jezusi nga ajo që erdhi më pas, sidomos nga të ashtuquajturit priftërinj, ne kemi një fe, e cila mund të shpëtojë botën nga të gjitha të ligat e shoqërisë. Është detyra e shenjtë e çdo njeriu të bëjë të pamundurën që kjo fe të triumfojë.” Kujtoni psikologun tonë të madh, Pavlovin. A nuk thuhet në librat tanë që ai ishte i krishterë? Madje edhe Marksi në parathënien e *Das Kapital* ka thënë se “Krishtërimi, sidomos në formën e vet protestante, është feja ideale për ndryshimin e karakterit të shkatërruar nga mëkati.” Unë kisha karakter të shkatërruar nga mëkati. Marksi më ka mësuar të bëhem e krishterë me qëllim që ta rregulloj. Si është e mundur që ju marksistët më gjykoni për këtë?»

Nuk është e vështirë ta kuptosh pse gjykatësi mbeti pa fjalë.

Ndaj së njëjtës akuzë, fesë anti-shkencore, një i krishterë u përgjigj përpara gjykatës: «Zoti gjykatës, jam i sigurt se ju nuk jeni shkencëtar aq i madh sa Simpsoni, zbuluesi i kloroformit dhe i shumë medikamenteve të tjera. Kur u pyet se cili mendonte ai se ishte zbulimi i tij më i rëndësishëm, ai u përgjigj: ‘Nuk ishte kloroformi. Zbulimi im më i madh ishte të mësoja që jam mëkatar dhe se mund të shpëtohesha me anë të hirit të Perëndisë.’»

Jeta, vetësakrifica, gjaku që besimtarët janë të gatshëm të derdhin për besimin e tyre, është argumenti më i fortë për Krishtërimin dhënë nga kisha e fshehtë. Ajo krijon atë që misionari i mirënjohur në Afrikë, Albert Shuaitzer, e ka quajtur «bashkësia e shenjtë e atyre që kanë shenjë të dhembjes» – bashkësi në të

cilën bënte pjesë Jezusi, Njeriu i dhembjeve. Kisha e fshehtë është e bashkuar nga një lidhje dashurie ndaj Shpëtimtarit të vet. E njëjta lidhje bashkon anëtarët e kishës me njëri-tjetrin. Askush në botë s'mund t'i mposhtë.

Në një letër të nxjerrë fshehtas, kisha e fshehtë ka thënë: «Nuk duam të lutemi për të qenë të krishterë më të mirë, por që të mund të jemi i vetmi lloj i të krishterëve që Perëndia dëshiron të jemi: Të krishterë të ngjashëm me Krishtin, që do të thotë të krishterë që mbajnë me dëshirë kryqin për lavdi të Perëndisë».


Me zgjuarsinë e gjarprit, sipas mësimeve të Jezusit, të krishterët gjithnjë refuzonin t'i identifikonin drejtuesit e tyre kur pyeteshin përpara gjyqit.

Pravda Vostoka (E Vërteta e Lindjes) e 15 janarit 1966, thoshte se si u përgjigj në mbrojtje Maria Sevçuk kur u pyet se kush e solli te Krishti: «Perëndia më tërhoqi në bashkësinë e Tij». Një tjetër kur e pyetën: «Kush është drejtuesi yt?» u përgjigj: «Ne nuk kemi drejtues njerëzor».

Fëmijët e krishterë u pyetën: «Kush ju ka mësuar të largoheni nga pionierët dhe të hiqni shallin e kuq?» Ata u përgjigjën: «E kemi bërë me dëshirën tonë. Nuk na mësoi askush».

Megjithëse në disa vende maja e «ajsbergut» dukej, në vende të tjera, të krishterët praktikonin vetëpagëzimin për të shmangur arrestimin e drejtuesve të tyre. Ndonjëherë pagëzimet bëheshin në lumë, ku pagëzuesi dhe personi që do të pagëzohej vinin të dy maska që të mos dalloheshin në fotografi.

Uchitelskaia Gazeta e 30 janarit të vitit 1964, tregonte për një leksion ateist në fshatin Voronin në zonën e Volnecino-Korski. Sapo mbaroi leksioni besimtarët filluan të sulmonin publikisht mësimet ateiste përmes pyetjeve, të cilave lektori nuk mundi t'u përgjigjej. Pyetjet ishin: «Ku i merrni ju, komunistët, parimet që shpallni, por që nuk u bindeni – si për shembull “mos vidh” dhe “mos vrit”?» Të krishterët i tregonin lektorit që çdo parim vinte nga Bibla kundër së cilës luftonin komunistët. Lektori u hutua plotësisht dhe leksioni përfundoi me fitore për besimtarët!



Rritet persekutimi i kishës së fshehtë

Të krishterët në disa prej ish-Republikave Sovjetike vazhdojnë të persekutohen ende në ditët e sotme. Në vendet e robëruara në mbarë botën, të krishterët e kishës së fshehtë po vuajnë më tepër se kurrë më parë. Thuhet se pothuajse 160 000 të krishterë u martirizuan në vitin 1997. Për të krishterët është e dhimbshme të dinë për shtypjen e judenjve në vendet komuniste, por qëllimi kryesor është persekutimi i kishës së fshehtë. Vite më parë, shtypi sovjetik raportoi një valë arrestimesh dhe gjykimesh në masë. Në një vend, tetëdhjetë e dy të krishterë u futën në një azil për të çmendur. Njëzetë e katër vdiqën pas disa ditësh për shkak të «lutjeve të zgjatura». Që kur kanë filluar të vrasin lutjet e gjata? A mund ta imagjinoni se çfarë kanë kaluar ata?

Rrezikonin vuajtje më të mëdha nëse zbuloheshin se u mësonin fëmijëve të tyre për Krishtin, u merreshin fëmijët përgjithmonë dhe nuk kishin të drejtë t'u bënin as vizitë.

Gjatë periudhës komuniste, Bashkimi Sovjetik firmosi deklaratën e Kombeve të Bashkuara «kundër diskriminimit në sferën e arsimit», e cila kishte si kusht që: «Prindërit duhet të kenë të drejtën për t'u siguruar arsimin fetar dhe moral fëmijëve sipas bindjeve të tyre». Në një artikull, tradhtari Karev, i cili ishte drejtuesi i Unionit Baptist zyrtar të Bashkimit Sovjetik, siguronte se i tillë ishte realiteti në Rusi, dhe të marrët e besonin! Tani dëgjoni se çfarë thoshte shtypi sovjetik.

Në botimin e datës 4 qershor 1963, *Sovjetskaia Russia* tregonte se si një gruaje baptiste të quajtur Makrinkova ia kishin marrë të gjashtë fëmijët, sepse ndante me ta besimin e krishterë dhe i ndalonte të vinin shallin e pionierit.

Kur dëgjoi dënimin, tha vetëm: «Vuaj për shkak të besimit». Iu desh të paguante për fëmijët që ia rrëmbyen, me helmimin e tyre nga ateizmi. Nëna të krishtera, mendoni për agoninë e saj!

Uchitelskaia Gazeta raportonte se e njëjta gjë i ndodhi edhe Ignati Mullinit dhe gruas së tij. Gjykatësi u kërkoi të hiqnin dorë

nga besimi: «Zgjidhni midis Perëndisë dhe vajzës suaj. A zgjidhni Perëndinë?» I ati u përgjigj: «Nuk do të heq dorë nga besimi im».


Pali thotë: «Të gjitha gjërat bashkëveprojnë për mirë» (Romakëve 8:28). Kam parë fëmijë të tillë, të cilët u rritën si të krishterë, u morën prej prindërve dhe u vendosën në shkolla komuniste. Në vend që të helmoheshin prej ateizmit, besimin që e kishin marrë në shtëpi ua shpërndanin fëmijëve të tjerë!

Bibla thotë se «ai që e do birin apo bijën më shumë se Unë nuk është i denjë për Mua» (Mateu 10:37). Këto fjalë kanë kuptim në vendet e robëruara.

Provoni të jetoni një javë pa parë fëmijët tuaj! Atëherë do t'i njihni vuajtjet e vëllezërve tanë në vendet e robëruara. Sipas botimit të 29 marsit 1967 të *Znamia Lunosti*, Zonjës Sitsh Vsetshelsavi, ia morën djalin vetëm se e kishte rritur me frikën e Zotit. Zonja Zabavina nga Habarovsk nuk mund ta shihte mbesën e saj të mbetur jetime, Tanian, sepse i kishte dhënë «edukim jonormal (të krishterë)» (*Sovietskaia Rossia* e 13 janarit të vitit 1968). Privimi i të krishterëve ndaj të drejtave prindërore vazhdon edhe sot në vendet e robëruara.

Nuk do të ishte e drejtë të flisnim vetëm për Kishën e fshehtë protestante. Të krishterët ortodoksë në Rusi ndryshuan plotësisht. Miliona prej tyre kanë kaluar nëpër burgje, ku nuk kishin rozario, kryqe, imazhe të shenjta, aroma apo qirinj. Njerëzit e thjeshtë ishin në burg pa një prift të vajosur. Priftërinjtë nuk kishin veshjen priftërore, nuk kishin bukë gruri, as verë për kungim, nuk kishin vaj të shenjtë, as libra me lutje të përgatitura që të mund t'i lexonin. Ata zbuluan se mund t'ia dilnin mbanë edhe pa to, duke shkuar direkt te Perëndia në lutje. Filluan të luteshin dhe Perëndia derdhi Shpirtin e Tij mbi ta. Një rizgjim i vërtetë shpirtëror, shumë i ngjashëm me Krishtërimin fundamentalist, ndodhi mes ortodoksëve në Rusi gjatë kohës së komunizmit.

Kështu ndodhi që në Rusi, si edhe në vende të tjera, ekzistonte një kishë ortodokse e fshehtë, e cila ishte në të vërtetë ungjillore, me të vërtetat bazë, dhe shumë afër Perëndisë. Mbahti shumë pak prej riteve ortodokse. Kjo kishë ortodokse e fshehtë pati



shumë martirë të mëdhenj. Kush mund të thotë se çfarë ndodhi me peshkopin e moshuar, Jermogenin e Kalugës? Ai guxoi të protestonte kundër bashkëpunimit jo të drejtë të Patriarkatit dhe qeverisë së paperëndishme komuniste.

Gjatë shtatë dekadave të sundimit komunist deri në fund të Bashkimit Sovjetik, në fillim të viteve '90-të, shtypi rus i bëri jehonë triumfit të kishës së fshehtë. Ajo kaloi përmes vështirësive të paimagjinueshme, por qëndroi besnike ... dhe u rrit!

Ne në Rumani mbollëm farën me punën tonë të fshehtë në ushtrinë ruse. Kështu kishin vepruar edhe të tjerë në Rusi dhe në vendet e pushtuara nga rusët. Ajo farë dha shumë fryte.

Azia komuniste dhe vende të tjera të robëruara mund të fitohen për Krishtin. Kundërshtarët tanë mund të bëhen të krishterë. Kështu mund të fitohen edhe ata që shtypen prej tyre, por vetëm nëse i ndihmojmë.

Prova që kam të drejtë është kisha e fshehtë, e cila lulëzoi në kohën e komunizmit në Bashkimin Sovjetik, po lulëzon në Azinë komuniste, dhe po rritet në Lindjen e Mesme sot.

Për të treguar bukurinë e bashkësisë sonë të krishterë në rrethana të tmerrshme, më poshtë do lexoni disa letra nga vajza ruse, dy të fundit të shkruara në burgjet ruse.

Si e gjeti Krishtin një vajzë komuniste

Në vijim janë tri letra nga Maria, një vajzë e krishterë, që drejtoi Varian te Krishti, anëtare e Organizatës Rinore Komuniste.

Letra e parë

...vazhdoj të jetoj këtu. Më duan shumë. Më do edhe një anëtare e celulës së Komsomolit (Organizata Rinore Komuniste). Ajo më tha: «S'mund ta kuptoj çfarë njeriu je. Këtu shumë njerëz të fyejnë dhe të lëndojnë, por ti i do të gjithë». Iu përgjigja se Perëndia na mëson t'i duam të gjithë, jo vetëm miqtë, por edhe armiqtë. Më parë, kjo vajzë më ka lënduar shumë, por u luta për të me shqetësim të veçantë.

Kur më pyeti nëse mund ta doja edhe atë, e përqafova dhe të dyja filluam të qanim. Tani lutemi së bashku.

Të lutem, lutu për të! E quajnë Varia.

Kur dëgjon ata që e mohojnë Perëndinë me të madhe, duket se janë të bindur për këtë. Por jeta e tregon se shumë prej tyre, megjithëse e mallkojnë, në zemër kanë mall të madh dhe mund t'ua dëgjosh rënkimet e zemrës... Ata kërkojnë diçka dhe dëshirojnë ta mbushin boshllëkun e brendshëm me gjëra të paperëndishme.

Motra juaj në Krisht, Maria.


Letra e dytë

Në letrën e mëparshme ju shkrova për vajzën ateiste, Varian. Të dashurit e mi, tani po ngutem t'ju tregoj për gëzimin tonë të madh: Varia ka pranuar Krishtin si Shpëtimtarin e saj, duke u dëshmuar të gjithëve.

Kur besoi te Krishti dhe njohu gëzimin e shpëtimit, ajo u ndie edhe e trishtuar. Ishte e trishtuar, sepse më parë kishte propoganduar se nuk kishte Perëndi. Tani ka vendosur të shlyejë fajin e saj.

Shkuam së bashku në asamblenë e të paperëndishmëve. Megjithëse e paralajmërova të ishte e rezervuar, ishte e kotë. Varia shkoi dhe unë e shoqërova për të parë se çfarë do të ndodhte. Pas këndimit të himnit komunist (këngë në të cilën Varia nuk mori pjesë), doli përpara të gjithë asamblesë. Me shumë guxim dhe me ndjeshmëri, u dëshmoi të pranishmëve për Krishtin si Shpëtimtari i saj dhe u kërkoi ish-shokëve falje, sepse i kishte pasur sytë shpirtërorë të mbyllur dhe se nuk e kishte parë se, edhe ajo vetë po shkonte drejt humbjes duke drejtuar edhe të tjerët në të. Iu përgjërua të gjithëve të largoheshin prej rrugës së mëkatit dhe të vinin te Krishti.

Të gjithë heshtën dhe askush nuk e ndërpreu. Kur mbaroi së foluri, këndoi me zërin e saj të shkëlqyer të gjithë himnin e krishterë «Nuk kam turp të shpall Krishtin që vdiq për të mbrojtur urdhërimet e Tij dhe fuqinë e kryqit të Tij».



Dhe më pas... më pas e morën Varian.

Sot është 9 maj. Nuk dimë asgjë për të, por Perëndia është i plotfuqishëm për ta shpëtuar. Lutuni!
Juaja Maria.

Letra e tretë

Dje, më 2 gusht, pata një bisedë në burg me Varian tonë të dashur. Më dhemb zemra kur mendoj për të. Në fakt, ajo është ende fëmijë. Është vetëm nëntëmbëdhjetë vjeç. Edhe si besimtare në Zotin, është akoma foshnjë, por e do Zotin me gjithë zemër dhe u fut menjëherë në rrugën e vështirë. E gjora vajzë është aq e uritur! Kur e morëm vesh që ishte në burg, filluam t'i dërgonim pako, por i shkonin shumë pak nga ato që i dërgonim.

Kur e pashë dje, ishte e dobët, e zbehtë dhe e rrahur. Vetëm se sytë i shkëlqenin me paqen e Perëndisë dhe me një gëzim qiellor.

Po, të dashurit e mi, ata që nuk e kanë përjetuar paqen e mrekullueshme të Krishtit s'mund ta kuptojnë... Por sa të lumtur janë ata që e kanë... Ne që jemi në Krishtin asnjë vuajtje apo shqetësim nuk duhet të na ndalojë...

E pyeta përmes hekurave të burgut: «Varia, nuk je penduar për atë që ke bërë?» «Jo» – u përgjigj ajo. «Edhe nëse do të më lironin, do të shkoja dhe do t'u tregoja përsëri për dashurinë e madhe të Krishtit. Mos mendo se do të vuaj. Jam shumë e gëzuar që Zoti më do kaq shumë sa që më jep gëzimin për të duruar për emrin e Tij».

Ju lutem të luteni për të. Mund ta dërgojnë në Siberi. Ia kanë marrë të gjitha veshjet dhe gjërat personale. Nuk i ka mbetur asgjë veç rrobave të trupit. Ajo nuk ka të afërm dhe ne duhet t'i sigurojmë gjërat e nevojshme. Kam lënë mënjanë shumë e fundit që më dërgove. Nëse Varian e transferojnë, do t'ia jap asaj. Besoj se Perëndia do ta forcojë dhe do t'ia japë fuqinë për të duruar edhe në të ardhmen. Perëndia e mbroftë.
Juaja Maria

Letra e katërt


E dashur Maria, më në fund kam mundësi të të shkruaj. Mbërritëm mirë. Kampi ynë është afërsisht gjashtëmbëdhjetë kilometra larg qytetit. S'mund ta përshkruaj jetën këtu. Ti e di. Do të doja të të shkruaja pak për vete. Falënderoj Perëndinë që më jep shëndet që të mund të punoj fizikisht. Motra X dhe unë u vumë të punonim në një repart me makineri. Puna është e vështirë dhe shëndeti i motër X nuk është i mirë. Duhet të punoj për vete dhe për të. Përfundoj në fillim punën time dhe më pas ndihmoj motrën. Punojmë dymbëdhjetë deri në trembëdhjetë orë në ditë. Ushqimi është njësoj si aty ku je edhe ti, shumë i pakët. Por nuk të shkrova vetëm për këtë.

Zemra ime lëvdon dhe falënderon Perëndinë që, përmes teje, më tregoi rrugën e shpëtimit. Në këtë rrugë, jeta ime ka një qëllim dhe e di se ku të shkoj dhe për kë vuaj. Ndiej dëshirën për t'u treguar dhe t'u dëshmuar të gjithëve për gëzimin e madh të shpëtimit që kam në zemër. Kush mund të na ndajë nga dashuria e Perëndisë në Krishtin?

Askush dhe asgjë. As burgu dhe as vuajtja. Vuajtjet që na dërgon Perëndia vetëm na forcojnë më tepër besimin në Të. Zemra ime është aq e mbushur sa që hiri i Perëndisë derdhet. Në punë, më mallkojnë dhe më dënojnë, më japin punë shtesë, sepse s'mund të hesht. Duhet t'u them të gjithëve atë që Zoti ka bërë për mua. Ai më ka bërë një qenie të re, një krijesë të re. A mund të hesht pas kësaj? Jo, asnjëherë! Për aq kohë sa buzët e mia mund të flasin, do t'u dëshmoj të gjithëve për dashurinë e Tij të madhe.

Gjatë rrugës për në kamp, u takuam me shumë motra dhe vëllezër në Krishtin. Sa e mahnitshme është kur e ndjen përmes Frymës që ata janë fëmijë të Perëndisë që me herën e parë të takimit! Nuk është e nevojshme të flasin. Që në pamje të parë e ndjen dhe e di se cilët janë.

Ndërsa ishim gjatë rrugës për në kamp, në një stacion hekurudhe, një grua erdhi, na dha ushqim dhe tha vetëm dy fjalë: «Zoti jeton».



Mbrëmjen e parë që mbërritëm këtu (ishte vonë), na dërguan në barakat e nëndheshme. I përshëndetëm të pranishmit me fjalët: «Paqja me ju». Për gëzimin tonë të madh, nga të gjitha qoshet dëgjuam përgjigjen: «Ju mirëpresim me paqe». Që nga mbrëmja e parë e ndjemë se ishim në një familje.

Po, ishte vërtet kështu. Këtu ka shumë që besojnë te Krishti si Shpëtimtari i tyre. Më tepër se gjysma e të burgosurve janë besimtarë. Kemi mes nesh këngëtarë të mrekullueshëm dhe predikues të Ungjillit. Në mbrëmje, kur mblidhemi pas punës së rëndë, kënaqemi kur kalojmë pak kohë së bashku në lutje në këmbët e Shpëtimtarit tonë. Me Krishtin ka liri kudo. Kam mësuar shumë himne të bukur këtu dhe çdo ditë Perëndia më jep gjithnjë e më tepër prej Fjalës së Tij. Në moshën nëntëmbëdhjetë vjeçare, festova për herë të parë datëlindjen e Krishtit. Nuk do ta harroj kurrë këtë ditë të mrekullueshme! Na duhej të punonim gjithë ditën, por disa nga vëllezërit tanë mundën të shkonin në lumin që gjendej aty pranë.

Atje, thyen akullin dhe përgatitën vendin ku, sipas Fjalës, unë dhe shtatë vëllezër u pagëzuam gjatë natës. Oh, sa e lumtur jam dhe sa do të doja që edhe ti, Maria, të ishe me mua për të shlyer sado pak të këqijat që kam bërë ndaj teje në të shkuarën. Por Perëndia vendos secilin prej nesh në vendin që Ai dëshiron dhe duhet të qëndrojmë të fortë.

Përshëndete të gjithë familjen e fëmijëve të Perëndisë. Perëndia bekoftë punën tënde të përditshme, ashtu si më bekoj edhe mua. Lexo Hebrenjve 12:1-3.

Të gjithë vëllezërit të përshëndesin dhe janë të gëzuar që besimi yt në Perëndinë është aq i fuqishëm dhe që ti e lëvdon Atë pa pushim në vuajtjet e tua. Nëse u shkruan të tjerëve, përshëndeti nga ana jonë.

Juaja Varia

Letra e pestë

E dashur Maria, të paktën kam gjetur mundësinë për të të shkruar disa rreshta. Mund të them se me hirin e Perëndisë, motra X dhe unë jemi mirë me shëndet dhe ndihemi mirë. Tani jemi në [vendndodhja është hequr].

Të falënderoj për kujdesin tënd prej nëne. Kemi marrë gjithçka që ke përgatitur për ne. Të falënderoj për gjënë më të çmuar, Biblën. Faleminderit të gjithëve! Kur t'u shkruash, përshëndeti dhe falënderoji nga ana ime!

Që kur Zoti më zbuloi misterin e thellë të dashurisë së Tij të shenjtë, e konsideroj veten si njeriun më të lumtur në botë. Persekutimet që kam duruar i konsideroj si hir të veçantë. Jam e gëzuar që Zoti më dha që ditën e parë të besimit lumturinë e madhe që të vuaj për Të. Lutu për mua që t'i qëndroj besnike Zotit deri në fund!

Zoti ju ruajttë dhe ju forcoftë për betejën e shenjtë!

Motra X dhe unë ju puthim të gjithëve. Kur të na dërgojnë në [vendodhja është hequr] ndoshta do të kemi mundësinë t'ju shkruajmë përsëri. Mos u shqetësoni për ne! Jemi të lumtura dhe të gëzuara, sepse shpërblimi ynë është i madh në qiell (Mateu 5:11,12).

Juaja Varia

Kjo është letra e fundit nga Varia, vajza e re komuniste që gjeti Krishtin, dëshmoi për Të, dhe u dënua me punë të detyruar. Nuk u dëgjua më për të, por dashuria e saj e mrekullueshme dhe dëshmia për Krishtin shfaq bukurinë shpirtërore të vuajtjes së kishës së fshehtë.

KAPITULLI 7

Si mund të ndihmojnë të krishterët perëndimorë

Më kanë quajtur «Zëri i kishës së fshehtë». Nuk ndihem i denjë të jem zëri i një pjese kaq të nderuar të Trupit të Krishtit.

Megjithatë, në vendet komuniste, drejtoja prej vitesh një pjesë të kishës së fshehtë.

Për mrekulli u kam shpëtuar këtëmbëdhjetë viteve të torturave dhe burgimeve, duke përfshirë edhe dy vjet «në dhomën e vdekjes». Me anë të një mrekullie akoma edhe më të madhe, Perëndia e pa disi të përshtatshme të më merrte në burg dhe të më nxirrte jashtë. U vendos nga kisha e fshehtë në Rumani që duhet të lija vendin dhe t'ua çoja mesazhin të krishterëve të lirë në botë. Me anë të një mrekullie, unë dhe familja ime patëm mundësi të largoheshim dhe unë pata mundësi të përmbush detyrën që m'u ngarkua nga ata që mbetën pas duke punuar, rrezikuar, vuajtur dhe duke vdekur në dhjetëra vende të robëruara.

Flas në emër të vëllezërve të mi që prehen në varre të shumtë pa emra. Flas në emër të vëllezërve, të cilët mblidhen tani në fshehtësi në pyje, bodrume, papafingo dhe në të tjera vende të tilla.

Mesazhi që sjell nga kisha e fshehtë është:

«Mos na braktisni!»

«Mos na harroni!»

«Mos na nënvlerësoni!»

«Na jepni mjetet që na duhen! Ne do të paguajmë çmimin e përdorimit të tyre!»

Ky është mesazhi që më kanë ngarkuar t'i ndaj kishës së lirë.

Flas për kishën e fshehtë, kishën e heshtur, kishën e «shurdhër», që nuk ka zë të flasë.

Dëgjoni thirrjet e vëllezërve dhe motrave tuaja në vendet e robëruara! Ata nuk kërkojnë të arratisen, as siguri apo jetë të lehtë. Kërkojnë vetëm mjete për të kundërshtuar helmimin e rinisë, brezit të ardhshëm, me ateizmin. Ata kërkojnë Bibla për t'i përdorur për të shpërndarë Fjalën e Perëndisë. Si mund ta ndajnë Fjalën e Zotit pa e pasur?


Kisha e fshehtë është si një kirurg që po udhëtonte me tren. Treni u përplas me një tjetër dhe qindra njerëz ishin përtokë, të gjymtuar, të plagosur, duke vdekur, kirurgu ecte mes të vdekurve duke thirrur: «Sikur të kisha mjetet e mia! Ah, sikur të kisha mjetet e mia!» Me këto mjete kirurgjikale mund të shpëtonte shumë jetë. E kishte dëshirën... por i mungonin mjetet. Në këtë pozitë gjendet kisha e fshehtë. Është e gatshme të japë gjithçka. Është e gatshme të japë martirët e saj. Është e gatshme të kalojë vite në burgje. Por dëshira e saj nuk është e vlefshme, nëse nuk ka mjete për të punuar. Lutja e njerëzve besnikë dhe të guximshëm të kishës së fshehtë për ju që jeni të lirë është: «Na jepni mjete, Ungjij dhe Bibla, literaturë, ndihmë, dhe ne do të bëjmë pjesën tjetër».

Si mund të ndihmojnë të krishterët në botën e lirë

Çdo i krishterë në botën e lirë mund të ndihmojë menjëherë në mënyrat e përmendura më poshtë.

Ateistët janë njerëz që nuk i njohin burimet e padukshme të jetës së tyre. Ata nuk e kanë ndjenjën e misterit në univers dhe në jetë. Të krishterët mund t'i ndihmojnë që të mund të ecin përmes besimit, duke jetuar një jetë në bashkësi me Perëndinë e padukshëm.

Ata mund të na ndihmojnë duke bërë jetë të një krishteri të vërtetë, jetë sakrifice. Mund të ndihmojnë duke protestuar publikisht sa herë që të krishterët persekutohen.



Të krishterët perëndimorë mund të na ndihmojnë duke u lutur për persekutuesit që të mund të shpëtohen. Lutje të tilla mund të duken naive. Kur u lutëm për komunistët, ditën që pasoi torturat karshi nesh u bënë edhe më të rënda se një dite më parë. Por edhe lutja e Zotit në Jeruzalem ishte «naive». Ata e kryqëzuan pas lutjes, por vetëm disa ditë më pas rrahën kraharorin dhe pesë mijë njerëz u kthyen në besim brenda ditës.

Lutja nuk shkon kot për të tjerët. Çdo lutje që nuk pranohet nga ata për të cilët po ndërmjetëson, të kthehet me shumë bekime. Për të përmbushur fjalën e Krishtit, shumë të krishterë, përfshirë edhe veten time, jemi lutur gjithmonë për Hitlerin dhe njerëzit e tij. Dhe jam i sigurt që lutjet tona ndihmuan për ta mposhtur, po aq sa edhe plumbat e ushtarëve aleatë.

Duhet ta duam të afërmin porsi veten. Komunistët dhe persekutuesit e tjerë janë të afërmit tanë, po aq sa edhe çdokush tjetër.

Ata janë rezultat i mosshpalljes së fjalëve të Krishtit. «Kam ardhur që të mund të kenë jetë dhe ta kenë me bollëk» (Gjoni 10:10). Të krishterët nuk ia kanë bërë të mundur të gjithëve këtë jetë me bollëk. Ata kanë lënë disa në prag të gjithçkaje të vlefshme në jetë. Këta persona janë rebeluar dhe kanë krijuar Partinë Komuniste dhe besime të tjera të rreme. Shpesh viktimat e vetë padrejtësisë shoqërore, kthehen në mizorë për shkak të hidhërimit që bartin. Duhet t'i përballojmë edhe ata. Por të krishterët, edhe kur luftojnë kundër një armiku, e bëjnë me armën e dashurisë.

Ne nuk jemi pa faj për faktin se disa jetojnë në rebelim. Jemi fajtorë të paktën për shpërfillje të detyrës.

Kështu duhet ta shlyejmë duke i dashur dhe duke u lutur për ta, që është diçka krejt ndryshe nga të pëlqyerit.

Nuk jam aq naiv sa të besoj se vetëm dashuria mund t'i zgjidhë këto probleme. Nuk do t'ua sugjeroja autoriteteve të shtetit të zgjidhnin problemet e bandave vetëm me anë të dashurisë. Duhet të ketë forca policore, gjykatës, dhe burgje për banditët, dhe jo vetëm pastorë. Nëse banditët nuk pendohen, duhet të burgosen. Nuk do ta përdorja kurrë shprehjen «rreth dashurisë» për të kundërshtuar

luftën e përshtatshme politike, ekonomike apo kulturore kundër komunistëve dhe tiranëve të tjerë, të cilën nuk janë asgjë tjetër veç banditë në shkallë ndërkombëtare. Banditët vjedhin një portofol; vjedhin edhe shtete të tëra.

Por pastorët dhe çdo i krishterë duhet të bëjnë më të mirën për të sjellë te Krishti kombet rebele, çfarëdo krimi që kryejnë, dhe viktimat e tyre të pafajshme. Duhet të lutemi me dhembshuri për ta.


Nevojë urgjente për Bibla

Një mënyrë tjetër për t'i ndihmuar të krishterët e lirë është duke dërguar Bibla dhe pjesë të saj. Mund të dërgohen të sigurta në vendet e robëruara, nëse të krishterët e lirë do t'i siguronin për motrat dhe vëllezërit në kishën e fshehtë. Kur isha në Rumani, mora shumë Bibla të sjella në mënyra të ndryshme. Dërgesa nuk është problem, duhet vetëm të mund të sigurohen.

Nevoja për to është e madhe. Mijëra të krishterë nuk kanë parë Bibla apo ungjij për dekada të tëra në vendet komuniste si Kina dhe Korea e Veriut.

Dy fshatarë me rroba të ndotura erdhën në shtëpinë time një ditë për të blerë një Bibël. Kishin ardhur nga fshati i tyre për të zënë punë në pastrimin e tokës nga akulli i dimrit për të fituar para me shpresën e vakët që të mund të kishin mundësi të blinin një Bibël të vjetër e të përdorur dhe ta çonin në fshatin e tyre. Më kishin ardhur disa Bibla nga Amerika dhe pata mundësi t'u jepja një të re. S'mund t'u besonin syve. U përpoqën të më paguanin me paratë që kishin fituar, por i refuzova. Nxituan të ktheheshin në fshat me Biblën. Disa ditë më vonë, mora një letër të gëzueshme, ku më falënderonin për Shkrimet. Ishte e firmosur nga tridhjetë fshatarë. E kishin ndarë Biblën në tridhjetë pjesë dhe shkëmbenin pjesët me njëri-tjetrin.

Ishte e trishtë të dëgjoje një rus të përgjerohej për një faqe të Biblës për të ushqyer shpirtin. Ishin të lumtur të shkëmbenin një lopë apo një dhi me një Bibël. Një njeri shiti unazën e martesës për



një Dhiatë të Re të përdorur. Shumë fëmijë nuk kanë parë asnjëherë një kartolinë Krishtlindjeje. Nëse do të kishin një të tillë, të gjithë fëmijët e fshatit do të mblihdeshin dhe ndonjë i moshuar do t'u shpjegonte për foshnjën Jezus, për lindjen e Tij nga një virgjëreshë, historinë e Krishtit dhe shpëtimin. E gjithë kjo, vetëm nga një kartolinë Krishtlindjeje! Ne u dërgojmë Bibla, ungjij dhe literatura të krishterëve në vendet e robëruara. Kjo është një mënyrë se si mund të bëni diçka.

Botojmë dhe dërgojmë edhe literatura të veçanta për t'iu kundërpërgjigjur helmit ateist, që u jepet të rinjve që nga kopshti e deri në universitet. Në Bashkimin Sovjetik, komunistët përgatisnin *Udhëzuesin Ateist*, që është «Bibla» e ateistëve. Fëmijëve në kopshte u mësohen versione të thjeshta, dhe nga i njëjti udhëzues, u mësohen versione më të përparuara ndërsa rriten. «Bibla» e ligë e ndjek fëmijën ndërsa rritet dhe përparon duke e helmuar me ateizmin gjatë gjithë kohës. Ne botojmë dhe dërgojmë *Përgjigjen e Udhëzuesit të Ateistëve* si përgjigjja e krishterë ndaj mësimëve ateiste.

Rinia jonë e helmuar duhet të ketë një përgjigje, përgjigjen e Perëndisë, përgjigjen e krishterë, përgjigjen tonë. Kjo është diçka tjetër që mund të bëni, duke ndihmuar me sigurimin e literaturave të veçanta në vendet, ku Perëndia nuk është «i ligjshëm». Literatura të tilla përfshijnë Bibla për fëmijë dhe literatura të ilustruara për të rinj.

Ne duhet t'i ndihmojmë anëtarët e kishës së fshehtë me mbështetje financiare për të ndarë Ungjillin përmes Ungjillëzimit personal. Shumë prej tyre janë të «prangosur» nëpër shtëpi nga mungesa e fondeve për të udhëtuar apo për ushqime gjatë udhëtimit. Nuk kanë mundësi të lëvizin ndërsa fshatrat njëzetë apo tridhjetë kilometra larg më kot i thërrasin për të ardhur në takime të fshehta. Duke u siguruar fonde çdo muaj, mund t'ua thyejmë «prangat» për të pasur mundësi për të shkuar në qytete apo fshatra me Fjalën e Perëndisë. Për shembull, ne blejmë motoçikleta për pastorët vietnamezë dhe kinezë, të cilët shkojnë për të ndarë Ungjillin në «zona të ndaluara» të vendeve të tyre.

Sigurojmë biçikleta për ungjilltarët në Bangladeshin mysliman, të cilët dëshmojnë duke rrezikuar shumë.


Të krishterët e thjeshtë duhet të kenë ndihmë financiare. Duke qenë se janë të krishterë, zor se fitojnë mjaftueshëm për të mbijetuar, ndaj nuk u mbetet asgjë për të shkuar nga fshati në fshat me Ungjillin. Kjo është «mrekullia» që do të bënin disa dollarë në muaj për ta.

Pastorët e kishave zyrtare, që drejtojnë paralelisht një shërbesë të fshehtë që bart rrezik të madh, duhet të kenë fonde që sigurohen fshehtas për këtë qëllim. Gatishmëria për të rrezikuar lirinë e tyre duke shpërfillur rregullat për t'u predikuar Ungjillin fëmijëve, të rinjve dhe të rriturve në takime të fshehta, nuk është e mjaftueshme. Ata duhet të kenë mjetet për ta vazhduar shërbesën e frytshme në fshehtësi. Dhurimi i fondeve për këtë qëllim do të shërbejë si ndihmesë për çdo anëtar të kishës së fshehtë që të ndajë Ungjillin me efektivitë.

Diçka tjetër, ne duhet ta transmetojmë Ungjillin në vendet e robëruara përmes radios. Duke përdorur stacione në botën e lirë, mund të ushqejmë shpirtërisht kishën e fshehtë, që ka nevojë të madhe për Bukën e Jetës. Ngaqë komunistët përdorin radio me valë të shkurtra për t'u bërë propagandë njerëzve të tyre, miliona njerëz në vendet e robëruara kanë radio dhe mund t'i dëgjojnë këto transmetime. Dyert mbeten të hapura për transmetime në radio dhe kjo punë duhet të zgjerohet. Kisha e fshehtë duhet të ketë ushqimin shpirtëror, që sigurohet përmes këtyre transmetimeve. Kjo është një mënyrë tjetër se si mund ta ndihmoni kishën e fshehtë në vendet e robëruara.

Tragjedia e familjeve të martirëve të krishterë

Familjet e martirëve të krishterë kanë nevojë për ndihmë. Dhjetëra mijëra familje të tilla po vuajnë në një mënyrë tragjike sa s'mund të përshkruhet. Kur një anëtar i kishës së fshehtë arrestohet, familja e tij goditet nga një tragjedi e tmerrshme. Është e paligjshme që



dikush t'i ndihmojë. Kjo është planifikuar mirë nga qeveria për të shtuar vuajtjen e gruas dhe të fëmijëve që janë lënë pas. Burgosja e një të krishteri, torturat apo edhe vdekja janë vetëm fillimi. Familja e tij vuan pafundësisht. Unë mund të deklaroj për faktin se, nëse të krishterët në botën e lirë nuk do të më kishin dërguar ndihmë mua apo familjes sime, nuk do të kishim mbijetuar për t'i shkruar këto fjalë.

Martirë ka gjatë gjithë kohës. Megjithëse ata shkojnë në varr dhe drejt shpërblimit, familjet e tyre jetojnë në kushte tragjike. Ne kemi mundësi dhe duhet t'i ndihmojmë. Sigurisht që duhet të ndihmojmë edhe indianët apo afrikanët që vuajnë urie. Por kush e meriton ndihmën e të krishterëve më tepër se familjet e atyre, që kanë vuajtur për Krishtin apo janë torturuar për besimin në burgje në vendet e robëruara?

Që prej liritim tim, 'Zëri i Martirëve' u ka dërguar tashmë shumë ndihma familjeve të martirëve të krishterë. Çfarë është bërë është shumë pak krahasuar me atë që mund të bëjmë me ndihmën tuaj.

Mesazhi im për ju nga kisha e fshehtë

Si anëtar i kishës së fshehtë, i cili ka mbijetuar dhe është shpëtuar, ju kam sjell një mesazh, një apel, përgjërëm nga vëllezërit që kam lënë pas.

Ata më kanë dërguar për t'ju ndarë këtë mesazh. Kam mbijetuar për mrekulli për t'ju bërë të ditur.

Ju kam treguar për urgjencën e çuarjes së Krishtit në botën komuniste dhe në vende të tjera të robëruara. Ju kam folur për urgjencën e ndihmës ndaj familjeve të martirëve të krishterë. Ju kam treguar mënyra praktike se si mund ta ndihmoni kishën e fshehtë të përmbushë misionin e saj për ndarjen e Ungjillit.

Kur më fshikullonin nga këmbët, gryka ulërinte. Pse ulërinte gryka? Ajo nuk rrihej. Ulërinte, sepse gryka dhe këmbët janë pjesë e të njëjtit trup. Dhe ju të krishterët e lirë jeni pjesë e të njëjtit Trup të Krishtit, që tani rrihet në burgje në vendet e

robëruara, por që edhe tani jep martirë për Krishtin. A nuk e ndjeni dhembjen tonë?

Kisha e hershme në gjithë bukurinë, sakrificën dhe përkushtimin është ringjallur përsëri në këto vende.

Ndërsa Zoti ynë, Jezu Krisht, lutej në agoni në kopshtin e Gjetsemanisë, Pjetri, Jakobi dhe Gjoni ishin pak hapa larg dramës më të madhe në histori, por ishin në gjumë të thellë. Sa prej shqetësimit tuaj të krishterë dhe dhënies është në ndihmë të kishës martire? Pyesni pastorët dhe drejtuesit e kishës se çfarë bëhet në emrin tuaj për t'i ndihmuar vëllezërit dhe motrat në vendet e robëruara në mbarë botën.

Në këto vende, drama, guximi dhe martirizimi i kishës së hershme po ndodh përsëri, dhe kisha e lirë fle.

Vëllezërit tanë atje, të vetëm dhe pa ndihmë, po përballen me betejën më të madhe dhe më të guximshme të shekullit të njëzetë, e njëjtë me heroizmin, kurajën dhe përkushtimin e kishës së hershme. Dhe kisha e lirë fle, e pavetëdijshme për mundimin dhe agoninë e tyre, po ashtu si fjetën Pjetri, Jakobi dhe Gjoni në momentet e agonisë së Shpëtimtarit të tyre.

A do të flini edhe ju ndërsa vëllezërit tanë në Krisht vuajnë dhe luftojnë për Ungjillin?

A do ta dëgjoni mesazhin tonë: «Na kujtoni, na ndihmoni?»

«Mos na braktisni!»

Tani jua solla mesazhin nga kisha e martirizuar besnike, nga vëllezërit dhe motrat tuaja, që po vuajnë nën zgjedhën e komunizmit ateist dhe nën sulmet në mbarë botën, që nga Indonezia dhe deri në Afrikë. Mos i braktisni!

Njeriu që guxoi të fliste

Pastor Riçard Vurmbrand nuk ishte drejtuesi i parë i krishterë, që iu largua trajtimit mizor të qeverisë komuniste rumune; të tjerë e kishin pararendur. Por përsëri bota perëndimore mbeti në padije ndaj vuajtjeve të duruara nga kisha e fshehtë. Pse nuk kishte folur askush tjetër?

Përgjigjja iu bë e qartë pastor Vurmbrandit kur u largua nga Rumania, ku oficerët e policisë sekrete e paralajmëruan që të mos fliste asnjëherë kundër komunistëve. Ata kishin agjentët e tyre në perëndim dhe ia bënë të qartë se do ta ruanin. Dhe pse duhej të fliste? A nuk kishte vuajtur mjaft?

Por Vurmbrandi foli. Pavarësisht kërcënimeve të komunistëve dhe kritikave të disa prej drejtuesve të kishave perëndimore, ai mbante dëshminë e vuajtjeve të atyre që duruan ferrin komunist dhe folën për besimin e tyre fitimtar.

Brenda vitit të parë në Shtetet e Bashkuara, pastor Vurmbrandi u arrestua dy herë për «ndërprerje» të takimeve prokomuniste. U thirr për të dëshmuar para Senatit, i zhveshur deri në mes për të zbuluar shenjat e tetëmbëdhjetë plagëve të shërurara, të shkaktuara nga torturat e shpeshta. Disa drejtues të krishterë e quanin të çmendur, si dikë që e kishte lënë mendja në qelitë e izolimit në burg. Për të tjerët, ai u bë «Pali i Perdes së Hekurt» apo «Zëri i kishës së fshehtë». Një reporter i *Philadelphia Herald* tha për Vurmbrandin: «Ai qëndroi në mes të luanëve, por s'mundën ta përpinin».


Në tetor të vitit 1967, me 100 dollarë dhe një makinë të vjetër shkrimi, me 500 emra dhe adresa, Riçard Vurmbrandi nxori

në qarkullim për herë të parë broshurën *Zëri i Martirëve*. Kjo broshurë botohej për të komunikuar dëshmitë dhe sprovat me të cilat përballeshin motrat dhe vëllezërit në vendet e robëruara në mbarë botën.

Nuk ishte si të tjerat. Lexuesit i shkruanin Vurmbrandit të tmerruar nga mizoritë që ai përshkruante. «Si ka mundësi që kjo të jetë e vërtetë?» – pyesnin ata. Të tjerët thoshin se kjo broshurë u shkaktonte makthe dhe kërkuan të mos e merrnin më. Por ata që panë përtej vuajtjeve dhe torturave panë bukuri, bukuri në zemrat e burrave dhe grave dhe madje edhe fëmijëve, të cilët refuzuan të mohonin Krishtin. Lexuesit qenë dëshmitarë të një besimi të gjallë, që i bënte të aftë njerëzit si pastor Vurmbrandi të «puthnin hekurat» e qelisë së tyre të burgut, të gëzonin në bashkësinë e vuajtjeve të Krishtit.

Në botën perëndimore, persekutimi i të krishterëve konsiderohet shpesh si çështje e «të drejtave të njeriut» duke kërkuar që qeveria të garantojë lirinë fetare dhe mbrojtjen. Megjithëse kjo mund të jetë pjesërisht e vërtetë, duhet të shohim përtej arsyesimit njerëzor, duhet të shohim drejt vendeve qiellore. Jezusi tha: «Një shërbëtor nuk është më i madh se i zoti i tij». Nëse më persekutojnë Mua, do t'ju persekutojnë edhe ju" (Gjoni 15:20). Ai na paralajmëroi gjithashtu se «në botë do të keni mundime» (Gjoni 16:33), dhe «do t'ju urrejnë për hir të emrit Tim» (Mateu 10:22). «Gëzohuni dhe ngazëllohuni, sepse shpërblimi juaj është i madh në qiell» (Mateu 5:12).

Megjithëse jemi thirrur të shfrytëzojmë çdo mundësi për të ndihmuar njerëzit në nevojë, duhet të pranojmë se të krishterët do të kalojnë përmes persekutimit. Njëmbëdhjetë prej dymbëdhjetë dishepujve u vranë. Jezusi nuk tha se për ne do të ishte ndryshe. Është pjesë e asaj që jemi në Krishtin. Jo të gjithë jemi thirrur për të vuajtur persekutim të njëjtë me pastor Vurmbrandin. Por kur vijnë sprovat, nuk duhet të habitemi, por të gëzohemi që po konsiderohemi të denjë për të vuajtur për Krishtin. Sepse vetë Ai ka thënë: «Lum ata që janë përndjekur për hir të drejtësisë, sepse e tyre është mbretëria e qiejve» (Mateu 5:10).



Pali shpjegon marrëdhënien midis pjesëtarëve të Trupit të Krishtit te 1 Korintasve 12:25-26: «që të mos ketë përçarje në trup, por të gjitha gjymtyrët të kenë të njëjtin kujdes për njëra-tjetrën. Dhe nëse vuan një gjymtyrë, të gjitha gjymtyrët vuajnë; kurse po të nderohet një gjymtyrë, të gjitha gjymtyrët gëzohen bashkë me të». Shkrimtari i Hebrenjve shton: «Kujtoni të burgosurit si të ishit të lidhur bashkë me ta, dhe ata që keqtrajtohen, sepse edhe ju vetë jeni një trup» (Hebrenjve 13:3). Ky varg ka qenë qendra e Zërit të Martirëve që në vitin 1967.

Bëhet e qartë se, ndërsa studiojmë Dhiatën e Re, persekutimi nuk është dhe as do të jetë ndonjëherë i panjohur për kishën në këtë tokë. Kështu që kemi detyrimin si pjesëtarë të Trupit për të «inkurajuar dhe për të ndërtuar njëri-tjetrin» (1 Thesalonikasve 5:11) derisa të kthehet Krishti. Po të veprojmë ndryshe do të thotë të refuzojmë përgjegjësinë tonë si të krishterë dhe mësimet e Jezusit.

Për këtë arsye, «Zëri i Martirëve» vazhdon të shërbejë në pothuajse 40 shtete në mbarë botën, ku motrat dhe vëllezërit tanë persekutohen vazhdimisht. Në Vietnam, Laos dhe në Kinë, të krishterët rrihen, vriten apo burgosen. Kishat e tyre shkatërrohen dhe u digjen Biblat. Nën sundimin e islamizmit në dekadat e fundit, martirizohen mesatarisht 400 të krishterë çdo ditë. Miliona njerëz janë vrarë në Sudan, ku forcat radikale islamike kanë kryqëzuar mijëra burra të krishterë apo i kanë mbytur në lumin Nil. Të tjerë janë burgosur duke pritur ekzekutimin me varje. Gratë sudaneze dhunohen ndërsa fëmijët u rrëmbehen dhe shiten si konkubina apo skllevër të myslimanëve në veri. Për këtë tragjedi, të krishterët sudanezë deklarojnë: «Megjithëse shtëpitë na janë djegur dhe kishat na janë shkatërruar, jemi të nxitur më tepër se kurrë për t'u predikuar njerëzve Krishtin».

Është e vështirë të kuptosh se gëzimi dhe liria mund të ekzistojnë së bashku me vuajtjet më të tmerrshme të njohura nga njeriu, për të kuptuar se si vuajtja mund të na jepet si «dhuratë» në emër të Krishtit (Filipianëve 1:29). Për njeriun shpirtëror, i destinuar të jetojë përjetë me Krishtin, vuajtjet nuk kanë pse të kuptohen nga ana njerëzore.

Broshuara e *Zërit të Martirëve* vazhdon të informojë dhe të nxisë për veprim të krishterët në mbarë botën e lirë për gjendjen e vështirë të atyre, që vuajnë për besimin në Krishtin. Përmes rrjetit të zyrave në mbarë botën, broshura botohet aktualisht në 30 gjuhë dhe shpërndahet në mbi 250 000 besimtarë çdo muaj.

Shërbesa ka zhvilluar gjithashtu pesë qëllime kryesore për t'i shërbyer kishës së persekutuar sot:

T'u sigurojmë të krishterëve Bibla, literaturë dhe transmetime në radio:

1. Në gjuhën e tyre në vendet e robëruara, ku të krishterët persekutohen.
2. T'u japim ndihmë familjeve të martirëve të krishterë në këto pjesë të botës.
3. Të ndërmarrim projekte inkurajuese për t'i ndihmuar besimtarët të rindërtojnë jetën dhe dëshminë e tyre në vendet që kanë vuajtur nga shtypja komuniste.
4. Të ftojmë për Krishtin ata që kundërshtojnë Ungjillin.
5. Të informojmë botën për mizoritë e kryera ndaj të krishterëve dhe për guximin dhe besimin e të persekutuarve.

Ju ftojmë të merrni pjesë në këtë shërbesë për të «kujtuar ata që janë në bugje, si të lidhur me ta» (Hebrenjve 13:3). Inkurajohuni prej besimit të tyre fitimtar dhe shfrytëzoni çdo mundësi për të qenë inkurajim për ata, që vuajnë për besimin e tyre në Krishtin.

Nëse dëshironi të mësoni më tepër për kishën e persekutuar sot apo të merrni regjistrim falas për broshurën e përmuajshme të *Zërit të Martirëve*, ju lutem na kontaktoni në:

The Voice of the Martyrs

P.O. Box 443

Bartlesville, OK 74005

(800) 747-0085

Vizitoni faqen tonë të internetit: www.persecution.com

20 tetor, 1997

Z. Tom Uajt
Drejtori i SHBA-së
Zëri i Martirëve, etj.

I dashur Z. Uajt:

Është nder për mua të shkruaj disa reflektime rreth botimit të edicionit të 30-të të «Të torturuar për Krishtin» nga Riçard Vurmbrand. Tri dekada pas botimit, ky libër komunikon ende me fuqi të pazakontë sakrificat e autorit dhe gruas së tij për kauzën e Krishtit.

Ngjarjet në «Të torturuar për Krishtin» ndodhën në Rumaninë e pushtuar nga sovjetikët pas Luftës së dytë Botërore. Historia që tregohet është plot gjallëri dhe prekëse, por transmeton në çdo faqe një dëshmi universale, e mbushur me dhimbje fizike dhe psikologjike të duruara nga martirët e krishterë gjatë dy mijëvjeçarëve të persekutimit. Riçard Vurmbrandi tregon se burgimi dhe izolimi, në vend që të çrrënjoshin besimin, e çuan në një harmoni më të thellë me Krishtin, i cili vuajti dhe vdiq që ne të mund të kemi jetë të përjetshme.

Ndërsa këtij shekulli tërë ankth po i vjen fundi, Perandoria Sovjetike nuk ekziston më, dhe vendet e Evropës Lindore i kanë flakur tej prangat e skllavërisë së një ideologjie të paperëndishme. Por mundimet e persekutimit dhe mizoritë që duruan Vurmbrandët janë po aq bashkëkohore, sa edhe në ditën që ky libër u shkrua. Në mbarë botën të krishterët vazhdojnë të vuajnë për besimin e tyre: shiten në skllavëri apo kryqëzohen në Sudan, ndalohen të adhurojnë lirshëm në vendet e Lindjes së Mesme, dënohen me punë të detyrueshme në kampet e Kinës dhe u nënshtrohen ligjeve dhe praktikave diskriminuese në dhjetëra vende të tjera. Midis tyre ka burra dhe gra, mundimet e të cilëve na duhet t'i mësojmë akoma, por për të cilat Riçard Vurmbrand na ka dhënë një pamje të plotë dhe rrëqethëse.

Le të gëzojë çdo i krishterë në guximin e treguar në këto faqe, dhe me shpresën që i ofrojnë besimtarëve në kohën tonë dhe në kohërat që do të vijnë.

Singerisht



Geri L. Bauer



[Universiteti Uiton]

Tom White
The Voice of the Martyrs, Inc.
P.O. Box 443
Bartlesville, OK 74003

Përveç Biblës, disa nga materialet më efikase që mund të përdoren për të ndihmuar të krishterët të rriten në besim janë biografitë dhe autobiografitë. Autobiografia e Riçard Vurmbrandit është një libër jashtëzakonisht i rëndësishëm. Është korrigjues i rëndësishëm i kotësive që shfaqen sot. Historia e jetës së Vurmbrandit thekson të vërtetën se «në botë do të keni mundime» nëse ndiqni Jezusin. Autori e ruajti besimin dhe shpresën, sepse Jezu Krishti e mundi botën.

Lyle W. Dorset
Profesor i Shërbesave Edukative dhe Ungjillëzimit
Universiteti Uiton, Illinois

«Besnik deri në vdekje»

Gjatë tridhjetë viteve që ky libër ka qenë në qarkullim, “Të torturuar për Krishtin” ka prekur jetët e mijëra njerëzve, të krishterë dhe jo të krishterë, me profesione, kultura dhe bindje të ndryshme fetare. Megjithëse ka denominacione me pikëpamje të ndryshme në disa aspekte të Krishtërit, mesazhi i kishës së persekutuar ka bashkuar shumë njerëz nën thirrjen e Hebrenjve 13:3: “kujtoni të burgosurit si të ishit të lidhur me ta”.

Në faqet që pasojnë janë letrat e vlerësimit nga drejtues të krishterë për jetën e pastor Riçard Vurmbrandit dhe librit të tij “Të torturuar për Krishtin”. Ne besojmë se do t’ju japin një shpirt falënderimi ndaj Perëndisë për shërbesën besnike të Riçard Vurmbrandit dhe gruas së tij, Sabinës, si dhe për frytet e punës së tyre.

AUTORIT

Rreth autorit


Pastor Riçard Vurmbrand është pastor ungjillor, i cili ka duruar katërbëdhjetë vjet burgim dhe tortura në vendlindjen e tij, në Rumani. Vetëm pak emra janë të njohur në Rumani, midis të cilëve ai është udhëheqësi, autori dhe edukatori më i njohur i krishterë.

Në vitin 1945, kur komunistët pushtuan Rumaninë dhe u përpoqën të kontrollonin kishat për qëllimet e tyre, Riçard Vurmbrand filloi një shërbesë të fshehtë frytdhënëse dhe të gjallë. U arrestua në vitin 1948, bashkë me gruan e tij, Sabinën.

Gruaja e tij punoi si skllave në kampin e punës për tre vjet në Kanalin e Danubit. Riçard Vurmbrand kaloi tre vjet në një qeli izolimi, duke mos parë askënd tjetër përveç torturesve komunistë. U transferua në një qeli të përbashkët, ku torturat vazhduan për pesë vjet të tjera.

Për shkak të reputacionit të tij ndërkombëtar si udhëheqës i krishterë, diplomatët e ambasadave të huaja i kërkuan qeverisë komuniste sigurinë e tij dhe u informuan se ai ishte arratisur prej vendit. Policia e fshehtë, duke u shtirur si ish-shokë burgu tashmë të liruar, i thanë gruas së tij se kishin marrë pjesë në varrimin e





tij në një varrezë burgu. Familjes dhe miqve të tij jashtë vendit u thanë ta harronin, sepse kishte vdekur.

Pas tetë vjet e gjysmë në burg, u lirua dhe menjëherë rifilloi punën në kishën e fshehtë. Dy vjet më vonë, në vitin 1959, u arrestua përsëri dhe u dënua me njëzetë e pesë vjet burg.

Z. Vurmbrand u lirua në një amnisti të përgjithshme në vitin 1964, dhe vazhdoi përsëri shërbesën e tij të fshehtë. Duke qenë në rrezik të madh të një tjetër burgimi, të krishterët në Norvegji bënë marrëveshje me autoritetet komuniste për daljen e tij nga Rumania. Qeveria komuniste kishte filluar të «shiste» të burgosurit politikë. Çmimi për një të burgosur ishte 1900 dollarë; çmimi për Vurmbrandin arriti 10 000 dollarë!

Në maj të vitit 1966, ai dëshmoi para komitetit të sigurisë së brendshme të senatit të SHBA-së, ku u zhvesh deri në mes për të treguar shenjat e tetëmbëdhjetë plagëve të thella prej torturave, që i mbulonin trupin. Historia e tij u përhap në mbarë botën në gazetatat në të gjithë SHBA-në, në Evropë dhe Azi. Në shtator të vitit 1966, u paralajmërua se regjimi komunist i Rumanisë planifikonte ta vriste; por përsëri ai nuk heshti përballë kërcënimit me vdekje.

Themeluesi i misionit të krishterë «Zëri i Martirëve» dhe gruaja e tij udhëtuan në mbarë botën për të themeluar një rrjet me mbi tridhjetë zyra, që sigurojnë ndihmë për familjet e të krishterëve të burgosur në vendet islamike, në Vietnamin komunist, Kinë dhe në vende të tjera ku të krishterët persekutohen për shkak të besimit. Mesazhi i tij ka qenë: «Urreni sistemin, por duajini persekutuesit tuaj. Duajini shpirtrat e tyre dhe përpiquni t'i fitoni për Krishtin».

Pastor Vurmbrandi është autori i disa librave të përkthyer në mbi gjashtëdhjetë gjuhë në mbarë botën. Ai është quajtur «Zëri i Kishës së Fshehtë». Udhëheqësit e krishterë e kanë quajtur një martir të gjallë dhe «Pali i Perdes së Hekurt».

SHTOJÇË


Materiale mbi kishën e persekutuar

Libra të tjerë nga Riçard Vurmbrand

- Orakujt e Perëndisë (The Oracles of God)
- Në Kishën e Fshehtë të Perëndisë (In God's Underground)
- Nga Vuajtja drejt Triumfit (From Suffering to Triumph)
- Krishti në Rrugën Çifute (Christ on the Jewish Road)
- Fitimtarët (The Overcomers)
- Besim Fitimtar (Victorious Faith)
- Të Arrish Lartësitë (Reaching Toward the Heights)
- Me Perëndinë në Dhomën e Izolimit (With God in Solitary Confinement)
- Prova të Ekzistencës së Perëndisë (Proofs of God's Existence)
- Përgjigje ndaj Udhëzuesit Ateist (The Answer to the Atheist's Handbook)
- Marksi & Satani (Marx & Satan)
- Kënga më e Ëmbël (The Sweetest Song)

Libra të tjerë nga Zëri i Martirëve

- Gruaja e Pastorit (The Pastor's Wife), nga Sabina Vurmbrand
- Raketat e Perëndisë mbi Kubë (God's Missiles Over Cuba), nga Tom Uajt
- Beteja Shpirtërore për Kubën (The Spiritual Battle for Cuba), nga Tom Uajt



- Midis Dy Tigrave (Between Two Tigers), nga Tom Uajt
- Fluturimi mbi Kufi (Flight Over the Border), nga Hans Martin Braun

Video nga Riçard Vurmbrand

- Ruaje Fjalën (Preserve the Word)
- Asnjë Perëndi Tjetër (No Other God)
- Fytyrat e Perëndisë (The Faces of God)
- Të Thërrasësh apo të Dëgjosh (To Shout or to Listen)
- Rumania: Kthimi (Romania: The Return)
- Në Burg me Psalmin 107 (In Prison With Psalm 107), nga Sabina Vurmbrand

Video nga Zëri i Martirëve

Besimi nën zjarr. Besimi nën zjarr paraqet intervista me të krishterë, të cilët përballen drejtpërdrejt me persekutimin. Do të takoni një mysliman, kthimi i të cilit në «rrugën e Damaskut» e çon drejt persekutimit; një pastor kinez që vuan nën politikën e «godit fort» me të cilën përballen të krishterët tani; dhe një adoleshent vietnamez që merret me arrestimin e të atit dhe burgosjen për punën e tij në kishën e fshehtë. «Besimi nën zjarr» do t'ju sfidojë të konsideroni: «Është besimi im gati për të qëndruar nën zjarr?» (Përmban skena dramatike, të cilat mund të mos jenë të përshtatshme për fëmijë.)

Prova e besimit të Stefanit (video për fëmijë). Dymbëdhjetë vjeçarin Stefan e tallin dhe e vënë në lojë për besimin e tij. Atë natë në ëndërr Stefani udhëton përgjatë historisë për të takuar Jezusin, Stefan martirin, familjet të cilat ishin gati të hynin në koloseun romak, Uilliam Tindeil, fëmijët e krishterë në Lindjen e Mesme sot, dhe të tjerët të cilët guxojnë të ndajnë besimin e tyre.

E filmuar në shumë vende, «Prova e Stefanit» është një sfidë frymëzuese për të gjitha moshat, një mjet i fuqishëm për shkollën e së dielës, për të pashpëtuarit, për klasa apo shtëpi. Kjo ecje me heronj besnikë na inkurajon me thirrjen historike për të vazhduar të ndjekim Jezu Krishtin kur vihemi në «provë». (Përfshin një linjë studimi me referenca nga Shkrimi.)

Zëri i Martirëve ka në dispozicion shumë libra, broshura, video dhe prodhime të tjera për t'ju ndihmuar të mësoni më tepër rreth kishës së persekutuar. Në SHBA, për të kërkuar një katalog, për të porositur materiale apo për të marrë letrën mujore të lajmeve telefononi në (800) 747-0085 ose shkruani në:


The Voice of the Martyrs, Inc.
P.O. Box 443
Bartlesville, OK 74005-0443

Nëse jeni në Kanada, Australi, Angli apo në Zelandën e re kontaktoni:

The Voice of the Martyrs
P.O. Box 117
Port Credit
Mississauga, Ontario L5G 4L5
Canada

Release International
P.O. Box 19
Bromley BR2 9TZ
England

The Voice of the Martyrs
P.O. Box 598
Penrith NSW 2751
Australia



Jesus to the Communist World
P.O. Box 69-158
Glendene, Auckland 1230
New Zealand

Formulari i Përgjigjes

- Do të doja të kisha një regjistrim falas në letrën e përmuajshme «Zëri i Martirëve».
- Ju lutem më dërgoni më tepër informacion se si mund të ndihmoj kishën e persekutuar.
- Ju lutem më dërgoni një listë të plotë të librave të tjerë, të videove dhe materialeve të ofruara nga «Zëri i Martirëve».
- E marr tashmë letrën e njoftimit të «Zëri i Martirëve». Ju lutem më dërgoni një regjistrim për shokun/shoqen tim(e) në adresën e mëposhtme:
- Kam pranuar Krishtin si Shpëtimtar dhe Zot si rezultat i leximit të këtij libri

Emri

Adresa

Qyteti..... Shteti Zip.....

Nr telefoni. (Dita)

Adresë imeli

Ju lutem shënoni në kutinë/kutitë përkatëse dhe dërgojeni këtë formular me anë të një zarfi në:

The Voice of the Martyrs
P.O. Box 443
Bartlesville, OK 74005-0443

Ju mund ta dërgoni përgjigjen tuaj me faks në (918) 338-0189.
Vizitoni në www.persecution.com.



Përmbajtja

Parathënie	5
1 Etja e madhe e rusëve për Krishtin	9
2 «Askush nuk ka dashuri më të madhe...»	29
3 Shpengimi dhe lirimi për të punuar në perëndim	43
4 Mposhtja e komunizmit me dashurinë e Krishtit	47
5 Kisha e fshehtë, e përhapur kudo dhe e pathyeshme	77
6 Si e mposht Krishtërimi komunizmin?	95
7 Si mund të ndihmojnë të krishterët perëndimorë	115
Njeriu që guxoi të fliste	123
Materiale mbi kishën e persekutuar	132